

GAREGIN D. NALBANDIAN

# Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit





GAREGIN D. NALBANDIAN

**LEGJENDA  
E  
HAJKUT  
DHE  
BEL NIMRODIT**



aibPAPER

TIRANË, 2020

Përktheu nga botimi në gjuhën Angleze: Berzh Piranjani, Kevin Piranjani

Pergatiti per shtyp: Berzh Piranjani

Redaktoi: Berzh Piranjani

Art Grafik: Orest Muça

Mundësuan botimin:

Berzh dhe Varuzhan Piranjani

Çdo përdorim ose ribotim i këtij libri për qëllime komerciale ndalohe.

Tirazhi 100 kopje

ISBN: 978-9928-05-271-1

Shtëpia Botuese “albPaper”, Tiranë, 2020

Rruga: “Shemsi Haka”, ish-Poligrafiku, Tiranë

Tel.: +355 42 35 89 37

## DEDIKIM

Hajku ishte paraardhësi i gjithë Armenëve. Legjenda e Hajkut është kaq domethënëse sa që Lordi George Gordon Byron dhe kolegët e tij e konsideruan atë të denjë për t'u futur si shtesë në Bibël. Ky libër i dedikohet gjithë Armenëve dhe njerëzve të tyre të afërt.

Armenë, jini krenarë për atë çfarë ju jini, dhe gjithnjë veproni në mënyrë të tillë, që paraardhësit tuaj të jenë krenarë për ju!



# MIRËNJOHJE

Do dëshiroja të falenderoja Joseph Orozco, i cili lexoi shumë, shumë versione të këtij tregimi dhe ngriti pyetje, që e ndihmonin atë të kuptonte historinë deri sa ajo u bë version final i Legjendës së Hajkut dhe Bel Nimrodit.

Gjithashtu, falenderoj lexuesit e mi, të cilët blenë dhe lexuan Botimin e Parë të Legjendës së Hajkut dhe Bel Nimrodit.

Falenderoj prindërit e mi, Melkon dhe Virgjine, që më dhanë jetë dhe më rritën si duhet, vëllain dhe motrën, Armen dhe Marine, që ishin gjithnjë pranë meje, gruan time, Elizën, dhe djalin tim, Mikelin, për mbështetjen e tyre, si edhe gjithë të afërmit dhe miqtë e mi, çdo njeri, që më ndihmoi mua të jem ai që jam sot.

Mbi të gjitha, falenderoj Zotin, që më krijoi mua si një Armen të lindur Sovjetik, që u rrit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe më kompletoi me edukimin dhe mundësitë studjuese, që unë të mund të isha i aftë të krijoja këtë libër.



Statuja e Hajkut si Harkëtar i Madh është punuar si skulpturë nga Karlen Nurinjanian në vitin 1975. Ajo është vendosur në kryeqytetin e Armenisë, në Erevan.

## PËRMBAJTJA

1. Legjenda e Hajkut dhe Belit. Poemë, pjesa e parë.....	9
2. Parathënie .....	15
3. Hyrje .....	19
4. E vetmja gjuhë që njerëzit flisnin në tokë .....	23
5. Gjuhët Indo-Europiane dhe ajo Armene një herë e një kohë kanë qenë e njëjta gjuhë .....	26
6. Gjurmë të adhurimit të Perëndisë së Pjellorisë.....	31
7. Thrakët e lashtë, Kushitët dhe Civilizime të tjera .....	35
8. Navasardi dhe tradita të tjera .....	37
9. Mbretëria e Hajkut dhe mbretëria e Belit .....	41
10. Ndërtimi i kullës së Babelit .....	57
11. Pasioni i Nimrodit për pushtet dhe madhështi .....	70
12. Beteja e parë e Hajkut kundër Titanëve .....	81
13. Beteja ndërmjet Hajkut dhe Belit.....	97
14. Trashëgimia e Hajkut.....	112
15. Konkluzione .....	128
16. Legjenda e Hajkut dhe Belit. Poemë, pjesa e dytë.....	131
17. Populli Armen dhe popujt e afërt me të.....	133
18. Fjalor.....	159
19. Bibliografi .....	173



# LEGJENDA E HAJKUT DHE BELIT

## POEMË

Pjesa I<sup>rë</sup>

Të falenderoj lexues; legjenda që lexon,  
Për Mitikun Hajk dhe mbretin e Babelit tregon,  
Mbretit të Kushitëve dhe shigjetarit me Hark,  
Mbreti quhej Nimrod, heroi quhej Hajk.

I pangopur ish Nimrodi, gjithnjë i padrejtë.  
Me ushtritë e fuqishme kudo kallte frikë.

Ky mbret Biblik që quhej Nimrod,  
Dhe Mbret Fuqiplot' dhe Zoti Bel,  
Thirri gjithë popujt për të të ndërtojn'  
Një kullë në vendin që quhej Babel.

Mbret i gjith' ligësive ishte,  
Vetë Djalli zili e kishte...

Trim mbi trimat ishte Hajku, djali i Torgomit,  
Të shkojë të punojë për kullën, u ftua në Babel.  
La shtëpinë e të jatit, si shumë e shumë të tjerë,  
E shkoi të punojë me besë tek Nimrod Bel.

Nimrodi i premtoi gjithë njerëzisë,  
 Takimin me Zotin kur kulla të mbarojë.  
 Zotin e Qiellit, Krijuesin e Tokës,  
 Krijuesin e yjeve, Atë që përmbytjen krijoj’.

Besuan njerëzit në fjalët që u tha,  
 Aq shumë dëshirë kishin Zotin me pa....  
 Secili e kishte një shkak, mirë ose keq,  
 Prej fuqisë së Zotit e dinin se ç’heq.

Prej qiellit Zoti pa,  
 Turbullira në Tokë...  
 Farkëtarët gatuanin armë pa fund,  
 Të mateshin njerëzit me Perëndinë.....

Kullën e Madhe mallkoi Zoti,  
 Që s’ ishte art, por vepër koti.  
 Ndërtuar njeriut t’i rrisë lavdinë,  
 Në provë Zotit t’i vërë fuqinë....

“Zoti ndryshoi gjuhët e njerëzve,”  
 Në Bibël kështu thuhet.  
 Dhe kulla u shemb  
 Duke frikësuar njerëzit.....

Nimrodi u mërzit.  
 Madhështia e tij ishte dëmtuar.  
 Nga ai çast vendosi gjithë botën të pushtojë.  
 Çdo gjë, që bëri, ishte për të shëruar shpirtin e tij të trishtuar.  
 Dikur një mbretëri qiellore e quajtur Babel,  
 Tani nga Nimrodi ishte shndërruar në ferr.

Ndërkohë Hajku, me treqind të tjerë,  
 Morën familjet dhe braktisën zotin e huaj...

Hajku mori udhën e shtëpisë, në tokën e prindërve.  
Aty ngriti një ushtri të re, me shigjetarët më të shpejtë.

Manitonit, mësuesit të Nimrodit,  
Ju shfaq një vision i ri,  
Sipas të cilit, Nimrodi vritej nga shigjetari i tij Xhafetik.....  
Sado e hidhur, ja tha Nimrodit vizionin e tij.

Nimrodi kuptoi, prej Zotit destinuar ishte,  
Të shkatërronte dhe vriste armiqtë e tij Xhafetikë  
Përpara se shigjetari të shkatërronte  
Mbretin e Titanëve dhe botën që njihte.....

Nimrodi thirri Titanët e tij, vasalët e tij, dhe gjithë të tjerët,  
“Sulm drejt Veriut” - urdhër i tij gjëmoi.

U mbloodhën gjithë ushtarët dhe shumë të tjerë;  
Të gatshëm të zbatojnë urdhërat e mbretit të tyre të lig.....

Ata kishin shërbyer nën Kushin, shpesh shërbenin për Nimrodin.  
Nga tokat e Kushit të Madh ata kishin kyer shumë fushata.  
Ata erdhën në vende të reja, por tashmë si armiq të rinj.  
Bel Nimrod udhëhiqte këtë ushtri heronjsh.

Ata kishin lëkurë, hundë, mollëza dhe fytyrë të zezë.  
Ata ishin të gjithë nga raca e njohur trime Hamitike.  
Ata ishin të gjatë si gjigantë, dhe frikën nuk e njihnin.

Titanë ua kishin vënë emrin, dhe fuqia e tyre shpërndante frikë.  
Armët e tyre arrinin larg.  
Armët e tyre arrinin edhe afër...

Si Titanë njiheshin, këta ushtarë mbi qerre luftarake.  
Mbrojtës të Kushitëve ndaj gjithë të pabindurve dhe kryengritësve...

Ata mbanin veshur armaturë bronzi, në kokë një luan.  
 Me heshtat dhe shigjetat, me shpatat bërë prej bronzi,  
 Ata pushtonin, dhe vrisnin duke u marrë jetën atyre,  
 Që të shëndetshëm ishin apo të sëmurë, të fuqishëm apo të dobët,  
 Dhe nuk ndjeheshin fajtorë.  
 Të pamëshirshëm ishin Titanët, nga natyra vrasës të lindur.  
 Madje në gji të nënave vrisnin dhe foshnja të posalindur.

Më të zhurmshëm se gjënim i bubullimës ishin ata. Lëviznin më  
 shpejt se njerëzit.  
 Ishin krijesa gjiganteske, që gjuanin luanë.  
 Kështu, që njerëzit duhet të mateshin mirë, kur bëhej fjalë për këta  
 kampionë Hamitikë.  
 Në ushtrinë e Nimrodit ata ofruan shërbimin e tyre.  
 Kurrë më parë, njeri i arsyeshëm, s'kishte guxuar të përballlej  
 Me këtë tufë të zgjedhur trimash,  
 Dhe bota gjithnjë do t'i trembej furisë së tyre zhurmëmadhe.

Burrat e Nimrodit erdhën për të sfiduar vullnetin e burrave të shquar,  
 Që ishin aleatë të Hajkut, por armiq të Belit.

Hajku dhe aleatët e tij e pranuan përballjen.  
 Kështu, të dy palët shkuan të luftojnë betejën e tyre përfundimtare.

Si përfundoi lufta, miqtë e mij, nuk do ua tregoj.  
 Sepse mund ta lexoni në legjendën që flet  
 Për Hajkun dhe Nimrodin Bel.



Garegin D. Nalbandian (Kar-e-kint), autori i “Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit” po punonte mbi një tjetër histori dhe “Legjenda e Hajkut dhe Belit” është një histori brenda asaj historie. Atëherë, Z. Nalbandian vendosi të publikonte “Legjendën e Hajk dhe Bel Nimrodit” si një libër më vete për të parë nëse lexuesve do t’u pëlqente. Duke gjykuar nga dëshmitë e shumta të lexuesve, të cilët lanë komentet e tyre mbi Botimin e Parë të këtij libri, si dhe vlerësimin 4.5 nga 5 yje, që ata lanë në Amazon.com, lexuesit e pëlqyen këtë libër dhe lindi nevoja për ta ribotuar atë si Botimi i Dytë me ndryshime të vogla dhe rregullime gramatikore. Pa hezitim të mëtejshëm, autori prezanton Botimin e Dytë të këtij libri për publikun. Kënaquni duke lexuar dhe duke u kthyer pas në kohën e ngjarjeve Biblike të deklaruara në Gjenezë...



## PARATHËNIE

“Legjenda e Hajkut” ishte kaq domethënëse, sa Lordi George Gordon Byron dhe kolegët e tij dolën me idenë ta shtonin atë në Bibël ose ta zëvendësonin me historinë e Kainit në Bibël; sidoqoftë, ata nuk ja dolën. Pasi studioi gjuhën Armene dhe gjuhë të tjera, ai deklaroi se “Armenishtja është gjuha për të folur me Zotin, dhe Zoti foli me botën në gjuhën Armene”.

“Legjenda e Hajkut dhe Nimrodit” është bazuar në fakte dhe histori. Ajo na kthen pas në kohë përmes mijëvjeçarëve deri në periudhën e kohës së ndërtimit të Kullës së Babelit. Flet për personazhe mitike dhe Biblike dhe ngjarje të cilat janë shkruar në Bibël. Ajo na siguron përgjigje dhe shpjegime për disa nga ngjarjet Biblike, të cilat kishin krijuar ngatërrim dhe dykuptimësi për shumë njerëz dhe dijetarë, të cilët kishin studiuar Biblën dhe kishin hulumtuar historinë dhe gjenealogjinë e racës njerëzore.

Hyrja jep një sfond dhe informacion për ngjarjet, që u bënë shkak për lëvizjet e njerëzve nga Afrika e Veriut drejt Lindjes së Mesme, nevojën për ndërtimin e kullës së Babelit, ngatërresën e gjuhëve ose ndarjes së gjuhëve të tjera nga gjuha mëmë, të cilën dijetarët e quajnë Gjuha Bazë (protolanguage) e njerëzve Indo-Europianë, si dhe për pasojat e betejës ndërmjet Hajkut dhe Bel Nimrodit. Gjashtë kapitujt e historisë përshkruajnë atë që ndodhi në të vërtetë. Fjalori përmban përkufizime dhe shpjegime të termave dhe fjalëve që janë

përdorur në gjuhën e lashtë të njerëzve të hershëm. Bibliografia deklaroi burimet letrare, që kam përdorur. Unë sugjeroj, gjithashtu, të lexohet seksioni “Populli Armen dhe popujt e afërt me të” i këtij libri, sepse shumë prej fisnikëve Armenë ishin pasardhës të Hajkut dhe aleatëve të tij.

Motivimi im për të shkruar “Legjendën e Hajkut dhe Bel Nimrodit” ishte të siguroja historinë e vërtetë mbi atë, që shkaktoi luftën ndërmjet Hajkut dhe Bel Nimrodit dhe mënyrën si ajo përfundoi. “Legjenda Armene e Hajkut dhe Belit” përcakton se, Hajku dhe pasardhësit e tij luftuan kundër ushtrive të Belit në zonën e quajtur Hajoc Cor, dhe se ishte një Betejë Gjigandësh. Historianët Armenë e quajtnë “Dyutsazunamart”, e cila fjalë për fjalë përkthehet Beteja (mart) e Gjakut (sazun) Hyjnor (dyu-t ose div), dhe nëse përkthehet sipas mitologjisë, do të thotë Beteja e Gjigandëve. Megjithatë, faktet dhe historia provojnë se Hajku dhe aleatët e tij luftuan më tepër se një betejë kundër ushtrive të Bel Nimrodit. Ato gjithashtu sigurojnë informacion për vendosjen (ngulimet) e popullit Armen dhe popujve të tjerë të Lindjes së Mesme, Europës dhe Azisë.

Është i njohur fakti se, historia e lashtësisë u shkrua duke përdorur një gjuhë të fshehtë, e cila quhet mit ose mitologji. Shumë historiografë të mitologjisë shkruan se Nimrodi ishte një gjigand (një Titan) i gjatë sa gjashtëdhjetë burra, që qëndronin mbi njëri-tjetrin. Shumë historianë Armenë shkruan se Hajku ishte një burrë i gjatë sa tridhjetë e gjashtë burra, që qëndronin mbi njëri-tjetrin. Nuk ekziston asnjë provë shkencore, si fosile ose skelete, të njerëzve aq të mëdhenj; prandaj, duhet të kuptojmë se këto numra përfaqësojnë diçka tjetër. Fuqia e Nimrodit, i gjatë sa gjashtëdhjetë burra, duhet kuptuar si të ishte një përfaqësim i gjashtëdhjetë fiseve ose popujve, të cilët ishin aleatët dhe mbështetësit e tij. Fuqia e Hajkut, i gjatë sa tridhjetë e gjashtë burra, përfaqësonte tridhjetë e gjashtë fiset ose popujt, të cilët ishin aleatë dhe mbështetës të tij. Hajku ishte pasardhës i brezit të gjashtë të Noes dhe kjo është historia e tij.

Shumë njerëz shohin lajmet ose lexojnë gazetat në mënyrë që të kuptojnë të tashmen. Njerëzit, gjithashtu, lexojnë mbi historinë ose shohin dokumentarë për të kuptuar të shkuarën. Unë e shkruajta këtë libër, sepse vura re nevojën për të përdorur historinë dhe faktet, për të ndihmuar njerëzit të kuptojnë të shkuarën, në mënyrë që ata të kuptojnë të tashmen. Shpresoj, që libri im të kënaqë kureshtjen e lexuesve të mi dhe se ky libër do t'i shërbejë një qëllimi madhor të kombinimit të fesë dhe shkencës duke përdorur faktet e historisë. Unë mendoj se, lexuesit e mi do të kënaqen duke lexuar këtë libër, sepse unë u kënaqa vërtet duke e shkruajtur atë, dhe sepse është po aq e rëndësishme për njerëzit që të kuptojnë të shkuarën, sa ç'është e rëndësishme për ta që të kuptojnë të tashmen.



## HYRJE

\* \* \*

Noe, pasardhësit e tij, dhe çfarë ndodhi me Arkën

Shumë herë, shkenca vjen në kundërshtim me Biblën e Shenjtë. Disa njerëz besojnë tek shkenca, të tjerë tek Bibla... Libri im do të sqarojë disa nga misteret dhe çuditë e Biblës, të cilat shkenca nuk ka mundur t'i ndriçojë. Kështu, njerëzit, që ndjekin shkencën, mendojnë se Bibla gabon, ndërkohë që nuk është e vërtetë. Njerëzit që janë më të prirur ndaj besimit dhe ata të cilët janë më të prirur ndaj shkencës, madje, në këto raste, as nuk marrin mundimin të marrin në konsideratë faktorin e tretë, që është historia. Historia luan një rol kritik dhe ka shumicën e përgjigjeve për shumë nga gjërat, të cilave shkenca dhe besimi nuk janë në gjendje t'u japin shpjegim. Për shembull, Bibla e Shenjtë tregon se Arka e Noes u ndal në malet Ararat (Genesis 8:4) kur ujrat e përmbytjes së madhe u tërhoqën. Libri i Datave të Shënuara (The Book of Jubilees)\* (\*këtu e më prapa - Libri i Ngjarjeve) shprehet se Arka e Noes qëndroi në majën e Lubarit, një nga malet e Araratit. Lubarit (Për kuptimin e Lubarit shih fjalorin në fund të këtij libri) ndoshta ka qenë emri i vjetër i Malit Ararat. Fosilet e gjetura në Shkretëtirën e Saharasë dhe në Lindjen e Mesme lënë të kuptohet se pjesë të Shkretëtirës së Saharasë dhe të Lindjes së Mesme kanë qenë vërtet nën ujë. Fosile

të tilla janë dëshmi e qartë shkencore e një Përmytjeje të Madhe të ndodhur në atë zonë; megjithatë, asnjë shkencëtar nuk ka qenë i aftë të gjejë ndonjë dëshmi që Arka e Noes ka qëndruar në Malet Ararat.

Arkeologët Dr. Ron Wyatt, Paul Zimansky dhe të tjerë, kanë gjetur mbetje të fosilizuara të një objekti, që duket të ketë formën e një anijeje. Arkeologu Dr. Randall Price është i bindur se “arka” është një mashtrim për të zhvatur para nga Kristianët syleshë. Biologu Dr. Todd Wood i Kolegjit Bryan në Tennessee beson se mostrat e drurit të “Arkës së Noes” të gjetura në Turqi i përkasin një kohe shumë të vonshme...

Ka shumë çoroditje rreth fosileve dhe Arkës së Noes, prandaj i këshilloj lexuesit e mi që të marrin parasysh faktet dhe historinë, e cila ka të bëjë me Arkën e Noes dhe Malet Ararat, në vend që të marrin anë. Persianët e quajnë atë Kuh-e-Nuh, që do të thotë Malet e Noes, sepse Arka e Noes ngeli atje. Maja e Araratit të Madh, që thirret, gjithashtu, Masis prej Armenëve, është maja më e lartë e Azisë së Vogël dhe Mesopotamisë. Ajo ka qenë shumë më e lartë nga ç’është sot. Ajo shpërtheu më 1840 dhe shfaqja e shpërthimit, krateri, është akoma i dukshëm nga ana e Armenisë. Robert Ellis (1820 - 1885) ishte një studjues Anglez, i cili ka konfirmuar shpërthimin vullkanik të Malit Ararat. Emri Kurd për malin Ararat është Ciyaye Agiri, që do të thotë Mali i Zjarrtë. Kështu, Mali i Zjarrtë është shprehje e shpërthimit vullkanik të Araratit. Duke njohur pasojat shkatërrimtare të shpërthimeve vullkanike, do të mund të thonim që, edhe nëqoftëse ndonjë mbeturinë e Arkës do të kishte pasë mbijetuar përgjatë mijëvjeçarëve nga erozioni, ajo me siguri do të ishte shkatërruar përgjatë shpërthimeve vullkanike.

Ghameku ose Lameku u martua me Betenos (Libri i Ngjarjeve, Ngjarja 15) dhe nga kjo martesë lindi Noe. Noe dhe familja e tij i shpëtoi përmytjes së Madhe nëpërmjet Arkës, të cilën ai dhe familja e tij e ndërtuan në përputhje me fjalën e Zotit. Nga Noe rrodhën shumë kombe, përfshirë edhe popullin Nairi ose Noi-Ri. Ri

nënkupton burrë (mashkull) në gjuhët Ballkanike dhe Anatoliane, ndërsa Nai ose Noi është një tjetër variant i emrit Noe. Noe është quajtur, gjithashtu, Ksithusros ose Ziusudra prej Grekëve dhe prej popujve Mesopotamianë si nofkë apo mbiemër për të shpëtuarin nga Përmytja. (Shënim B.P.: Ziusudra – ai që i shpëtoi Përmytjes). Shumë kombe të ditëve tona shprehen se ata janë pasardhës direktë të Noes.

Ky libër do t'ju furnizojë me informacion dhe do të sqarojë me fakte historike dhe gjuhësore vlefshmërinë e atyre pretendimeve.

Sipas Biblës së Shenjtë, Libri i Gjenezës, Arka e Noes qëndroi mbi Malin Ararat, ku Noe dhe pasardhësit e tij ishte e shkruar prej Zotit t'i mbijetonin Përmytjes së Madhe dhe të ripopullonin botën. Noe dhe e shoqja patën shumë djem dhe vajza, të cilët nga ana e tyre, edhe ata, u bënë me shumë djem e vajza të tyre. Si Bibla ashtu edhe Libri i Gjenezës flasin për ta dhe emrat e vendndodhjeve të tyre mund të gjenden në territorin, që njihet si Malësitë Armene.

Sipas Ghevond Alishanit, Noe dhe djemtë e tij, Sem Zirvan, Ham Titan, dhe Xhafet Osti morën për gra nga pasardhësit e Setit dhe të vajzave të Noes: Astghik ose Astra (Astghik është emër Armen për femrat dhe ka kuptimin “Yll”) dhe Araza, me prejardhje nga fisnikëria e Setit. Astghik do të thotë “Yll” në Armenisht, dhe ajo është njohur si Astra nga historianët Grekë. Mbetet ende e panjohur nëse Astghiku u martua ndonjëherë; sidoqoftë, Araza ishte nëna e dy figurave mashkullore, e Skitës dhe Bretonit, prej të cilëve rrodhën Skithët dhe Bretonët. Shumë karaktere Biblike emërtohen si bij të Noes në Biblën e Shenjtë; kështu, p.sh., ka njëfarë paqartësie lidhur me faktin se kush është në fakt bir direkt i Noes dhe kush i përket pasardhësve të Noes. Burimet jo-Biblike, që kam mundur të has gjatë kërkimeve të mia, përmendin vetëm tre djem dhe dy vajza si fëmijë direkt të Noes. Të gjithë karakteret e tjerë Biblike rrjedhimisht duhet konsideruar se janë pasardhës të Noes.

\* \* \*

## Vendndodhja e Kopshtit të Edenit, ku jetuan Adami dhe Eva, si edhe pasardhësit e tyre

Kopshti i Edenit, që përmendet në Biblën e Shenjtë është një tjetër mister Biblik, të cilin shkencëtarët nuk arrijnë ta përcaktojnë, sepse Edeni nuk është emër vendi. Eden do të thotë Rrafshinë (Pllajë) në gjuhën Sumere dhe ka të njëjtin kuptim si edhe fjala *Dorë* (pëllëmbë ??) në gjuhët Ariane dhe Anatoliane. Kopshti i Edenit është e njëjta gjë me Sahand (Sa – nënkupton Tokë dhe Hand nënkupton Kopësht në gjuhën Persiane dhe atë Hurro-Urartiane), që nënkupton Toka e Kopshtit (ose Kopshti i Tokës). Sahandi ndodhej në veri-perëndim të Irakut, në lindje të liqenit Urmia. Pohimi i vendndodhjes së Kopshtit të Edenit është bërë në një artikull të titulluar “Parajsa e gjetur”. Ai u publikua në Jerusalem Report, në 01 Shkurt, 1999, bazuar në gjetjet e arkeologut David Rohl. Historia provon, që Sahandi dhe vende të tjera ndërmjet liqenit Urmia dhe Liqenit Kaspik kanë qenë prona të Medëve (Madaians). Ndodhet edhe një vend tjetër, që i afrohet përshkrimit të Kopshtit të Edenit. Ky vend quhet Albak në gjuhën Urartiane dhe Aghbak ose Albak në gjuhën Armene, në varësi të dialektit Armen. Albak, gjithashtu, ka qenë quajtur Ba'alBak dhe BelBak (El-Bak) në gjuhët e ndryshme të popullit Mesopotamas, që do të thotë Kopshti i Zotit apo i Perëndisë. Ail-Bak ose Ayl-Bak, në varësi të dialektit, nënkupton një tjetër Kopësht në gjuhën Armene. Albaku ka qenë vendosur në lindje të liqenit Van, në provincën Vaspurakan të Urartu-së dhe në Mbretërinë Armene pas-Urartiane. Albaku është gjithashtu një nga vendndodhjet e mundshme të Kopshtit të Edenit; sidoqoftë, unë besoj që Sahandi është një përjasje më e mundshme për vendndodhjen e identifikuar si Kopshti i Edenit. Ndoshta, Kopshti i Edenit është më i shtrirë nga sa njerëzit e mendojnë, dhe ka mundësi, ai mund të përfshijë Albakun dhe Sahandin bashkë, me shumë mundësi,

gjithashtu, edhe toka të tjera. Arsyeja përse Albaku është konsideruar një vendndodhje e mundshme e Kopshtit të Edenit bazohet në emrin e tij (Bak – ka kuptimin Kopësht në gjuhën Armene) dhe sepse ndodhet një qytet me emrin Adamakert në Albak dhe ky qytet është emëruar sipas Adamit. Adamakert – fjalë për fjalë – në gjuhën Armene do të thotë – i ndërtuar prej Adamit. Për faktin se në Malësitë Armene kanë ekzistuar edhe vende të tjera, që mbanin emrat e djemve dhe vajzave të Adamit, ne mund të pohojmë me më shumë saktësi, se ku kanë pasë jetuar në lashtësi Adami dhe fëmijët e tij. Unë jam i sigurt, se nëpërmjet arkeologjisë dhe kërkimeve, kjo çështje do të marrë vlerën e një fakti të provuar shkencërisht. Bibla e Shenjtë pohon, se pasi Zoti krijoi Tokën, Diellin, Universin, Ai krijoi edhe Adamin. Adami quhej, gjithashtu, edhe *Adamu* prej popujve të Mesopotamisë së Vjetër. *Dumu* nënkupton Bir në gjuhët Sumeriane, Babilonase, Assiriane dhe Hurro-Urartiane. Kështu, - *Adam* ose (*a*)*dumu* - nënkupton – Bir, pasi ai është krijuar prej Zotit, gjë që nënkupton se, ai ishte Bir i Zotit. Libri i Ngjarjeve (The Book of Jubilees) (Ngjarja 19) tregon se Adami jetoi 930 vjet.

\* \* \*

## E vetmja gjuhë që njerëzit flisnin në tokë

Një tjetër mister i përmendur në Bibël është se njerëzit flisnin një gjuhë të vetme deri në ndërtimin e Kullës së Babelit, dhe Zoti i ndryshoi gjuhët e tyre, në mënyrë që ata ta kishin të pamundur të komunikonin mes tyre, dhe të ndalonin ndërtimin e Kullës së Madhe, e cila do të lidhte Tokën me Parajsën.

E vërteta është se njerëzit që jetonin në jug të maleve të Kaukazit, në Azinë e vogël, dhe në Lindjen e Mesme, flisnin një gjuhë. Shumë gjuhëtarë dhe dijetarë e quajtën këtë gjuhë si gjuha Primitive ose Protogjuha. Për më tepër informacion mbi Protogjuhën e njerëzve

të lashtë, ju lutem referojuni shkrimit “Historia e hershme e gjuhëve Indo-Europiane”, e shkruar nga Tamaz V. Gamkrelidze dhe Vyacheslav V. Ivanov.

Gjuha e lashtë Trake, gjuha Cimeriane, dhe ajo Sumeriane ishin ndër dialektet e shumta të së njëjtës gjuhë, që flitej nga Gomeri, nga paraardhësit dhe pasardhësit e tij, dhe nga populli Nairi ose Noy-ri. Nairi ose Noy-ri do të thotë të afërmit e Noes në gjuhët Ariane dhe Anatoliane. Populli Trak ishin populli i Tirasit. Ata ishin pasardhës të Tirasit, Gomerit, dhe Xhafetit (Japhethit); ndaj, ata ishin, gjithashtu, pasardhës të Noes. Torgomi dhe Hajku ishin pasardhës të Gomerit; prandaj, ata flisnin të njëjtën gjuhë, që kishin folur Noe dhe Xhafeti. Kur Tirasi vdiq, Kushi dhe pasardhësit e tij u zhvendosën nga Afrika e veriut dhe Egjipti drejt Mesopotamisë (kjo shpjegon teorinë sipas së cilës njerëzit e lashtë e kanë origjinën në Afrikë dhe më pas ata lëvizën drejt Mesopotamisë dhe pjesëve të tjera të botës) dhe aty themeluan një mbretëri të re me kryeqytet Babelin, i cili më pas mori emrin Babiloni.

Sipas Geoge Rawlinson (George Rawlinson ishte vëllai i dijetarit britanik Sir Henry Rawlinson) dinastia Burbur (Burburët e Akadit) e Shinarit u shkurorëzua nga Kushitët, kur Kushi dhe ushtritë e tij pushtuan Babiloninë. Duke cituar Herodotin, George Rawlinson, gjithashtu, deklaroi se fisnikët e dinastisë Burbur ishin të lidhur me anë të emrit, fesë dhe gjuhës me njerëz të rëndësishëm të Armenisë të quajtur Alarodianë. Ndaj, Alarodianët ishin fisnikë të rëndësishëm të Armenisë. Edhe pse shumë dijetarë u munduan të paraqisnin Alarodianët si njerëz të Kaukazit verior, George Rawlinson, Michael Herzfeld, dhe dijetarë të tjerë i vendosën Alarodianët në tokat e lumit Arsanas ose Arzanas (Aratsani në gjuhën Armene) dhe ndër fiset kryesore të mbretërisë Urartu. Kërkime të mëtejshme mbi fisnikët Alarodianë konfirmuan se Alarodianët kishin lidhje me popullin Udi. Në punën e tij, ‘Pesë Monarkitë e Mëdha’, George Rawlinson deklaroi se kur Kaldeanët zotëruan mbi Babiloni, Babilonasit folën “arba lisun” ose “katër gjuhë”, dhe ajo çfarë është interesante është

fakti se “Lezu” do të thotë “Gjuhë” në Armenisht dhe “Lezuner” do të thotë “disa Gjuhë”. Fjala “chors” (çors) që do të thotë “katër” në Armenisht, është një fjalë e huazuar nga gjuha Farsi, që zëvendësoi fjalën e gjuhës së lashtë Armene për “katër”. Çfarë e bën edhe më interesante është fakti, që fjala “arba” (fjala e lashtë për fjalën “katër”) mbijetoi në gjuhët e Europës Perëndimore. Arbalest, që është një lloj harku gjuetie (hark në formë kryqi), është një armë e cila ka katër pika. Ky është një shembull perfekt, që tregon se fjala “arba” do të thotë “katër”.

Nmrodi, djali i Kushit, ftoi shumë njerëz në Babiloni për të punuar në ndërtimin e Kullës së madhe (Kullës së Babelit), e cila duhej të lidhte Tokën me Qiellin. Kjo lëvizje e njerëzve nga Afrika dhe vende të tjera ndihmoi në zhvillimin e shumë gjuhëve të reja, të cilat filluan të lulëzojnë në atë zonë. Si pasojë, njerëzit filluan të mos merreshin vesh me njeri tjetrin. Për ironi të fatit Kulla e Babelit dështoi, pjesërisht për gabime në projektim dhe arsye të tjera, dhe ajo u la ashtu e pambaruar...

Është fakt i njohur, që pjesa më e madhe e historisë së vjetër, e cila arriti të mbijetojë, është shkruar nga Egjiptianët, Sumerianët, Babilonasit, Akkadianët, Hittitët, Assirianët, Hurro-Urartianët, Medët, Persianët, Grekët, Romakët, dhe shumë të tjerë. Si rrjedhim, emrat e njerëzve dhe vendeve u Helenizuan ose u Romanizuan, ose pësuan ndryshime në varësi të historianëve, që shkruan historinë. Emrat e djemve dhe pasardhësve të Noes, gjithashtu, u Helenizuan prej historianëve Grekë ose u ndryshuan prej historianëve me prejardhje të ndryshme.

Diferenca në shqiptimin e emrave erdhi prej Assirianëve, Hurro-Urartianëve dhe popujve të tjerë, që përdornin alfabetin Assirian ose të ngjashëm me të; kështu, u krijua konfuzion me germat. Germat, si p.sh. G dhe C shpesh ngatërroheshin me K; H dhe Ch zakonisht ngatërroheshin me Kh; B dhe P me B dhe V; gjithashtu Ph me F; I dhe Y me E; S me Sh; D dhe T me Th; U shpesh përdorej për O; dhe L

shpesh përdorej për Gh, pasi alfabeti Assirian dhe ai Hurro-Urartian nuk kishin O dhe Gh, etj. Çoroditja me germat dhe gramatikën Hurro-Urartiane vazhdon akoma edhe sot në Dialektin Perëndimor të gjuhës Armene, sepse ajo nuk pësoi aq shumë ndryshime sa ç'pati fatin të pësojë dialekti Armeno Lindor. Unë nuk jam duke folur vetëm për çoroditjen me germat në gjuhën Armene, pasi mua më duhet ta pohoj ndershëmrisht, që ka një çoroditje të germave edhe ndërmjet gjuhëve të tjera, gjithashtu. Për shembull, çoroditja e germave gjendet edhe tek përdoruesit e gjuhës Latine, Angleze, dhe gjuhëve të tjera, që janë aktualisht në përdorim në mbarë botën. Shkaqet e këtij fenomeni mund të gjenden duke studjuar gjuhët e lashtë të Egjiptit ose Mesr, Mesopotamisë, popujve Kaukazianë, popujve Arianë, dhe popujve të Ballkanit, dhe duke i krahasuar ato me gjuhët e tyre të kohës së sotme. Unë jam i sigurt se, studimi i gjuhëve do të tregojë ndryshimin e të njëjtës gjuhë sipas etapave kalimtare nga gjendja e saj në kohët më të lashta deri në ditët e sotme. Gjithashtu, është emocionuese të shohësh se si ndryshojnë gjuhët sa më tepër i largohen vendit të origjinës, vend të cilin shumë gjuhëtarë dhe studjues e vendosin në Malësitë Armene, pasi Arka e Noes u ul mbi Malin Ararat (Shih Gjenezë 8:4) dhe rrjedhimisht Malësive Armene u takon të njihen si djepi i civilizimit.

\* \* \*

Gjuhët Indo-Europeanë dhe ajo Armene një herë e një kohë kanë qenë e njëjta gjuhë

Për gjuhëtarët dhe studjuesit paraqet interes edhe fakti që gjuha Angleze, Uellsiane, Gjermane, si edhe gjuhë të tjera kanë fjalë, të cilat jo vetëm tingëllojnë të ngjashme, por gjithashtu kanë të njëjtin kuptim si edhe në gjuhën Armene, gjë që tregon, që folësit e gjuhës Armene ose të gjuhëve të afërta me të kanë arritur deri në Britaninë e Madhe dhe Indi. Prej këtej rrjedh edhe termi Gjuhët

Indo-Europiane. Bretonët kanë pohuar se paraardhësit e tyre kanë ardhur nga Armenia. Indianët kanë influenca nga disa drejtime në kohë të ndryshme të historisë.

Robert Ellis në librin e tij, “Origjina Armene e Etruskëve”, demonstroi shumë bukur ngjashmëritë gjuhësore të shumë gjuhëve të ndryshme, që kanë gjurmë të origjinave të tyre prej gjuhës Armene. Për ata, që janë të interesuar të gjejnë diçka më tepër rreth lidhjeve gjuhësore të gjuhëve të ndryshme, mund të lexojnë këtë libër.

Tani le të ndjekim gjurmët e gjuhës Armene në pjesë të ndryshme të Kontinentit Eurazian (Euro-Azia).

Këtu janë disa shembuj të fjalëve Armene në Anglisht:

*Aksel* në Anglisht dhe *Ak* në Armenisht ka kuptimin *Aks*,

*Door* në Anglisht dhe *Dur* në Armenisht ka kuptimin *Derë*,

*Kau* në Anglisht dhe *Kov* në Armenisht ka kuptimin *Lopë (kau)*,

*Kat* në Anglisht dhe *Katu* në Armenisht ka kuptimin *Mace*,

*Center (Centre)* në Anglisht dhe *Kentron* në Armenisht ka kuptimin *Qendër*,

*Hund* në Anglisht dhe *Shun* në Armenisht ka kuptimin *Qen*,

*Nstel* në Armenisht ka kuptimin *Nest ose to Sit* në Anglisht (*me ndejtë*),

*Lsel* në Armenisht ka kuptimin *to Listen* në Anglisht (*me ndigjue*),

*Hents ose Henc* në Armenisht ka kuptimin *Hence* në Anglisht (*prej këtej, rrjedhimisht, etj*),

*Skjurr* në Armenisht ka kuptimin *Squirrel* në Anglisht (ketër)...

Këtu janë disa shembuj fjalësh, që tregojnë gjurmët e gjuhës Armene në gjuhën Uellsiane (Uells):

*Ty* (Ti) në Uells dhe *Tun* në Armenisht kanë kuptimin *Shtëpi*

*Gwin* (Xhuin, Xhin) në Uells dhe *Gini* (shqiptuar si gii-nii) në Armenisht kanë kuptimin *Verë*,

*Carreg* ose *Garreg* në Uells dhe *Kar* në Urartian, gjithashtu *Kar*, *Car*, *Gar*, ose *Qar* (ka shumë mënyra për të shqiptuar fjalën *Qar*, në varësi të dialektit Armen) në Armenisht kanë kuptimin *Gur*.

*Mis* në Uells, *Mu* në Urartian, dhe *Amis* në Armenisht kanë kuptimin Muaj.

Këtu janë disa shembuj fjalësh, që tregojnë gjurmët e gjuhës Armene në gjuhën Gjermane:

*Kuh* në Gjermanisht dhe *Kov* në Armenisht kanë kuptimin *Lopë (Ka)*, *Durch* në Gjermanisht dhe *Dur* në Armenisht kanë kuptimin *Derë*,

*Achse* në Gjermanisht dhe *Ak* në Armenisht kanë kuptimin *Aks*, *Lauschen* në Gjermanisht dhe *Lsel* në Armenisht kanë kuptimin “*me ndigjue*”,

*Katze* në Gjermanisht dhe *Katu* në Armenisht kanë kuptimin *Mace*, *Hund* në Gjermanisht dhe *Shun* në Armenisht kanë kuptimin *Qen*.

Këtu janë disa shembuj fjalësh, që tregojnë gjurmët e gjuhës Armene në gjuhën Latine dhe Spanjolle:

*Cannabis* në Latinisht dhe *Kannep* në Armenisht kanë kuptimin “*Kërp*”, *Centro* në Spanjisht dhe *Kentron* në Armenisht ka kuptimin *Qendër*, *Gatto* në Spanjisht dhe Latinisht, si edhe *Katu* në Armenisht, kanë kuptimin *Mace*,

*Jubileum* në Latinisht dhe *Hobelian* në Armenisht ka kuptimin *Përvjetor, festim përvjetori, ngjarje festive*

*Sciurus* në Latinisht dhe *Skjurr* në Armenisht ka kuptimin *Ketër*

Këtu janë disa shembuj fjalësh, që tregojnë gjurmët e gjuhës Armene në gjuhën Greke:

*Gata* në Greqisht dhe *Katu* në Armenisht kanë kuptimin *Mace*, *Kentron* në Greqisht dhe *Kentron* në Armenisht ka kuptimin *Qendër*, *Skiouros* në Greqisht dhe *Skjurr* në Armenisht ka kuptimin *Ketër*

Këtu janë disa shembuj fjalësh, që tregojnë gjurmët e gjuhës Armene në gjuhën Hebraje:

*Ari* në Hebraisht dhe *Arjux* në Armenisht ka kuptimin *Luan*,  
*Khatuul* në Hebraisht dhe *Katu* në Armenisht kanë kuptimin *Mace*,  
*Shophar* në Hebraisht dhe *Sheppor* në Armenisht ka kuptimin  
*Trumpetë*,

*Jovel* në Hebraisht dhe *Hobelian* në Armenisht ka kuptimin  
*Jubilee*, (*ose ngjarje festive*)

Këtu janë disa fjalë Armene të huazuara nga gjuha Farsi:

*Aspbod* në Farsi dhe *Aspbed* në dialektin Armeno-Perëndimor ose *Aspet* në dialektin Armeno-Lindor nënkupton *Kalorës (fisnik)*.

Sidoqoftë, fjala *Muush* në Farsi dhe *Muug* në dialektin Armeno-Perëndimor ose *Muuk* në dialektin Armeno-Lindor nënkupton *Mi*, dhe përfundimisht ka një origjinë Armene.

Për fat të keq, gjuhët Farsi dhe Iraniane kanë një ndikim të konsiderueshëm Arabik; prandaj është e vështirë të gjenden gjurmë Armene në gjuhën Farsi dhe ato Iraniane. Unë shpresoj, se lexuesit e mi mund ta dallojnë ngjashmërinë në kuptim dhe tingëllim (shqiptim) në bërthamën e fjalëve bazike primitive në këto gjuhë! Kështu, ngjashmëritë në kuptim dhe tingëllim të fjalëve primitive në këto gjuhë japin të kuptosh se këto gjuhë janë e njëjta, ose të ngjashme me njera tjetrën, në një kohë të caktuar të historisë së lashtë.

Kjo do të thotë, se gjuha më e vjetër, ose gjuha më e shumicës së gjuhëve Indo-Europiane, është gjuha e vjetër Armene, dhe popujt Indo-Europianë janë i njëjti popull, ose të afërt me njeri tjetrin. Kjo afërsi gjuhësore dhe tregimet Biblike, sipas të cilave popujt flisnin një

---

Shënim G.N.: Ju lutem, referojuni: [translate.google.com](https://translate.google.com), n.q.s. dëshironi të verifikoni përkthimin e fjalëve të sipërlistuara.

gjuhë dhe që Arka e Noes qëndroi në Malet Ararat, lënë të kuptosh, se djepi i civilizimit në Tokë janë Malësitë Armene.

Ka shumë punime të bëra nga gjuhëtarë të ndryshëm, të ekspozuara në biblioteka dhe librari, të cilat mund të kënaqin kuriozitetin e lexuesve, të cilët janë të interesuar të mësojnë më shumë rreth gjuhëve dhe gjuhësisë. Ju lutem, keni gjithë të drejtën të bëni kërkimet tuaja në këtë fushë.

\* \* \*

## Emri i vërtetë i liqenit Urmia ishte liqeni Blu

Emri Armen për Liqenin Urmia ishte Kaputan Liç\*, nga fjala Armene “Kaput”, që do të thotë “blu” (Azur gjithashtu do të thotë blu) dhe fjala Armene “Liç” që do të thotë “Liqen”, pra si rrjedhojë emri Liqeni Blu. Libri i Ngjarjeve (The Book of Jubilees) deklaroi se Avani (Liqeni Van mori këtë emër nga Avani) dhe Azura (Liqeni Azur mori këtë emër nga Azura) ishin bijat e Adamit dhe Evës. Bibla e Shenjtë, Libri i Ngjarjeve, dhe burime të tjera letrare pohojnë se Abeli, Kaini dhe Sethi ishin bijtë e Adamit dhe Evës.

Emri i Liqenit Kaputan ose Liqenit Blu (Azur) ishte riemëruar Urmia ose Urmia nën sundimin Arab. Urmia do të thotë (Urmia dhe Mia-ujë në gjuhët Arabe dhe Siriake) Toka e Ujit dhe ishte fillimisht emri i qytetit Urmia, i njohur si një Qyteti i Ujit, ose Toka e Ujit, për shkak të vendndodhjes së tij, dhe më vonë këtë emër e mori dhe Liqeni. Përveç Medëve ose Medianëve, grupe të tjera etnike jetonin gjithashtu në tokat përreth Liqenit Urmia. Për

---

\* Shënim B.P.: Në gjuhën Armene emri “Liqeni Blu” shkruhet: “Գապուտյան լիճ” dhe lexohet:

Në Dialektin Armeno Lindor:	Kapujt Liç
Në Dialektin Armeno Perëndimor:	Gabujd Lixh

shembull, Medianët jetonin në tokat në jug të Liqenit Urmia, Marët ose populli Mar jetonte në tokat në perëndim të Liqenit Urmia, pasardhësit e vëllait të Hajkut, Herosit, të njohur si fisnikët Heruni ose Herheruni në historinë Armene, jetuan në Her (aktualisht Koj, IRAN) dhe në toka të tjera në veri të Liqenit Urmia, populli Azhi (Azhi do të thotë gjarpër në gjuhët Arjane, dhe ata u quajtën Azhi, pasi ishin adhurues të gjarpërinjve) jetonin në tokat në lindje të Liqenit Urmia, etj...

\* \* \*

### Gjurmë të adhurimit të Perëndisë së Pjellorisë

Mjafton pak logjikë për të dalluar ngjashmëritë midis emrit Shinar ose Sin-Ar të Sumerianëve, emrit të qytetit Shnav ose Sen-Av të popullit Mar, liqenet Desna dhe Sosna, gjithashtu Vesna të Cimerianëve (aktualisht Sllav ose Ukrainas) kanë të njëjtën Sna, Sina, dhe Sena, që do të thonë Zot, Perëndi dhe Hyjni. Sin, Sina, Sine, ose Sini ishte perëndia ose perëndesha e pjellorisë, lindjes dhe krijimit. Sina adhurohej si një perëndi ose perëndeshë hënë nga njerëzit e lashtë, sepse hëna ose cikli hënor përdorej si një formë kalendari; ndaj, ishte tejet e rëndësishme në ato kohë. Ekzistenca e Malit Sinai në Gadishullin Sinai, Mesina në Siçili dhe Siena në Toskanë të Italisë, Sena në Aragon të Spanjës, dhe Senja në Norvegji provojnë, se adhurues të këtij/kësaj perëndie ose perëndeshe të lashtë jetuan në një sipërfaqe, që shtrihej nga Gadishulli Sinai, pranë Egjiptit, deri në Norvegji në Skandinavi, dhe nga Lindja e Mesme deri në Europën Perëndimore.

Fjalët “Senat” dhe “Senator” shoqërohen me Senën. Emri Armen Lusín (Lu-Sin) do të thotë person i Sinës ose adhurues i Sinës në gjuhën Sumeriane. Mbiemri Armen Sinanian, po ashtu, ka kuptim të ngjashëm në gjuhën Persiane dhe atë Armene. Emrat Lusín dhe Arsin janë emra të zakonshëm Armenë. Ekzistonte një “Uji Manasna

ose Lumi Manasna” në Krahinën Aghdznik ose Aldznik të mbretërisë Armene, që ishte një degë furnizuese e Lumit Tigër. Gjithashtu, ekzistonte një qytet i quajtur Sakasena ose Sakashen në Krahinën Uti ose Utik të Urartu-së dhe Armenisë. Këto dhe fakte të tjera janë tregues se Armenët, Sumerët, Cimerët, Thrakët, dhe popuj të tjerë të afërt ishin folësit fillestarë të Protogjuhës dhe adhurues të perëndisë ose perëndeshës së lashtë Sina ose Sine. Emrat Europeanë si, Zena, Ksina ose Ksenia janë variante të ndryshme të Sinës. Lumi Sena ose Seine dhe Lumi Armankon (Armankoni është degë furnizuese e Lumit Sena) në Francë tregojnë se adhurues të perëndisë, ose të perëndeshës të emërtuar Sena ose Sina, jetonin edhe në Francë. Disa dijetarë, gjithashtu, e lidhin emrin Kina me emrin Sina; megjithatë, saktësia e kësaj nuk është verifikuar ende...

Populli Asur (Asirianët) kishin mbretër me emra Senakerib dhe Naram-Sin. Urartianët kishin Lugal-Sin ose Lugal-Sini, që do të thotë Mbreti-Zot. Cimerianët përdornin fjalën Lugal dhe Sumerianët kishin fjalën Lugal Banda (Lugal do të thotë Mbret; nga Lu - person dhe Gal ose Gag - fron, në gjuhët Cimeriane, Sumeriane dhe Hurro-Urartiane, dhe ishte e njëjtë me Gah në gjuhët Persiane dhe Armene, pra mbreti është Personi mbi Fron) me të njëjtin kuptim. Cimerianët dhe Hurro-Urartianët përdornin fjalën “KUR”, që do të thotë “tokë”. Sumerianët përdornin fjalën “Ur” ose “(k)Ur” dhe Hurro-Urartianët po ashtu përdornin fjalën “(k)Ur”, e cila gjithashtu do të thotë “tokë”; kështu, këto fjalë lidhin së bashku gjuhët e këtyre civilizimeve të lashta. Fatkeqësisht, unë nuk jam një gjuhëtar, dhe nuk munda të gjeja më tepër fjalë, që do të provonin faktin, se këta popuj flisnin dialekte të ndryshme të së njëjtës gjuhë; megjithatë, ka mjaftueshëm prova për të mbështetur këtë teori. Ndaj, adhurimi i perëndisë ose perëndeshës Hënë, Sina ose Sin, mund të lidhet edhe me astro-teologjinë, pasi shumë nga popujt e lashtë besonin në trupat qiellorë. Për shembull, Helenët dhe Romakët praktikonin po ashtu astro-teologji, sepse ata i vunë emra planetëve dhe i adhuruan si perëndi.

\* \* \*

## Rreth Sumerianëve, Marëve, Cimerianëve, Thrakëve dhe kombeve të tjera

Ka të dhëna më se të mjaftueshme (bazuar në faktorët historikë, gjuhësorë, kulturorë dhe religjözë) kundër pretendimeve, që Sumerianët kanë qenë një popull Semitik duke qenë se Sumerianët kanë qenë pjesë e Perandorisë Akkadiane, ose pretendimeve se Cimmerianët flisnin një gjuhë Turke duke qenë se Cimmerianët (Kimmerianët) ishin një tribu Skithe. Pretendimet se Sumerianët kanë qenë një popull Semitik dhe pretendimet se Cimmerianët dhe Skithët flisnin një gjuhë Turke janë pa baza, pasi ata nuk janë i njëjti popull. Edhe pse Sumerianët u pushtuan nga Kushitët dhe popujt Hamitikë, dhe më vonë edhe nga popujt Akkadianë dhe Semitikë, Sumerianët e ruajtën gjuhën e tyre dhe identitetin e tyre kombëtar, gjë që i bëri ata të jenë të ndryshëm. As Cimmerianët dhe as Skithët nuk mund të konsiderohen si Turq të lashtë, sepse Cimmerianët flisnin një gjuhë, që ishte e afërt me atë Hurro-Urartiane dhe atë Sumeriane, dhe Skithët flisnin një gjuhë, që i përkiste grupit të gjuhëve të Iranit Verior. Grupi i gjuhëve të Iranit Verior nuk kishte lidhje afërie me gjuhët Altaike (Turke). Hungarezët, Khazarët, Turqit dhe popuj të tjerë Turanianë flisnin dialekte të ndryshme të gjuhës Turke, dhe gjuha Turke është një nëngrup i gjuhëve Altaike. N.q.s Cimmerianët do të kishin folur një gjuhë Turke, atëhere përse gjuha Uellsianë\* (populli i Uellsit e quan gjuhën e vet Gomereg dhe vendin e tij Uells, Kumru ose Gymru, e cila është një formë e fjalës Gimmerian ose Cimmerian) nuk është konsideruar si gjuhë Turke? N.q.s. Skithët dhe Sarmantët\* (populli Polak dhe ai Ukrainas e konsiderojnë veten si pasardhës të Skitho-Sarmantëve) flisnin një gjuhë Turke, atëhere përse gjuhët Polake dhe Ukrainase nuk janë konsideruar si gjuhë Turke? Përgjigja është e thjeshtë dhe e qartë: sepse Turqit nuk janë të njëjtë me Uellsianët, Polakët dhe

Ukrainasit, dhe ideja se Cimmerianët dhe Skithët na paskan folur gjuhën Turke është absurde.

Kur Skithët e zgjeruan perandorinë e tyre drejt perëndimit, ku jetonin Cimmerianët, Skithët pushtuan dhe shkatërruan gjithçka që ishte Cimmeriane. Cimmerianët e lanë vendin e tyre dhe gjetën strehim në pjesë të tjera të Europës dhe Azisë së Vogël. Skithët madje hynë në Azinë e Vogël në ndjekje për të vrarë ata Cimmerianë, që gjetën strehim në Kappadokia dhe në Armeninë e Vogël. Përse do të duhej, që Skithët të kërkonin shkatërrimin e plotë të Cimmerianëve, n.q.s. Cimmerianët do të ishin pjesë e tribuve Skithe? Kjo nuk ka kuptim. Fakti, që Skithët shkaktuan shkatërrimin në masë të Cimmerianëve, është përshkruar nga Herodoti (Libri I: Klio) dhe nga historianë të tjerë; nga këtu rrjedh që, Cimmerianët nuk ishin tribu Skithe, dhe që as Cimmerianët dhe as Skithët nuk flisnin gjuhë Turke. Gjithashtu, Thrakasit ishin një tribu Cimmeriane, sepse Tiras ishte djali i Gomerit; kështu, të pohosh që Thrakasit dhe Trojanët janë Turq etnikë është gabim.

Ka studjues, të cilët kanë deklaruar, që Togarmahu ose Torgomi ka qenë paraardhësi i popullit Turk; sidoqoftë, këta studjues janë diskredituar nga burime më me emër. Për shembull, pohimi që Mbreti i Khazarëve, Josif (Joseph) ben Aaron, ka deklaruar se është pasadhës i Togarmahut, është përgënjeshtuar prej shumë studjuesve Hebrenj, sepse Mbreti Josif ben Aaron ka deklaruar të jetë djali i Obediah, i cili është pasardhës i Bulanit. Rabbi Jehudah ben Barzilai paralajmëroi lexuesit e tij rreth vërtetësisë së letrës së Mbretit Josif ben Aaron dërguar Hasdai ibn Shaprut (Hasdai bar Isaak bar Shaprut) dhe hebrenjve të Spanjës; kështu, letra e Mbretit Josif ben Aaron nuk duhet konsideruar një burim i besueshëm. Gjithashtu, shumë historianë kanë vërtetuar, që Khazarët kanë qenë një konfederatë popujsh Turq dhe të afërm me ta dhe (bazuar në histori dhe fakte) ashtu kanë qenë. Josif ben Gorion ka deklaruar, se Togarmahu ka qenë i bashkuar me popujt Turq; sidoqoftë, e vërtetë është, se popujt Turq pretendojnë të jenë pasardhës

të Nimrodit Biblik, Mbretit Atropatene, Atilës së Hunëve, dhe çdokujt të fuqishëm e të famshëm. Le të trajtojmë faktet, përpara se të japim opinionin tonë lidhur me këtë çështje. Fakt është, që Josif ben Gorion është diskredituar si shkrimtar nga Biblioteka Virtuale Hebreje ([JewishVirtualLibrary.org](http://JewishVirtualLibrary.org)) në artikullin e titulluar: Jossipon, dhe nga Enciklopedia Hebreje ([JewishEncyclopedia.com](http://JewishEncyclopedia.com)) në artikullin e titulluar: Joseph ben Gorion. Joseph ben Gorion është diskredituar nga Franz Delitzch, dhe studjues të tjerë si një shkrimtar me plot gabime historike dhe për të dhëna shtesë fiktive. Besimi se Togarmah ose Torgom është paraardhësi i popullit Turk është diskredituar, gjithashtu, edhe prej burimeve Kristiane dhe burimeve të tjera jo-Biblike. Për më tepër informacion rreth Togarmah ose Torgom dhe bijve të tij, ju lutem drejtoju kreu “Populli Armen dhe popujt e afërt me të” të këtij libri.

\* \* \*

## Thrakët e lashtë, Kushitët, dhe Qytetërime të tjera

Xhon Denison Balduin (John Denison Baldwin) në shkrimin e tij “Kombet Pre-Historike” ka shkruajtur se Kushitët kanë qenë “adhurues të gjarpërit” dhe historia provon se populli Azhi (Shih fjalorin në fund të librit për termin Azhi) ka qenë, gjithashtu, adhurues i gjarpërit; nga kjo, unë shoh një lidhje ndërmjet popullit Kushit dhe atij Azhi. Populli Azhi fillimisht shfaqet si një tribu e ndryshme prej Medëve (Madajanëve). Ata u vendosën në tokat në lindje të liqenit Urmia afërsisht në të njëjtën kohë, kur Kushitët dhe aleatët e tyre e zgjeruan perandorinë Kushite dhe influencën e tyre në Lindjen e Mesme. Azhitë u bënë tributë udhëheqëse të Medëve (Madajanëve). Astiazh ose Azhi-Dahakes (Azhi-Dahaka në mitologjinë Persiane ose Azhdahak në mitologjinë Armene) ishte mbreti i fundit i popullit Azhi. Astiazh ra nga fronin (referuar shkrimeve të Herodotit dhe Moisi Korenacit) prej forcave të

bashkuara të Mbretit Kir të Persisë, Mbretit Tigran Jervanduni të Armenisë, dhe aleatëve të tyre.

Shumë studjues dhe historianë e identifikojnë popullin e Marit, popullin Mannai ose Manaian, popullin Mittani dhe popuj të tjerë vendas, në tokat përreth liqenit Urmia, si populli Med ose Madajan; sidoqoftë, historia dhe faktet provojnë, që këta popuj dhe civilizime bashkëekzistuan, deri sa Medët i mposhtën ata të gjithë dhe e shtrinë perandorinë e tyre deri në lumin Halis në Azinë e Vogël. Medët ose Madajanët ishin pasardhës të Madai. Mannai ose Mannajanët ishin pasardhës të Manitonit. Mittanët ishin popull Hurrian. Gjithashtu, Herodoti pohon, se kur Deioces, paraardhësi i Astiazhit apo Azhi-Dahakes, i bashkoi Medët në një komb dhe mbretëroi mbi ta, Medët përbëheshin nga Busae, Paretaci, Struchates, Arizanti, Budii dhe Magi. Kështu, të konsiderosh Mari, Mannaeenët, Mittanët dhe të tjerë si Medë apo Madajanë do të ishte një gabim historik. Fakt është se populli Mar apo Mari janë pasardhës të Gomer apo Gamirit. Populli Mar apo Mari janë i njëjti popull apo i afërt me Sumerianët, Thrakët dhe Cimmerianët, sepse ata kanë të njëjtin paraardhës. Kështu, populli Mar apo Mari fliste të njëjtën gjuhë apo të afërt me atë të popullit Hurrian, Nairi, Sumerian, Cimmerian dhe Thrak. Nairi, Huri, Mari dhe Mariam janë emra të zakonshëm Armenë. Vendbanime, siç është Mardastani, Marand, Marastan, Mardali, Martuni, Martunashe, Marash, Maravan, Mardakert dhe vende të tjera në Armeni dhe në Iranin e veriut i kanë marrë këta emra nga populli Mar. Gymri ose Gumri e ka marrë emrin nga Cimmerianët apo Gimmerianët, që ishin populli i Gomer apo Gamirit. Shumë emra familjesh (mbiemra) e kanë origjinën nga populli Mar. Njerëz me mbiemër Marutean, Maribian, Mariphian, Maraphian, Mardikian, Martinian dhe emra të tjerë të tillë të ngjashëm e kanë prejardhjen tek populli Mar apo Mari.

\* \* \*

## Navasardi dhe Tradita të tjera

Të gjithë i njohin Lojrat Olimpike; megjithatë, pak njerëz e njohin kuptimin e Navasardit dhe Lojrat e Navasardit. Të dhënat më të hershme të Lojrave Olimpike janë shkruar nga Pausanias në Olimp të Greqisë në vitin 776 p.e.s. Më e mahnitshme është se Lojrat e Navasardit i paraprijnë Lojrat Olimpike me afërsisht dy mijëvjeçarë. Navasardi ose Nauazardi do të thotë “Dekoratat e reja” në gjuhën Ariane. Ajo shenjonte ditën e parë të muajit të parë të një Viti të Ri në kalendarin e lashtë Armen, dhe festohej gjatë javës së dytë të Gushtit duke nderuar fituesit e Lojrave të Navasardit me dekorata të reja, deri kur Kalendari Julian u pranua në Romë në vitin 46 p.e.s. dhe në krahina të tjera të Perandorisë Romake, duke përfshirë Armeninë. Navasardi nuk kishte të bënte me një ekuinoks ose Solstic Veror, dhe ishte një mister edhe për vetë Armenët, se përse Navasardi, dita e parë e Vitit të Ri Armen në lashtësi, festohej në Gusht. E vërteta është se Navasardi ishte dita që shenjonte kthimin në vendlindje të Hajkut dhe pasardhësve të tij. Sipas historianëve Armenë, Ghevond Alishan dhe Katolikos (Kathoghikos) Hovhannes Draksanakerci, ishte një ditë Gushti, e bukur dhe me diell, 2500 vite para lindjes së Jezu Krishtit, kur Hajku dhe treqind trimat e tij, bashkë me familjet, e tyre u kthyen nga Babilonia. Navasardi u festua gjatë javës së dytë të Gushtit. Navasardi ishte një ditë e rëndësishme për Armenët e lashtë, sepse Hajku solli nisma të reja kur u kthye. Hajku dhe aleatët e tij ishin heronj legjendarë dhe ata u bënë paraardhësit e Armenëve dhe popujve të afërt me ta.

Shumë burime letrare shkruajnë se Anahiti (Anahita ose Nahid në gjuhën Persiane) ishte perëndesha e bukurisë, pjellorisë, shërimit dhe e ujrave e Armenëve Paganë, dhe ajo ishte e lidhur me festimin e Navasardit, dhe se Lojrat e Navasardit u dedikuan në nder të saj. Anahiti adhurohej si nga Persianët e lashtë, ashtu dhe

nga Armenët e lashtë. Ndaj, ajo ishte e adhuroar kudo në Persi, Armeni, Mesopotami dhe në Azinë e Vogël. Anahiti adhurohej së bashku me Aramazdin. Aramazdi ose Aram-Yazd njihej, gjithashtu, si Ahura Mazda, perëndia Zoroastriane. Disa dijetarë pretendojnë, se Anahiti dhe Aramazdi kanë depërtuar në popullin Armen nëpërmjet Arshakunit dhe mbretërve Partë. Të tjerë pohuan, se Aramazdi ishte i njëjtë me Aramaneakun dhe se Anahiti ishte bashkëshortja e tij. Aramazdi festohej në ditën e Ekuinoksit Pranveror (Viti i Ri Persian quhet Novruz, dhe Persianët e festojnë atë në ditën e Ekuinoksit Pranveror) dhe Anahiti festohej gjatë Navasardit. Shumë tempuj u ndërtuan në nder të perëndisë dhe perëndeshës Zoroastriane. Një mal në Krahinën Siunike u quajt Aramazd dhe një mal në Krahinën Sofene (Tsopk) u quajt Anahit. Armenët e lashtë mund të kenë festuar Navasardin për të nderuar Anahitin për të njëjtën arsye, që Kishat Katolike Romake festojnë Krishtlindjen në 25 Dhjetor, e cila ishte fillimisht data e festimit të Ditës së perëndisë Pagane Saturn nga Romakët. Të Krishterët e Lindjes dhe ata Ortodoksë e festojnë Krishtlindjen në 6 Janar, pasi ajo është dita e vërtetë e Krishtlindjes. Shpeshherë, një kremtim i një feje të vjetër, të cilën njerëz të të njëjtit grupi etnik ose fetar dëshironin të festonin (e cila do të ishte e papërshtatshme të festohej nën një urdhër strikt konservativ të Krishterë, ose urdhrit Zoroastrian në atë kohë, që ishte po aq strikt) paraqitej në përshtatje me një fe të re, në mënyrë që të ruhej festimi i atij kremtimi. Shembull për këtë është Dita e Krishtlindjes e Kishës Katolike. Një tjetër shembull është kremtimi Armen i kapërcimit mbi zjarr. Kjo u quajt Trndez (Tërndez) dhe festohet edhe ditët e sotme si një kremtim i Krishterë, Tiarndarak (Tyarndarach), që do të thotë “Drejt Zotit”. Ajo festohet nga Kisha Apostolike Armene dyzet ditë pas 6 Janarit. Kremtimi Arian i quajtur Novruz, ishte një kremtim Zoroastrian, që festonte Vitin e Ri Persian në ditën e Ekuinoksit Pranveror, dhe festohet ende në Republikën Islamike të Iranit. Jam i sigurt se ka edhe shumë kremtime të tjera të ngjashme, të cilat festohen nga njerëz të ndryshëm kudo nëpër botë.

\* \* \*

## Rreth Legjendës së Hajkut dhe Bel Nimrodit

Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit është domethënëse për të kuptuar historinë e racës njerëzore. Kjo legjendë na ushqen me shpjegime për ngjarjet Biblike dhe mitologjike që kanë ndodhur gjatë kohës kur Protogjuha (gjuha e vetme që flisnin të gjithë njerëzit në tokë, deri sa Zoti i ngatërroi gjuhët e tyre, Gjenezë 11:1-7) krijoi gjuhë të tjera. Ajo shpjegon arsyet e lëvizjes së njerëzve nga Malet Ararat në Azi, Afrikë dhe Europë, dhe ajo na siguron faktet dhe detajet e shumë-duhura rreth Thrakëve, Kushitëve dhe popujve të tjerë të botës së lashtë.

Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit na siguron prova që shkrirja e hekurit ka filluar që në Epokën e Bronzit. Kjo legjendë dhe punime të tjera letrare, të cilat unë i kam listuar në seksionin e Bibliografisë të këtij libri, provojnë se popujt e lashtë nuk kanë qenë aq primitivë sa kanë pasë besuar popujt e kohëve të reja. Civilizimi i lashtë arriti suksese të mëdha në kimi nëpërmjet shkrirjes së tipeve të ndryshme të metaleve për të prodhuar armë, vegla, zbukurime, enë, etj. Ata arritën suksese të mëdha në arkitekturë duke ndërtuar Ziggurate, piramida, pallate, ura dhe ndërtime të tjera. Disa civilizime të lashta kanë ndërtuar sisteme ujitjeje dhe sisteme kanalizimesh për ujërat e zeza, dhe zbulimi më i madh i tyre ishte rrota, e cila ndihmoi proceset inxhinierike të konstruktimit të qerreve luftarake dhe atyre për punë. Popujt e vjetër arritën suksese të mëdha në astronomi, pasi ata arritën të zbulojnë pesë nga planetët e sistemit diellor, Yllin Polar, si edhe trupa të tjerë qiellorë. Ata arritën suksese të mëdha në agrikulturë duke prodhuar sasi të mjaftueshme produktesh bujqësore për të ushqyer tërë popullsinë e mbretërive të tyre. Suksesi i tyre në mjekësi i ndihmoi ata të shëronin sëmundjet dhe dëmtimet. Mjekët e lashtë kryenin disa lloj ndërhyrjesh kirurgjikale, dhe dinin të qepnin plagët dhe të çarat. Ata krijuan, gjithashtu, muzikën dhe artet. Mbretërit dhe tregtarët e asaj kohe kishin gjuhëtarë, të cilët

i ndihmonin të komunikonin me popuj të racave dhe grupeve të ndryshme etnike. Kështu pra, ne të gjithë mund të pajtohemi me faktin, se njerëzit e lashtë nuk kanë qenë primitivë; në fakt, historia ka provuar se ata kanë qenë inteligjentë. Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit është shumë e veçantë dhe ajo ka shumë për të na ofruar. Është e mrekullueshme të shohësh, se me sa shumë dituri historike mund t'i pajisë ky libër të gjithë ata, që e lexojnë atë...

Më poshtë jepet Harta e Mbretërisë së Hajkut dhe e popujve fqinjë me të gjatë viteve 2500 B.C., e ilustruar prej Garegin D. Nalbandian, bazuar në historinë dhe faktet, që përmban Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit. Copyright 2012. Përdorimi i kësaj harte për qëllime komerciale mund të bëhet vetëm me autorizim me shkrim pasi të jetë dërguar kërkesë me shkrim për këtë qëllim pranë Garegin D. Nalbandian.



\* \* \*

## Mbretëria e Hajkut dhe mbretëria e Belit

Ka pasë qenë një mbretëri e lashtë, e vendosur në lindje të Azisë së Vogël, në jug të Maleve të Mëdha (Malet e Kaukazit), që ndante tokat e Askanazit në veri prej tokave të Torgomit në jug. Atje lumenjtë ishin të fuqishëm dhe malet të bukur. Vetë Zoti e kishte bekuar tokën me pasuri të tilla, ku disa lumenj mbartnin në ujrat e tyre ar dhe disa të tjerë argjend, disa të tjerë zbrisnin metale dhe minerale nga malet për në luginat ku banonin njerëzit. Gjithashtu, lumenjtë ishin plot me peshk dhe uji i tyre furnizonte tokat bujqësore në anët e tyre. Tokat bujqësore prodhonin me shumicë fruta, zarzavate, barishte dhe çdo gjë tjetër, që i shërbente njerëzve për ta bërë jetën e tyre të shëndetshme e të begatë.

Mbretëria ishte pjesë e perandorisë së Tirasit, i cili ishte pasardhës i Xhafetit, të cilën ai (Tirasi) e kishte trashëguar nga paraardhësit e tij. Shumë toka në këtë mbretëri ishin emëruar sipas figurave Biblike ose Mitologjike. P.sh. Abeliank (Abeghiank) ishte vendosur në veri të Liqenit Van dhe e kishte marrë emrin nga djali i Adamit, Abeli. Liqeni Van kishte marrë emrin e vajzës së Adamit, Avanit. Kajenku ishte vendosur në veri të lumit Aghstev (lumit Aghstev mund të ketë pasur një tjetër emër të lashtë; p.sh. ai mund të ketë pasë qenë quajtur sipas Kainit ose të afërmve të Kainit, dhe më pas ai të ketë marrë emrin Aghstev, sepse Kaini vrau vëllanë e tij, Abelin (Libri i Ngjarjeve, Ngjarja e Dytë) dhe Kajenku ka marrë emrin e djalit të Adamit, Kain ose Kajen. Lumi Aghstev ndodhet në verilindje të Liqenit Sevan dhe ai është emërtuar sipas emrit të vajzës së Noes, Astghik ose Astlik. Në Armenisht, Astghik do të thotë Yllth. Liqeni Sevan është emërtuar pasi Avani dhe Kaini ishin martuar (Libri i Ngjarjeve, Ngjarja e Katërt) dhe ishin vendosur në atë zonë, pasi ata ishin përjashtuar nga Kopshti i Edenit si ndëshkim për vrasjen e Abelit. Ka një legjendë Armene, që thotë se shtëpia

e Kainit u shkatërrua prej një tërmeti dhe ai vdiq nën gërmadhat e saj si ndëshkim nga Zoti për vrasjen e Abelit me një gur. Emri Sevan vjen prej Sa-Van ose Sa-Avan, që do të thotë Toka e Avanit. Setku (Setku njihet, gjithashtu, edhe si Sjudk ose Sodk në historinë Armene) ndodhet në juglindje të Liqenit Sevan dhe ka marrë emrin e djalit të Adamit, Sethit. Lumi Araz ka marrë emrin e vajzës së Noes, Araza. Liqeni Kaputan, që do të thotë Liqeni Blu, është i njohur si Liqeni Azure (Azur ose Azure do të thotë Blu, Qiell në gjuhën Perse, Arabe dhe ato Latine) dhe e ka marrë emrin nga vajza e Adamit, Azura ose Azure. Liqeni Kaputan ose Liqeni Azure është emri i vjetër i Liqenit Urmia. Mali Ararat ka pasë qenë quajtur Kuhe-Nuh (Kuh-e-Nuh do të thotë Mali i Noes në gjuhën Persiane) dhe ai ka marrë emrin e Noes.

Mali Arnoi ose Arnojotn, në juglindje të Liqenit Van, ka marrë emrin e Noes. Arnoi ose Arrn-Noi, fjalë për fjalë do të thotë “E marrë prej Noes”. Vendbanimi Hamshen ka marrë emrin e Ham Titanit. Hamshen ose Ham-Shen nënkupton “E ndërtuar prej Shemit”. Vendbanimi Ostan ndodhet në juglindje të liqenit Van, dhe ka marrë emrin e Xhafet Oste. Vendbanimi Zaravand ka marrë emrin e djalit të Noes, Sem Zrvan, dhe ndodhet ndërmjet lumenjve Araks apo Araz dhe Liqenit Urmia (Liqeni Kaputan ose Liqeni Azure). Samsar ka marrë emrin e djalit të Noes, Sem Zrvan. Sem-Sar ose Sim-Sar do të thotë Mali i Semit në gjuhën Armene, dhe ndodhet në jugperëndim të Mushit. Semsari ka shërbyer si kufi për të ndarë Mushin nga Sanasuniku. Lumi Arpa, një degë furnizuese e Lumit Araks ose Araz, ka marrë emrin prej nipit të Noes, Arpaçshad (Arpachshad) ose Arfaksas (Arphaxas), i cili ishte djali i Sem Zrvanit...

Disa njerëz thonë se këta personazhe Biblike apo Mitologjike kanë pasë banuar në këto vende, të tjerë thonë ndryshe; sidoqoftë, historia dhe faktet pohojnë se origjina e tyre rrjedh prej këtyre vendeve. Kështu, këto vende hyjnore me rëndësi Biblike dhe mitologjike u bënë pronë e Tirasit, pasi ajo i takonte atij si pjesë e trashëgimisë nga paraardhësit. Qytetet dhe vendbanimet u ndërtuan

prej mjeshtërive të aftë në ndërtim dhe arkitekturë, dhe populli ishte i bekuar prej Zotit. Gratë ishin të bukura si malet e vendit dhe burrat ishin të fuqishëm si lumenjtë. Ata flisnin gjuhën e Noes dhe të bijve e të vajzave të tij, që nga koha kur Noe dhe pasardhësit e tij zbritën prej Arkës dhe filluan të popullojnë Tokën (Shih seksionin e Fjalorit për përcaktimin e Lubarit).

Në mitologji, Tiras identifikohet si Taurus ose një dem, dhe demat ishin kafshë të bekuara të shumë kombeve Arianë, duke përfshirë dhe Hurro-Urartianët e lashtë. Tiras ishte një politikan i madh. Ai gjithmonë ja arriti të ruajë paqen ndërmjet pasardhësve të Xhafet Oste (Yapheth ose Hapheth), Sem Zrvan (Shem ose Sim), dhe Ham Titan (Kham ose Kam). Ai (Tirasi) kishte një marrëdhënie të veçantë me pasardhësit e Xhafetit; në këtë mënyrë, ai e zgjeroi influencën dhe mbretërinë e vet drejt perëndimit, ku të afërmit e tij Xhafetikë e mirëpritën atë si mbret të tyre. Kështu, Tirasi ja la tokat e tij djemve të tij dhe u nis për në perëndim me vajzat e tij, burrat e tyre, dhe pasardhës, të afërm, ndjekës të tjerë të tij. Ka emra vendesh; si p.sh. Lumi Terek, që rrjedh nëpër Malin Kazbek, që ndodhet në Malet e Kaukazit Verior dhe derdhet në Detin Kaspik, dhe Thraka, që ndodhet në Europën Lindore, ndërmjet Ballkanit dhe Azisë së Vogël, të cilat dikur ishin pjesë e Mbretërisë së Tirasit. Ai bëri gjithçka ishte brenda mundësive të tij, për të plotësuar nevojat e njerëzve të tij, dhe për këtë ai gëzoi dashurinë dhe respektin e popullit të tij. Tirasi i quajti njerëzit e tij Tirasianë ose Tirakians (Thrakians) sipas emrit të tij, dhe sipas Ksenofonit të Kolofonit, Thrakët ishin “të zbehtë dhe flokë-kuq”, që nënkupton njerëz me flokë të kuq ose bjondë dhe me ngjyrë të lëkurës të bardhë apo të hapur, gjë që përkon me përshkrimin, që i është bërë Gomerit dhe pasardhësve të tij prej shumë historianëve. Gomeri është përshkruar si Dragoi i Kuq prej shumë studjuesve si edhe në Mitologji për shkak të ngjyrës së flokëve të tij ngjyrë gështenjë ose të kuqërremta. Kështu, heronjtë mitikë Grekë të cilët vranë Dragonjtë, në fakt vranë Cimmerianët. Dragonjt kanë qenë

të lidhur me shumë kultura Aziatike; sidoqoftë, marrëdhënia e tyre më Gomerin kërkon akoma edhe më studime të tjera.

Sipas Moisi Korenacit, i cili citon Mar Abas Katina dhe Berossus, Tiras ose Thirak (Tir) ishte djali i Gomerit dhe nipi i Xhafetit, gjë që ka kuptim sepse Torgomi (Tor-Gom) nënkupton “nipi i Gomerit”, dhe që Torgomi të jetë nip, babai i Torgomit nuk mund të jetë Gomeri, siç shkruhet në Bibël; kjo e bërë qëllimisht apo jo qëllimisht, mund të jetë subjekt i një diskutimi tjetër.

Si bir i Gomerit, Tirasi u bë mbret mbi Sumerianët, popullit Nairi, popullit Mar dhe Cimerianëve, të cilët ishin, gjithashtu, pasardhës të Gomerit dhe të afërm të Tirasit. Tirasi ishte baba për Thrakët, Trojanët, (Krimeasit) Taurit, dhe shumë të tjerë. Tirasi ishte babai i Askanazit, Rifatit, dhe Torgomit (Togarmahut) dhe duke qenë se Hajku ishte një nga shumë nipërit e Tirasit, Armenët mund të konsiderohen një popull Thrak. Në mitologjinë Armene, Tirasi adhurohej si Tir, një nga shumë perënditë e lashtësisë Armene. Tempulli i Tirit u ndërtua në perëndim të Lumit Araks ose Arakses (Araz) pranë qytetit Artaksata (Artashat). Tiri ishte një qytet i lashtë në Feniki, që mori emrin nga Tirasi. Tiri u themelua në bregun lindor të Deti Mesdhe. Tiri quhej Urru (ta-Urru ose Taurus, që do të thotë “Dem” në gjuhën Greke, dhe demi simbolizonte Tirasin) në gjuhën Akadiane, Tiros në gjuhën Greke, dhe Tirus në gjuhën Latine. Shumë studiues kanë shkruar se Tiri ishte një qytet Kushit; megjithatë, historia dhe faktet provojnë se Tiri u ndërtua fillimisht nga Fenikasit dhe Thrakët, të cilët jetuan atje deri kur Paflagoni, biri i Fenekut Biblik dhe i bijës së Rifatit, Halis ose Alis, e zhvendosi popullin e tij në Paflagonia, kur Nimrodi dhe Kushitët pushtuan Tirin. Ekzistonte një krahinë, e cila ishte pjesë e Mbretërisë Urarte dhe Armene, që quhej Turuberan ose Tauruberan në nder të Tirasit. Fjala “Ur” në gjuhët Urarte dhe Sumeriane do të thotë “Vend” ose “Tokë”, dhe “Uru” do të thotë “Tokë me shumë qytete”, që nënkupton një “Shtet” në gjuhët Urarte dhe Sumeriane; për këtë arsye, qytet-shtetet e Urit dhe Urukut u themeluan gjithashtu nga

popujt e lashtë Sumerianë dhe Thrakë, të cilët ishin popuj të afërt për shkak të gjuhës dhe ngjashmërive kulturore. Prandaj, mbretëria e Tirasit filloi nga Lumi Terek ose Tired në Malin Kaukaz, përfshinte Tirin pranë Artaksatit (Artaksati ose Artashati ishte kryeqyteti i Mbretërisë Armene i mbretërve Artashianë) në Krahinën Airarat të popullit Eriuki të Krahinës Urartu, Turuberanin ose Tauruberanin (Turuberani ishte një krahinë e Armenisë) e Malësive Urartu, Tavrosin (Tauros) në Azinë e Vogël, Urinin dhe Urukun pranë Gjirit Persik në Mesopotami, Tirin në Feniki, Trakonitin në Siri, Trojën në Azinë e Vogël, Thrakinë dhe pjesë të tjera të Gadishullit Ballkanik, Etrurinë ose Tirenin (Etruria gjithashtu u quajt Tirenia prej Tirenit, një pasardhës i Tirasit) e cila ndodhej në tokat veriore të Gadishullit Italian, Taurin (Tauri ishte emri i lashtë i Krimesë), i cili identifikohet me Taurusin ose Tirasin, dhe (Tiras ishte emri i lashtë për Lumin Dniester, i cili ndodhet në Ukrainë) Lumin Tiras, i cili ndodhej në veri të Detit të Zi. Për këtë arsye, gjuha e vetme që flisnin të gjithë popujt në Tokë, e cila u shkruajt në Bibël, ishte gjuha, që tani njihet gjerësisht si Protogjuha nga shumë gjuhëtarë dhe studiues, dhe ishte gjuha e popullit Nairi, popullit Thrak, dhe popujve të afërt me ta, e cila mbijetoi në tokat e origjinës së saj në malësitë Armene, ku u themelua fillimisht nga Noe dhe familja e tij.

Ekzistojnë shumë fjalë të ngjashme në gjuhët Cimeriane, Frigiane, Sumeriane, Mare, Thrake, Hurro-Urartiane, dhe Armene, si dhe shumë ngjashmëri kulturore ndërmjet këtyre civilizimeve, sepse ata janë popuj të afërt, ose i njëjti popull. Për shembull, populli Trojan dhe Thrak, në mënyrë të ngjashme me popullin Mar, Cimerian ose Gimerian, Sumerian, Hurro-Urartian dhe Armen, ishin popuj Arianë, dhe të gjithë ishin pasardhës të Gomerit Biblik. Një tjetër ngjashmëri është se ata adhuronin Diellin si symbol i Perëndisë dhe zota të tjerë, që përfaqësojnë natyrën, perëndinë ose perëndeshën Hënë, Sina ose Sena, dhe planetet. Ata ishin popuj bestytë dhe që e donin Perëndinë. Ata ishin të shkëlqyer në ato që bënë dhe arritën suksese të mëdha në beteja, agrikulturë, mjekësi, muzikë dhe art.

Ndërkohë që plakej, Tirasi e kuptoi që nuk mund ta drejtonte më tej perandorinë e tij. Ai i ndau tokat e tij dhe ua kaloi ato djemve dhe vajzave të tij, dhe më pas djemtë dhe vajzat e tij ua kaluan ato djemve dhe vajzave të tyre... Kjo ishte rruga nëpërmjet së cilës Torgomi, një nga djemtë e Tirasit, i trashëgoi tokat e tij dhe ua kaloi ato djemve të tij. Për më tepër informacion rreth Torgomit dhe djemve të tij, ju lutem referojuni pjesës së këtij libri ku flitet: Populli Armen dhe popujt e afërt me të. Robert Ellis ka pohuar se Thrakët në origjinë të tyre kanë banuar në Armeni, ndërmjet Detit Kaspik dhe Liqenit Urmia, në jug të Lumit Araks ose Araz. Ai është vendi aktual i popullit Talish dhe Armenëve Iranianë të Arminies në Iran. Shumë studjues e konsiderojnë popullin Talish si një tribu Persiane dhe disa burime të shkruara pohojnë se origjinat e popullit Talish janë të panjohura; sidoqoftë, historia dhe faktet provojnë se populli Talish ishte një tribu Thrake. Kjo mund të jetë edhe arsyeja, që populli Talish ndihet më afër me Armenët se sa me Iranianët. Kështu, ata, origjinalisht, janë të lidhur me Armenët. Për shkak të influencës së gjatë mijëvjeçare Persiane mbi popullin Talish, besimi, gjuha dhe kultura kanë ndryshuar duke u afruar me atë të popullit Iranian.

Sipas letrës që Mar Abas Katina (Mar Abas Katina njihet si Maribasa në historinë Armene) i dërgoi Mbretit Vagharshak (Valarsaces) të Armenisë në lidhje me kërkesën e këtij të fundit rreth fisnikëve Armenë dhe gjenealogjisë së tyre, Hajku ishte djali i Torgomit dhe nip i Tirasit. Hajku ishte paraardhësi i popullit Armen, Hurro-Urartian dhe popujve të tjerë Arianë. Shkrimet e Abidenus (Abidenus ishte historian Grek) dhe Berossus (Berossus ishte historian me prejardhje Babilonase, i cili ka shkruar në Greqisht në shek. 3të p.e.s.; në historinë Armene njihet, gjithashtu, si Beros) rreth paraardhësve të popullit Armen konfirmojnë gjenealogjinë e Hajkut.

Torgom ose Tagarmahu ishte vëllai i Askanazit dhe Rifatit, dhe të gjithë ata ishin djemtë e Tirasit. Ndonëse disa studjues shpallin se Askanazi, Rifati dhe Torgomi janë bij të Gomerit, ka shumë historianë, që i shpallin ata bij të Tirasit. Askanaz apo Ashkenaz është deklaruar

të jetë paraardhësi i Skithianëve dhe Sarmantëve; sidoqoftë, është fakt i njohur, që Skita apo Skitha ka qenë paraardhës i Skithianëve, dhe Sarmantët kanë qenë një degëz e popujve Skithë dhe Amazonë.

Ka shumë tregime të disa historianëve dhe studjuesve, sipas të cilëve Skithët synonin të shkatërronin plotësisht Cimmerianët, dhe Cimmerianët, që arritën t'i shpëtojnë dhe t'i mbijetojnë Genocidit, gjetën strehë dhe krijuan vendbanime të reja në Malësitë Armene; dhe pikërisht në krahinat e Hamshenit, Xhavakut, dhe Gymri të Mbretërisë Armene.

Askanazi ka qenë paraardhësi i popullit Skandinav, Saka, Sakson, etj. Ka shumë turbullirë përse i përket vendndodhjes së Mbretërisë së Askanazit. Disa historinë besojnë të ketë qenë përreth Liqenit Askanaz në brigjet lindore të Detit Egje në Azinë e Vogël, të tjerë besojnë se Mbretëria Askanaz ka qenë në Skandinavi.

Bibla e Shenjtë pohon, që Rifati ishte paraardhësi i Paflagonianëve. Paflagonianët janë një popull Xhafetik, që ka banuar në Azinë e Vogël. Shumë studjues kanë shkruajtur se Paflagoni, paraardhësi i Paflagonëve, ishte djali i Fineusit (Phineus) të Tirit. Historia tregon se Fineusi i Tirit ishte i lidhur me Fenikasit. Kështu, Fineusi ishte version Grek dhe Romak i Feneçit Biblik (Phennech), pasi Feneçi ishte paraardhësi i Fenikasve. Feneçi ishte në krye të kampit Xhafetik gjatë konstruktimit të Kullës së Babelit. Sipas burimeve jo-Biblike, që unë kam shfletuar, Feneçi u martua me Halisin ose Alisin, vajzën e Rifatit, dhe ata lindën Paflagonin. Lumi Halis në Azinë e Vogël kishte emrin e saj. Kështu, Paflagoni ishte një princ Fenikas. Ai ishte nipi i Rifatit. Mbi Paflagonët dihet shumë pak; sidoqoftë, unë munda të gjej informacion të mjaftueshëm për të provuar pikëpamjen time...

Sipas një burimi tjetër jo-Biblik ([www.fantocus.org](http://www.fantocus.org) -Artikulli i emëruar: Paflagonët) mbretërit Paflagonë sunduan nga Gangra (Germanikopolis), që ndodhej pranë kufirit Galatian. I njëjti artikull, gjithashtu, pohon se Paflagonët ishin të afërm të Maqedonasve duke

ndjekur të njëjtat rrënjë si dhe ato të Frigëve. Kjo ndodh për arsye se Maqedonasit dhe Frigët ishin popuj Thrakë, dhe Rifati ishte i biri i Tirasit dhe nipi i Gomerit. Duke cituar Homerin, i njëjti artikull, gjithashtu, pohon se “Paflagonët luftuan kundër Grekëve gjatë Luftës së Trojës”. Sërish, kjo ndodh për arsye se si Trojanët ashtu edhe Paflagonët ishin popuj Thrakë. I njëjti artikull pretendon se Paflagonët ishin fqinjë të Kapadokëve; megjithatë, të dy këta popuj flisnin gjuhë të ndryshme. Arsyeja për këtë ishte se Kapadokët ishin një degë e popullit Sirian dhe Paflagonët flisnin në një dialekt Fenikas ose Thrak. Edhe pse Paflagonët u pushtuan nga Grekët, Romakët, dhe nga Bizantinët, ata u sunduan gjithnjë nga fisnikë Paflagonas; ndaj, ata qenë të aftë të ruanin gjuhën dhe identitetin e tyre kombëtar.

Historia tregon se tokat e Paflagonit më vonë u shndërruan në atdheun e popullit Hati ose Hatik, dhe u pushtuan nga Hititët. Populli Adixh (Çirkasët), të cilët aktualisht jetojnë në Kaukazin Veriperëndimor, pretendojnë se janë pasardhës të civilizimit Hatik. Është e vështirë të provohet se populli Hatik migroi për në Paflagoni nga Kaukazi Veriperëndimor, ose që ata jetuan atje si një degë e Paflagonëve. Një tjetër teori e mundshme është se populli Hatik u dërgua të vendosej dhe jetonte në Kaukazin Veriperëndimor nga Grekët ose nga Romakët.

Populli Çeçen, të cilët e quajnë veten Nokçi, pretendojnë se janë njerëz të Noes, dhe mund të jenë degë e popullit Nairi. Ata pretendojnë se janë pasardhës të populli Matian (Mitan), të cilët jetonin në Mbretërinë Armene Hurro-Mitane. Më vonë, Mbreti ose Mbretërit Sassanidë i zhvendosën ata në tokat, që sot njihen si Çeçeni, të cilat ndodhen në Kaukazin Qëndror, ku Mitanët u bënë të njohur si populli Sassan (Çeçen).

Torgomi ose Togarmahu ishte një paraardhës i popullit Armen, Abkaz, Kaukazian, Kartli, Axhar, Lezgin, dhe shumë popujvë të tjerë të afërt me ta, të cilët jetonin në jug të Maleve Kaukaz, në Azinë e Vogël, dhe në Persinë veriperëndimore. Torgomi ose Tor-Gom (Tor

do të thotë “nip” në gjuhën Armene dhe atë Ariane – Gom nënkupton Gomerin ose Gamirin) ishte nipi i Gomerit dhe një pasardhës i Xhafet Oste. Xhafet Oste ishte emri i Xhafetit Biblik, një nga tre bijtë e Noes, dhe Oste (Oste ose Osto do të thotë “Kockë” në gjuhën Greke) ishte nofka ose mbiemri që i ishte vënë Xhafetit duke qenë se ishte një njeri me kocka të mëdha (eshtërmadh)...

\* \* \*

Bibla, Libri i Ngjarjeve, dhe burimet e tjera të shkruara pohojnë që Hami e pa lakuriqësinë e Noes dhe për këtë Noe e mallkoi Kanaanin që të bëhet skllav. Ka, gjithashtu, tregime edhe për Nimrodin, i cili kishte një veshje speciale, e cila i përkiste Adamit dhe u desh të kalojnë disa gjenerata, deri sa ajo t’i kalonte Noes; kështu, ai trashëgoi veshjen e shenjtë. Në atë veshje kishte shkrime të shenjta, të cilat tregonin se si mund të ishte i aftë për të kuptuar dhe për të komunikuar me kafshët dhe zogjtë, si edhe shkrime rreth të jetuarit gjatë dhe shëndetshëm. Noe e përdori këtë veshje për të komunikuar me kafshët dhe zogjtë, që ishin brenda Arkës, në mënyrë që ata të mund të jetonin në paqe përgjatë kohës që ishin në të, deri sa të mbaronte përmbytja. Historitë tregojnë, që Nimrodi e mori këtë veshje nga Kushi, i cili e kishte marrë atë nga Hami. Tani është e logjikshme të kuptohet, që Hami e vodhi veshjen ndërkohë që Noe ishte i pirë, kështu që, vëllezërit e tij të mos mundnin ta trashëgonin veshjen e shenjtë, duke e lënë kështu Noen të zhveshur. Hami thirri vëllezërit e tij që të vinin dhe ta shihnin babain e tyre të zhveshur, ndërkohë që Noe flinte, dhe Hami bënte shaka dhe qeshte me Noen, me qëllim që të mbulonte krimet e tij. Xhafeti dhe Semi morën një çarçaf të bardhë dhe mbuluan trupin lakuriq të Noes. Kur Noe u zgjua dhe kuptoi çfarë kishte ndodhur, ai e mallkoi Kanaanin, që ishte pasardhës i Hamit, që të shndërrohej në skllav për pasardhësit e Xhafetit dhe Semit. Noe emëroi Semin

si mbret të mbretërisë së tij dhe shpalli Xhafetin dhe pasardhësit e tij të shërbenin si mbrojtës për Semin dhe pasardhësit e tij. Hami nuk u pajtua me vendimin e Noes; prandaj, ai (Hami) mori familjen e tij dhe e la mbretërinë e Noes. Hami u nis në drejtim të jugut në kërkim të tokave të reja.

Sipas një legjende tjetër, kur Hami mori familjen e tij drejt jugut, pasi ishte mallkuar nga Noe, atij iu desh të ndeshej me një luan për të mbrojtur familjen e tij, dhe Hami e vrau luanin. Kështu, ai u emërtua Titan për shkak të fuqisë së tij të hyjnore. Kushi ishte një Titan, pasi ai ishte pasardhës i Ham Titanit. Kushi, gjithashtu, vrau një luan dhe e vendosi kokën e luanit mbi kësulën e tij, për të treguar, që ai ishte trashëgues i linjës së gjakut hyjnor të Hamit. Kushi krijoi një traditë për të gjithë Titanët: për t'u përballur dhe për të vrarë një luan. Pasi vdiq Hami, Kushi u bë mbret i Titanëve (Kushitëve) dhe i Hamitikëve të tjerë, që kishin zbritur në Egjiptin e Sipërm dhe Afrikën e Veriut.

Titanët ishin një lloj i veçantë njerëzish. Ata ishin të mëdhenj dhe të fortë, dhe ata u martuan me gra të mëdha dhe të forta me prejardhje nga Titanët për riprodhimin e racës së Titanëve. Luftëtarët Titanë ishin përzgjedhur nga fiset e shumta të racës Hamitike; sidoqoftë, ata shërbyen nën Kushin dhe Nimrodin. Kështu, ata u konsideruan të ishin Kushitë.

Titanët kishin veshje mbrojtëse të rënda prej bronzi, si edhe kësula të bëra prej bronzi, të zbukuruara me kokën e luanit. Çdo Titan ishte i etur të meritonte kësulën speciale ashtu si edhe Titanët e tjerë. Kështu, një grup Titanësh shkuan në gjueti kundër një tufe luanësh; sidoqoftë, çdo Titan duhej të fiksonte një luan dhe ta vriste atë me armët e tij. Pas kësaj, Titani e sillte luanin e vrarë tek Kushi si provë të trimërisë dhe aftësisë së tij. Vetëm Kushi kishte të drejtë ta deklaronte atë si Titan dhe urdhëronte të bëhej një armaturë speciale prej bronzi dhe një kësulë speciale prej bronzi për atë Titan. Kështu, mashkulli Titan pranohej në shoqëri

dhe konsiderohej i denjë për t'u martuar me një grua nga familje Titanësh. Luftëtarit Titan i jepeshin armët e tij luftarake dhe ai vendosej në Njësinë Speciale të Luftëtarëve Elitë, duke sjellë kështu nder për veten dhe familjen tij. Disa Titanë, kishin fatin ta vrisnin luanin e tyre që me përpjekjen e parë, ndërsa të tjerët përpiqeshin disa herë, deri sa të mund t'u jepej rasti për të vrarë luanin e tyre. Shumë Titanë shkonin në gjueti luanësh; disa ja arrinin, të tjerë ktheheshin duarbosh. Titanët, të cilët nuk mundnin ta vrisnin një luan, vazhdonin të përpiqeshin të vrisnin luanin e tyre për sa kohë ishin në moshë dhe të aftë. Ata prej Titanëve, të cilët ishin të paaftë të vrisnin një luan, nuk lejohej të martoheshin me një grua prej familje Titanësh, kështu që, ata ishin të detyruar të martoheshin jashtë racës së tyre. Ata konsideroheshin si racë e ulët, dhe ata dhe pasardhësit e tyre vendoseshin në njësi luftarake të një rëndësie të vogël. Gjuetia e luanëve ishte e rrezikshme. Shumë nga djemtë e Titanëve (Hamitikë) ishin dëmtuar; të tjerë bëheshin pre e luanëve dhe nuk ktheheshin më...

Duke cituar Berossusin, George Rawlinson pohon se Nimrodi dhe Babilonasit (Kushitët) ishin gjuetarë të mëdhenj; ata gjuanin arinj të egër dhe kafshë të tjera. Gjuetia e luanëve ishte një tjetër traditë e Babilonasve të lashtë (Kushitëve) të cilët ishin të detyruar të vrisnin luanët për të mbrojtur familjet dhe bagëtitë e tyre. Kështu, mbajtja gjallë e traditës së gjuetisë së luanëve kontribuoi në reduktimin e numrit të luanëve në Babiloni dhe në Afrikën e Veriut, dhe banorët Hamitikë tashmë nuk kishin frikë nga bishat e egra, pasi ata ndjeheshin të sigurtë duke e ditur se Titanët ishin fitimtarë në betejën e tyre kundër luanëve. Ai pohon se Babilonasit (Kushitët) kishin çehre të errët ose të zezë dhe kishin hundë dhe nofulla që u ngjanin hundës dhe nofullave të Indo-Europianëve. Kjo provon se Kushitët nuk ishin të racës vendase Afrikane. Kushitët ishin të afërm me Egjiptianët, Etiopianët dhe popuj të tjerë të lashtë Hamitikë. Ata adhuronin Qiellin, që do të thotë se babilonasit praktikonin tipin Astro-Teologjik të Politeizmit; ata adhuronin

Diellin, Hënën, dhe pesë planetët e njohur. Ata i emërtuan trupat e njohur qiellorë me emrat e heronjve të tyre dhe i adhuronin ata si zota. Ata, gjithashtu, adhuronin edhe zota të tjerë, që përfaqësonin natyrën si edhe katër elementet, që përfaqësonin Zjarrin, Ajrin, Ujin dhe Tokën.

Disa studiues dhe gjuhëtarë e konsideronin gjuhën Kushite si gjuhë Afro-Aziatike dhe jo si gjuhë Hamitike, për shkak të ndikimit Kushit në Afrikën Veriore dhe në Lindjen e Mesme. Të tjerë pretendojnë se gjuha Kushite ishte një dialekt i gjuhëve Hamitike. Prandaj, është e paqartë, nëse gjuha e Kushitëve ishte gjuhë Hamitike apo Afro-Aziatike. Jam i sigurt se nëpërmjet kërkimeve dhe arkeologjisë, kjo pyetje do të gjejë një përgjigje të saktë.

Titanët, të cilët ishin pjesë e popullit Kushit, duhet edhe të përshkruhen me tipare të tilla, ashtu siç i kanë përshkruar George Rawlinson dhe Berossus, sepse ata ishin popull Hamitik, dhe Hami ose Khami Biblik ishte paraardhësi i popujve me lëkurë të errët ose të zezë. Ata ishin më të mëdhenj, më të fuqishëm, dhe më të shpejtë se çdo njeri mbi Tokë. Titanët ishin elitarë, super-njerëz dhe ishin ata, që i drejtonin gjithnjë ushtritë Kushite në betejë. Titanët vishnin armaturë të rëndë prej bronzi, e cila dallonte nga armatura e lehtë e ushtarëve, dhe armët e tyre ishin më të mëdha e më të rënda. Në betejë, Titanët luftonin si bisha të egra dhe visheshin si luanë. Në flamurin e njësisë së tyre kishte një luan të bronzit (Shiko Flamurin e Babilonisë; Nimrodi e përshtati Flamurin e Titanëve për Babiloninë dhe Luani u bë simboli i Perandorisë Babilonase) dhe ai luan ishte i drejtuar në të djathtë, ose drejt lindjes. Titanët vendoseshin në koçi (qerre luftarake) për të rritur lëvizshmërinë e tyre, pasi ata ishin tepër të rëndë për t'u ngjitur në kuaj. Teksa kočitë sulleshin drejt linjave të armikut, Titanët kërcenin prej kočive dhe fillonin të vrisnin ushtarët armiq. Asnjë njeri nuk ishte në gjendje të vriste një Titan në betejë; për këtë arsye, ata konsideroheshin si të pavdekshëm, pasi edhe pse ata lëndoheshin në betejë, ata vazhdonin të luftonin. Asnjë Titan

nuk kishte vdekur në betejë. Ata ishin luftëtarë të zotë dhe çdo Titan mund të vriste dhjetë ose më shumë armiq, duke i detyruar ata të dorëzoheshin ose të vraponin për të shpëtuar. Reputacioni i tyre e paraprinte fuqinë e tyre dhe prania e tyre përhapte frikë në rradhët e armiqve.

Sipas Biblës së Shenjtë dhe burimeve të tjera jo-Biblike, Noe jetoi më tepër se nëntëqind vjet. Disa burime pretendojnë se Noe jetoi nëntëqind vjet dhe burime të tjera pretendojnë se ai jetoi nëntëqind e pesëdhjetë vjet. Adami jetoi 930 vjet (Libri i Ngjarjeve, Ngjarja e Nëntëmbëdhjetë) dhe sekreti për një jetë të gjatë e të shëndetshme u trashëgua nëpërmjet mantelit të shenjtë të Adamit brez pas brezi, deri kur Kushi e trashëgoi atë mantel nga Hami. Kushi ishte bashkëkohor me Gomerin dhe Tirasin, dhe ai jetoi më gjatë se të dy ata. Ai mblodhi haraç nga Torgomi dhe mbretër të tjerë. Nimrodi ishte bashkëkohor me Torgomin dhe ai jetoi më gjatë se Torgomi. Nimrodi ishte ende gjallë kur Hajku kishte nipër. Herodoti i quajti Etiopianët (Kushitët) “Njerëz të urtë të Nilit të Sipërm, burra me jetë të gjatë”. Prandaj, jetëgjatësia e Kushitëve mund të shpjegohet vetëm me faktin, se ata kishin mantelin e shenjtë dhe njihnin sekretin e një jete të gjatë e të shëndetshme.

Nimrodi ishte djali i Kushit. Ai ishte i fortë dhe trim; prandaj ai u zgjodh nga Kushi për të qenë udhëheqësi i Titanëve dhe i Hamitikëve të tjerë. Nimrodi ishte vëllai i Sebës, Havilahut, Sabtahut, Raamahut dhe Sabtekahut. Për më tepër informacion rreth vëllezërve të Nimrodit (shih djemtë e Kushit, Gjenezë 10:6-12) ju lutem referojuni seksionit të Fjalorit në këtë libër. Nuk dihet, nëse Kushi dhe pasardhësit e tij jetuan në vendet e njohura si Gadishulli Arabik rreth Detit të Kuq dhe Mesopotamia, përpara se Kushi dhe Nimrodi të pushtonin Sumerianët dhe të ndërtonin Babiloninë. Ndoshta, kështu ishte. Gjithashtu, është e mundur, që të kenë marshuar nga Afrika e Veriut dhe Egjipti për në Azinë Jugperëndimore dhe të kenë pushtuar Gadishullin Arabik, kur Kushi dhe Nimrodi pushtuan Babiloninë. Unë jam i sigurtë, që

nëpërmjet arkeologjisë dhe kërkimeve ky problem do të qartësohet.

Sipas Moisi Korenacit, Nimrodi kishte një djalë të quajtur Bab. Sir Henry Rawlinson dhe historianë të tjerë pohojnë se Belus (Bab-Bel) ishte djali i Nimrodit. Berossus ka shkruajtur se Belus ishte njëlloj si Nimrodi dhe ishte mbreti i parë i Babilonisë. Sipas legjendës Hungareze të Drerit të Bardhë, Nimrodi ishte babai i Hunorit dhe Magorit, të cilët u bënë paraardhësit e Hunëve dhe të Maxharëve. Libri i Ngjarjeve (Ngjarja tridhjetë e dy) pohon se Nebrodi ose Nimrodi ishte babai i Azuradit, dhe Azurati më vonë u bë nëna e Pelegut. Pelegu ishte një paraardhëse e Abrahamit; kështu rezulton që, Nimrodi ishte paraardhës i Abrahamit. Libri i Xhasherit tregon se Nimrodi kishte një djalë të quajtur Maridon dhe një vajzë të quajtur Zeliha, dhe se si Abrahami e vrau Nimrodin; sidoqoftë, kjo duhet të jetë e pamundur, sepse Nimrodi ishte brezi i katërt i Noes dhe Hamit ndërsa Abrahami ishte gjenerata e njëmbëdhjetë e Noes, dhe ka edhe fakte të tjera, që provojnë se Nimrodi nuk luftoi kurrë kundër Abrahamit. Kështu, ka shumë turbullirë dhe dyzim rreth figurës së Nimrodit dhe djemve të tij ...

\* \* \*

Pasi vdiq Tirasi, pasardhësit e Tirasit e ndanë perandorinë e madhe të Thrakëve dhe krijuan shumë mbretëri të tjera më të vogla, në varësi të pjesës së trashëgimisë që u takoi të marrin. Kushi pa një mundësi të mirë për të pushtuar këto mbretëri të vogla që u krijuan dhe veproi shpejt... Kështu, pak pasi vdiq Tirasi, Kushi dhe pasardhësit e tij, të mbështetur nga një ushtri Titanësh, filluan të pushtojnë mbretëritë më të vogla të pasardhësve të Xhafetit dhe Semit. Disa pasardhës të Xhafetit Oste dhe Sem Zrvan vendosën të luftojnë kundër Titanëve; megjithatë, qëndresa e tyre u thye ashpërsisht prej Kushit dhe ushtrive të tij. Nimrodi, djali i Kushit dhe një pasardhës i Ham Titanit, fitoi famë në këto beteja,

dhe krijoi një sferë influence ndërmjet Titanëve (Kushitëve) dhe popujve të tjerë Hamitikë.

Sipas George Rawlinson (George Rawlinson ishte vëllai i studjuesit Anglez Sir Henry Rawlinson) Dinastia Burbur e Shinarit ishte shfronësuar prej Kushitëve kur Kushi dhe ushtritë e tij pushtuan Babiloninë. Ai, gjithashtu, ka shkruajtur se fisnikët e Dinastisë Burbur ishin të afërm me Alarodianët e Armenisë. Familja Burbur gjeti strehim në mbretërinë e Torgomit. Fisnikët Alarodianë i kërkuan Torgomit të lejonte fisnikët Burbur të vendoseshin në mbretëri, dhe Torgomi i mirëpriti ata. Fisnikët e Dinastisë Burbur u vendosën në tokat në verilindje të Pllajës së Araratit, pranë malit me shumë maja, dhe ai u emërua Bur ose Biur (Biurakani ose Burakani është një qytet pranë Malit Aragatson në Krahinën Aragatson të Armenisë) prej tyre.

Kushi i përgatiti ushtritë e tij për të marshuar drejt veriut, që të luftonte kundër pasardhësve të Xhafetit. Në mënyrë që të shpëtonin tokat dhe njerëzit e tyre nga shkatërrimi, Torgomi, Feneku, dhe pasardhës të tjerë të Xhafetit ofruan të paguanin haraç në këmbim të paqes, dhe Kushi i pranoi kushtet e tyre. Kushi përzgjidhte me kujdes se kë mbante si vasal dhe haraçpagues, dhe kë donte të shkatërronte ose ta nënshtrointe. Torgomi ishte një politikan i madh. Ndaj, Torgomi arriti të siguronte një traktat paqeje ndërmjet Kushit dhe pasardhësve të Xhafetit. Tregtarët përforcuan tregtinë; ushtarët Babilonas taksuan të nënshtuarit e Kushit, dhe koloni të reja lulëzuan në Mesopotami...

George Rawlinson, John Denison Baldwin, William Gifford Palgrave, dhe studiues të tjerë shkruan për perandorinë e Kushitëve, duke pretenduar, se ajo shtrihej që nga veriu i Maleve Kaukaz dhe Azisë së Vogël, dhe nga Afrika dhe Arabia në perëndim deri në Indi në lindje. Nëse kjo teori do të ishte një fakt, shkrimtarët e lashtë do kishin mbajtur të dhëna mbi këtë. Fakti është, se Torgomi dhe mbretërit e tjerë pranuan t'i paguanin haraç Kushit në shkëmbim

të paqes; megjithatë, Kushitët nuk zotëruan asnjëherë toka në Azinë e Vogël dhe Kaukaz, sepse ata asnjëherë nuk e pushtuan atë në të vërtetë. Kushitët ose Etiopianët, siç janë klasifikuar nga shumë studiues, nuk kishin një perandori aq të madhe sa ç'e imagjinojnë ata. Këta dhe studiues të tjerë citojnë shkrimet e Homerit "A race divided, whom the sloping rays; the rising and the setting sun surveys", (në Shqip do ta përdornim: Një perandori ku dielli nuk perëndon kurrë; ose, një racë e ndarë, ku njera shihte lindjen e Diellit dhe tjetra perëndimin e tij) dhe ata pohojnë se, në të vërtetë, ekzistonte një Perandori Kushite, që shtrihej nga Afrika deri në Indi. Kjo ndodh, për shkak se këta studiues ishin të specializuar në studimin e historisë Kushite dhe njohuritë e tyre mbi historinë ishin të limituara në ato, që ata studionin. Nëse do të lexojmë citatin e Homerit pa i shtuar gjë tjetër, të gjithë ne mund të shohim se si citati i tij përshkruante si Kushitët ishin të ndarë në dy: Kushitët Lindorë ose Indo-Kushët dhe Kushitët Perëndimorë ose Hamitët. Duke ndjekur këtë logjikë, do të kishte kuptim, që Kushitët të kishin një perandori, e cila shtrihej nga Afrika deri në Indi; megjithatë, Homeri deklaroi se ajo ishte e ndarë, dhe faktet dhe historia tregojnë se ashtu ishte. Jam i sigurtë, se lexuesit e mi do të jenë kuriozë të kuptojnë, se përse Perandoria Kushite ishte e ndarë...

Fakti qëndron në atë, se Kushitët kishin një perandori të madhe, që shtrihej nga Afrika Veriore dhe Gadishulli Arab deri në Asiri. Mbretëritë e Azisë së Vogël, mbretëria e Torgomit në Kaukaz, Madianët, Manianët, Elamitët dhe të tjerë ishin haraçpagues të Kushit; megjithatë, Kushitët nuk shtriheshin deri në Indi në atë kohë.

Bibla e Shenjtë dhe burime të tjera letrare jo-Biblike deklarojnë emrat e qytet-shteteve, që ndërtoi Nimrodi, dhe këto qytet-shtete ishin të vendosura në Lindjen e Mesme ose në tokat, që njiheshin më parë si Mesopotamia, jo në Azinë e Vogël, jo në Kaukaz, dhe jo në Indi. Logjika të çon të mendosh se fillimisht Nimrodi duhej të pushtonte këto qytet-shtete dhe më pas ai duhej t'i ndërtonte ato ose të riparonte dëmet, që kishin shkaktuar ushtritë e tij. Nimrodi

i ndërtoi ose riparoi ato qytet-shtete, sepse atij i nevojitej pasuria, të cilën e mblihdte nga ato.


Për këtë arsye, perandoria e Kushitëve nuk mund të shtrihej aq lart në veri deri tek Malet Kaukaz dhe Azinë e Vogël, dhe as nga Afrika dhe Arabia në perëndim deri në Indi në lindje. Perandoria Kushite shtrihej vetëm nga Afrika Veriore deri në Gadishullin Arab dhe Mesopotami, dhe është e qartë, se Kushi (Kushitët ose Etiopianët) nuk kishte një perandori aq të madhe, sa ç’ e mendonin shumë studiues. Lëvizja e Kushitëve drejt (Indu-Kushanisë) Indisë u shkaktua edhe nga një ngjarje tjetër, dhe “Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit” do të sigurojë më tepër informacion mbi këtë ngjarje, që shkaktoi migrimin e Kushitëve drejt Indisë.

\* \* \*

### Ndërtimi i Kullës së Babelit

Babilonia është një variant Grek për emrin Babel. Babeli ka qenë quajtur, gjithashtu, Babili (El ose Eli nënkupton Zot dhe Babilili ose Bab-Eli nënkupton Porta e Zotit në gjuhën Babilonase) dhe konsiderohej të ishte qendra e Tokës; sidoqoftë, ky është interpretimi i disa historianëve dhe studjuesve. N.q.s ne pranojmë, se Babeli ose Babilili është ndërtuar dhe emërtuar prej Babit, djalit të Nimrodit, atëhere do kishim Babel ose Babilili (Bab-Bel ose Bab-Bili), që do të thotë Bel Bab ose Zoti (Perëndia) Bab; kështu, kjo do të provonte, që Babilili është emërtuar sipas emrit të djalit të Nimrodit, Babit, gjë që bën më tepër sens, sepse ishte e zakonshme në kohët e lashta, që qytetet apo vendbanimet e ndërtuara të emërtoheshin me emrin e mbretit ose të bijve të tij.

Sipas Biblës së Shenjtë, Libri i Gjenezës, Bel Nimrod (Bel nënkupton Zot në gjuhët Assiriane dhe Babilonase) ishte një prej shumë djemve të



Piktura “Kulla e Babelit” e Pieter Bruegel tregon se si Nimrodi i rrethuar nga rojet e tij mbikqyr gurgdhendësit gjatë ndërtimit të Kullës së Babelit.

Kushit. Së bashku me të vëllezërit, ai sundoi mbi Babiloni dhe qytet-shtete të tjera. Mamaja e tij ishte pasardhëse e Mizraimit të Egjiptit. Kushi dhe Mizraimi, që të dy këta, ishin ishin vëllezër me Putin dhe Kanaanin (Gjeneza 10:6) dhe të katër këta ishin djemtë e Ham Titanit. Hami Biblik ishte një prej djemve të Noes.

Manitoni ishte mbret i Mannae në atë kohë. Në historinë e lashtë dhe në librat Zoroastrianë ai identifikohet, gjithashtu, me Jonton. Shumë historianë pohojnë se Jonton ishte djali i katërt i Noes. Jontoni duhet të ketë qenë dhëndri (burri i vajzës) i Noes, sepse ai është përmendur të ketë qenë burri i Arazës, vajzës së Noes. Kështu, Jontoni ishte në Arkë dhe kishte arritur të shpëtonte, pasi duke qenë i lidhur me vajzën e Noes ishte konsideruar si pjesë e familjes së Noes. Manitoni ishte pasardhës i Jontonit. Ai trajtohet si pasardhës i Noes. Manitoni ishte adhurues i shumë Zotave. Ai ishte njeri i mësuar dhe i edukuar mirë. Manitoni thuhet të ketë qenë

njeriu më i zgjuar në Tokë i kohës së vet. Ai praktikonte, gjithashtu, artet e errta dhe magjinë. Ai ishte mjeshtër i magjisë dhe i arteve iluzioniste. Ai dinte të përgatiste helme, kundërhelme dhe ilaçe të të gjitha llojeve. Ai mund të vriste njerëz dhe mund t'i shëronte ata, dhe për këtë arsye njerëzit e kishin shumë frikë. Askush nuk ishte aq trim, sa të vinte në diskutim ose të mos përfillte fjalën e tij. Kur Manitoni foli me Torgomin në lidhje me edukimin e ardhshëm të Hajkut, Torgomi, me delikatesë, i tha atij, se asnjë nga djemtë e tij nuk ishte aq i zgjuar, sa të meritonte të merrte edukacion nga Manitoni dhe që prej asaj kohe edukimi i djemve të Torgomit nuk u diskutua më kurrë. Mbreti Maniton u takua me Torgomin vetëm një herë, kur ai kishte nevojë të blinte një kalë, dhe Torgomi ishte i famshëm për mbarështimin dhe trajnimin e kuajve më të mirë të kohës.

Kushi ishte gjithë kohës i zënë me mbledhjen e tributeve nga nënshtetasit dhe vasalët e tij, dhe nuk ishte e zakonshme për mbretërit të edukonin dhe të rrisnin vetë fëmijët e tyre. Ndër detyrat e rëndësishme të mbretit, krahas të tjerave, ishte të drejtonte mbretërinë dhe të zgjidhte një trashëgimtar për të siguruar vazhdimësinë e mbretërisë...

Mbreti Maniton e kuptoi, se Kushi shumë shpejt do të kishte nevojë për dikë, që të edukonte Nimrodin dhe djemtë e tjerë të Kushit. Manitoni, kur vinte puna për të zgjedhur nxënësit e tij, gjithnjë vinte gishtin mbi djemtë më të mëdhenj të mbretit, që ishte fqinj me Mannaen. Në këtë mënyrë ai mund të kontrollonte fqinjët e tij nëpërmjet studentëve të tij. Ai, gjithashtu, siguronte për Mannaen që të kishte në të ardhmen influencë dhe marrëdhënie të mira me mbretëritë fqinje, pasi në qytetërimet e lashta ishte zakon që mbretërinë e trashëgonte djali më i madh. Kështu, nxënësit e Manitonit do të mund të ishin gjithnjë aleatë të tij, dhe mbretëritë e tyre do të ishin aleatë të Mannaes.

Mbreti Maniton u ofrua të merrej me edukimin dhe formimin e Nimrodit, dhe Kushi u ndje i kënaqur ta linte Nimrodin nën kujdesin edukativ të Mbretit Maniton. Manitoni shkoi në Babiloni së bashku

me studentët e tjerë të tij dhe ai qëndroi atje për t'i bërë përshtypje Kushit me ato, që ai ofronte t'u mësonte nxënësve të tij. Ai kishte një grup të vogël studentësh të moshave të ndryshme dhe të grupeve të ndryshme etnike, dhe ai ishte njëlloj i përkushtuar ndaj të gjithëve. Shumë shpejt, Manitoni së bashku Nimrodin dhe studentët e tjerë u kthyen në Mannaea. Nga frika se mos ndonjë nga studentët e tij mund ta helmonte ndonjë ditë, ai i mësoi atyre vetëm të fshehtat e magjisë primitive. Çdo herë që studentët i kërkonin që t'u mësonte magjinë e zezë, Manitoni u thoshte se do t'ua mësonte atë kur të ishin gati për të... Në mendjen e tij ata nuk ishin gati për atë, pasi ai nuk ishte i bindur, se ndonjë prej studentëve të tij ishte aq i fortë, sa të mund ta zëvendësonte denjësisht atë.

Sipas Biblës së Shenjtë, Nimrodi ishte i bekuar dhe i preferuar i Zotit, pasi ai ishte një gjahtar i zoti dhe një djalë trim. Si një djalë mbreti, ai kishte çdo gjë kur ishte fëmijë, por duke u rritur, ai filloi të bëhej ambicioz, ashtu siç mund të bëhej ambicioz dhe rebel çdo student i Manitonit. Nimrodi nuk ishte asnjëherë i kënaqur me atë çfarë ai kishte, dhe çdo herë tentonte për më tepër. Manitoni e vuri re potencialin e tij dhe e mori Nimrodin nën mbikëqyrjen (kujdestarinë) e vet. Manitoni u mësonte studentëve të urrenin Zotin, pasi Zoti kishte shkatërruar pasardhësit e Adamit, dhe në vend të tij ai u mësonte studentëve të tij të adhuronin Zotat-Idhuj, pasi ata nuk shkaktonin dëme tek njerëzit. Nimrodi mësoi ta urrente Zotin dhe i bindi prindërit e tij, që ishte meritë e tij personale gjithçka ai kishte arritur dhe Zoti nuk kishte të bënte fare me këtë gjë. Shumë burime Hebreje dhe Zoroastriane e konfirmojnë faktin se Nimrodi adhuronte Zotat-Idhuj të bërë prej guri apo druri.

Kushi dhe gruaja e tij nuk ishin të kënaqur me mënyrën e mësimdhënies së Manitonit dhe me mosbindjen e Nimrodit ndaj Zotit; sidoqoftë, ata e kuptuan se ishte dinjitoze për një mbret të kishte një djalë nën kujdesin edukativ të Manitonit. Manitoni ishte një mik i familjes dhe ai njihej si njeriu më i zgjuar dhe më i edukuar në Tokë, kështu që Kushi e toleroi qëndrimin e Manitonit dhe

Nimrodit përkundrejt Zotit, ndonëse ai nuk e pëlqente aspak atë. Kushi shpresonte, që Nimrodi të mund të merrte edukimin më të mirë të mundshëm. Kushi dhe gruaja e tij planifikuan të presin dhe të mos e trazojnë edukimin e fëmijëve të tyre, sepse ata mendonin, se më vonë ata do të mund të ndikonin tek fëmijët e tyre për t'u mësuar dashurinë dhe respektin ndaj Zotit, siç bënin edhe ata.

Manitoni gjithnjë e paraqiste veten e tij si një vëlla të Kushit, ndonëse ata nuk kishin lidhje gjaku. Pas një lëngimi të gjatë për shkak të një sëmundjeje të panjohur, Kushi vdiq. Kur vdiq Kushi, Mbreti Maniton bekoji Zotin, që i mori jetën Kushit. Manitoni përfitoi nga rasti për të rritur influencën e tij mbi pasardhësit e Kushit. Kështu, ai këmbënguli, që kufoma e Kushit të digjej në majë të një mali në Manaea, të cilin ai e emërtoi me emrin e Kushit përpara funeralit, ku ai do të mund të lutej për ringjalljen e mbretit. Nimrodi dëgjoi këshillën e Manitonit dhe ndikoi mbi vëllezërit e tij, që të pajtoheshin me këtë ide dhe të pranonin rekomandimin e Manitonit. Shumë shpejt, Familja Mbretërore pranoi propozimin e Manitonit; kështu, Kushi u dogj në Manaea, në majë të malit Kush (Kuh-e-Kush në gjuhën Persiane) të emërtuar nga Mbreti Maniton, i cili vulosi varrin e Mbretit të Titanëve.

Sipas Sir Henry Rawlinson, Kush ishte i pari Belus dhe i pari mbret i Babilonisë dhe Nimrodi ishte Belusi i dytë. Bel Nimrod (Bel Nimrod ka qenë njohur si Bilu Nipru në Babiloni) është përmendur në versionin Septuagint (Septu-a-gint ose Septu-a-Kint prej fjalës septic ose septum, që nënkupton një mur ose një ndarje, dhe kint, që nënkupton njohuri) të Testamentit të Vjetër. Në Egjipt, ku Septuaginti është përkthyer, gërmat M dhe B janë jo të qarta, kështu që emri i Nimrodit mund të jetë Nibrod ose Nebrod, dhe Grekët e përshtatën këtë emër nga Egjiptianët si “Nimrod”. Në të njëjtën mënyrë, emri Maniton është keqpërkthyer në Bouniter. Bouniter (Maniton) është përmendur në Librin e Rotullave (Book of the Rolls) (Kitab al-Magall) si personi, që u mor me formimin e Nimrodit (Mësuesi ose tutori i Nimrodit).

Pasi Kushi ishte djegur, Nimrodi kërkoi këshillën e Manitonit përpara se të merrte fronin e Babilonisë. Shumë shpejt pas kësaj Nimrodi u shpall Mbret i Babilonisë. Torgomi, Manitoni dhe shumë të tjerë, që i paguanin tribute Kushit, përfituan nga situata dhe ndaluan së paguari tribute Nimrodit. Ata besonin, se Nimrodi do ta përforconte pushtetin e tij si mbret i denjë për respektin e tyre dhe tributin, që ata paguanin. Nimrodi u mërzit nga humbja e disa prej vasalëve të tij dhe e tributeve, që ata paguanin; sidoqoftë, ai nuk guxoi t'i deklarojë luftë Torgomit, Manitonit dhe sferave të tjera të influencës. Nimrodi shpresonte se Manitoni, si këshilltar i tij, do të ishte mbështetës dhe do të vazhdonte të paguante tribute, duke influencuar në këtë mënyrë edhe tek vasalët e tjerë, që të bënin të njëjtën gjë dhe të vazhdonin të paguanin tribute. Ai ishte i pakënaqur me pozicionin e këshilltarit të tij kundër pagesës së tributeve ndaj tij. Më pas ai e mendoi këtë gjë dhe e kuptoi, përse një këshilltar nuk duhet t'i paguante tribute nxënësit të tij...

Nimrodi ishte fillestar në artin e të mbretëruarit. Ai njihej si njeri me karakter krejt të ndryshëm nga ai i Kushit. Ai e dinte se i duhej ndihmë për të mundur të qeveriste atë, që i ishte lënë nga perandoria e të jatit. Nimrodi ishte burrë i zgjuar, dhe e kuptoi se ai kishte akoma nevojë për këshillat e Manitonit, me qëllim që të mundte të qeveriste me sukses mbretërinë e tij. Ai, gjithashtu, kërkoi mendimin e Manitonit kur pushtoi Assurin apo Assirinë, një tokë Semite, dhe e bëri atë pjesë të mbretërisë së tij. Assur ose Ash-Ur do të thotë Tokë e Shenjtë ose Hyjnore në gjuhët Assiriane dhe Siriake.

Shpejt, Nimrodi e shndërroi mbretërinë e tij në Tirani, pasi ai nuk shihte rrugë tjetër për të larguar nga njerëzit frikën nga Zoti. Nimrodi vendosi t'i vendosë ata në varësi dhe frikë të vazhdueshme nga fuqia e tij. Ai filloi të shajë publikisht Zotin për shkatërrimin e pasardhësve të Adamit nëpërmjet Përmbytjes. Ai premtoi të përballet me Zotin dhe të hakmerret për vdekjen e Kushit dhe viktimat e Përmbytjes, dhe për këtë Nimrodi u mallkua nga Zoti.

Manetoni ose Manitoni ishte mbreti i popullit Mannaean.

Mannaeanët njiheshin, gjithashtu, si Manaani në shkrimet Urartiane dhe Hittite (Urartu ishte mënyra se si e quanin Assirianët Araratit; kështu, të thuash Urartian, është njëloj si të thuash Araratian) dhe si Mannai prej Akkadianëve. Manitoni ishte një burrë i moshuar dhe ishte gjithashtu shumë i respektuar për ndershmërinë dhe diturinë e tij, pozicionin e tij si mbret, moshën e tij, njohuritë e tija si dhe për eksperiencën si mbret. Mannaeanët praktikonin politeizmin si fe. Ndonëse Manitoni nuk vazhdonte të paguante më tribute, duke u konsideruar si mik i ngushtë i Kushit dhe Nimrodit, ai vazhdoi të mbetej këshilltar i studentit të tij të dashur. Mbreti Maniton i mësoi Nimrodit rreth adhurimit të Zotave-Idhuj, të cilët përfaqësonin Diellin, Hënën dhe Yjet, dhe i shpjegoi marrëdhënien ndërmjet Zjarrit, Ujit, Ajrit dhe Tokës. Nimrodi i besoi Mbretit Maniton; prandaj, ai besonte çdo fjalë të mësuesit të tij, pasi në mendjen e Nimrodit Manitoni ishte një profet i Zotave-Idhuj.

Bel Nimrodi dëshironte të respektohej si një Zot i gjallë në faqen e Tokës, në mënyrë që ai të mund të sfidonte Zotin e Qiellit, dhe ai donte të arrinte diçka të jashtëzakonshme, që emri i tij të jetonte më gjatë se ai vetë; prandaj, ai shkoi në Mannaean për të kërkuar urtësi nga Manitoni për këshilla se si të arrinte madhësitinë. Manitoni i tha atij të bashkonte njerëzit në Tokë dhe të ndërtonte një Kullë aq të madhe dhe të lartë, sa njerëzit të mund ta përdornin atë për të vizituar Zotin e Qiellit, dhe vetëm atëherë Nimrodi mund të sfidonte dhe të mundte Zotin dhe të bëhej Zoti i vetëm i Tokës dhe Qiellit përgjithnjë. Mbreti Mannaean i tha Nimrodit se në mënyrë që të arrinte madhësitinë, ai duhej të mposhte Zotin në një betejë përpara syve të njerëzve.

Nimrodi dëgjoi për veprat e mira të Zotit, nga prindërit e tij dhe të tjerët. Ai gjithashtu dëgjoi për veprat e këqija të Zotit nga Mbreti Maniton dhe miqtë e tij, të cilët ishin po ashtu studentë të Manitonit. Ai dëgjoi se Zoti krijoi Përmbytjen e Madhe dhe e përdori atë për të vrarë njerëzit në Tokë. Ai mendoi se Zoti i mori jetën Kushit, sepse njerëzit thonin se Zoti ishte ai, që vendoste kush jetonte e kush

vdiste. Njerëzit, po ashtu, thonin, se Zoti vendoste kush jeton në Tokë dhe kush në Qiell, dhe ata, që jetonin në Qiell, kishin jetë të përjetëshme. Nimrodi kuptoi, se njerëzit që jetonin në Tokë, eventualisht do të vdisnin, dhe ai nuk donte të vdiste. Ndaj, ai donte të jetonte jetën e tij në Qiell. Nimrodi ndjeu një nevojë për këtë lloj fuqie. Ai donte të kishtë një jetë të përjetëshme dhe të bëhej Zot i Tokës dhe Qiellit; për këtë arsye, ai e kaloi jetën e tij duke u stërvitur dhe duke u përgatitur për betejën e tij me Zotin. Ai shpesh mendonte se si do të ishte të mposhte Zotin e Qiellit. Fjalët inkurajuese të Manitonit i dhanë atij shpresë. Ai e dinte, se ai kishte fuqi Qiellore, sepse ai ishte më i fuqishmi i të gjithë Titanëve, dhe Titanët ishin më të fuqishëm se kushdo tjetër në Tokë. Ai kuptoi, se i kishte këto fuqi qiellore për një arsye, dhe në mendjen e tij kjo arsye ishte të qënit sundues i Tokës dhe Qiellit. Ai ishte mendërisht i përgatitur të bënte çdo gjë, që nevojitej për të kthyer ëndrën e tij në realitet. Gjithçka që i duhej ishte Kulla, për të cilën i tregoi Manitoni, dhe ai ishte i vendosur të ndërtonte Kullën më të madhe mbi Tokë në Babiloni.

Nimrodit i pëlqente ideja e të paturit njerëz që punonin për të për ndërtimin e Kullës; prandaj, ai u dërgoi ftesa të gjithëve t'i bashkoheshin atij dhe ta ndihmonin të ndërtonte Kullën e Babelit. Ai u tha njerëzve, se Babeli (Porta e Zotit) ishte qendra e Tokës; ndaj, Kulla duhej të ndërtohej atje, sepse kështu ishte dëshira e Zotit, dhe Kulla do të ishte ura, që lidhte Tokën me Qiellin. Njerëzit, të cilët morën ftesa nga Nimrodi, u entuziazmuan dhe e pranuan më kënaqësi, pasi ata menduan se mund ta përdornin Kullën për të takuar Zotin. Të motivuar nga ideja e takimit me Zotin shumë njerëz lanë shtëpitë e tyre dhe u zhvendosën në Babiloni, për të ndërtuar Kullën e Madhe.

Lajmi për ndërtimin e Kullës së Madhe u përhap shumë larg, deri në Skithi, Kinë, Baktri, Lumin Indus, Afrikë, Tirren, dhe në tokat e Britonit. Njerëz nga e gjithë bota e njohur donin të merrnin pjesë në ndërtimin e Kullës së Babelit, në mënyrë që të takonin

Zotin. Secili prej tyre kishte qëllime të ndryshme për të takuar Zotin. Pjesa më e madhe kishin qëllime të mira, por kishte dhe nga ata, të cilët ishin stërvitur nga Manitoni për ta urreyer Zotin. Ata kërkonin ta sfidonin Zotin për krijimin e Përmbytjes dhe për vendosjen e një limiti në jetëgjatësinë njerëzore. Ndaj, njerëzit, të cilët morën ftesa, lanë pas tokat e tyre dhe nisën udhëtimin drejt Babilonisë.

Ndërtimi i Kullës së Babelit ishte diçka aq e jashtëzakonshme, sa të gjithë donin të ishin pjesë e ndërtimit të saj. Njerëzit kuptuan, sa frydhënese do të ishte për njerëzimin dhe sa nder do t'i jepte atyre, që do punonin mbi të; prandaj, ideja e ndërtimit të Kullës së Babelit formoi një lëvizje botërore të njerëzve drejt qytetit të Portës së Zotit. Njerëz nga të gjitha anët erdhën në Babiloni. Ata erdhën së bashku me familjet e tyre, ose i lanë familjet dhe të afërmit e tyre pas. Ata erdhën sepse donin të ndihmonin në ndërtimin e Kullës, që të kishin mundësinë të takonin Zotin e Qiellit.

Disa ecën drejt Babilonisë. Të tjerë kishin lloje të ndryshme kafshësh që i përdornin si mjet transporti. Ata të gjithë e kuptuan, se do të duhej një kohë tepër e gjatë për të ndërtuar Kullën e Madhe, ndaj dhe ata erdhën të përgatitur për të qëndruar aq gjatë, sa të ishte e nevojshme për të ndërtuar Kullën. Ata ishin gurgdhendës, marangozë, dhe punëtorë pa zanat. Ata flisnin gjuhë të ndryshme dhe kishin mënyra të ndryshme për ndërtimin e gjërave, dhe gjëja e vetme, që kishin të përbashkët, ishte se ata ishin të gjithë të vendosur të takonin Zotin ose të vdisnin duke u përpjekur...

Njerëzit, të cilët arritën në qytetin (Babel) e Portës së Zotit, u morën në pyetje dhe u vendosën nëpër kampe. Ekzistonin tre kampe, dhe ato ishin të ndara sipas gjenealogjisë. Nimrodi mbante Titanët ose Hamitët, Joktani mbante Semitët, dhe Feneku mbante Xhafetitët. Drejtuesit e kampeve regjistronin çdo person që vinte dhe i jepnin dhoma ku mund të qëndronin. Mëngjesin e nesërm këta njerëz dërgoheshin nëpër vendet e punës të caktuara për ta, që të fillonin punimet mbi ndërtimin e Kullës së Madhe. Shumë

njerëz erdhën në Babiloni për të ndihmuar në ndërtimin e Kullës së Madhe, dhe shumë të tjerë vazhdonin të vinin... Qyteti më i Madh në botë u kthye në shtëpinë e pothuajse çdo njeriu në botën e njohur.

Sipas Xhuanshirit, Hajku dhe vëllezërit e tij ishin të njohur si vëllezërit Torgomianë. Në kohën e tyre ata flisnin të njëjtën gjuhë, dhe kjo ishte Armenishtja e Vjetër (Nairi ose Noi-ri) ose një dialekt i gjuhës Thrake. Ajo ishte gjuha amtare e vendit, ku ishin vendosur Noe dhe pasardhësit e tij. Ata banonin në një vend, që Torgomi e kishte quajtur Hairk ose Hark. Hairk nënkupton stërgjiyshërit dhe kjo është rrënja e fjalës Armene Hajrenik, që do të thotë Mëmëdhe ose Atdhe, dhe është edhe rrënja e emrit të djalit të tij Ha ose Hajk (Haik). Haju njihet, gjithashtu, edhe si Haos, Heag ose Hiagnes prej popujve me etnicitet të ndryshëm.

Hajku ishte djali më i madh i Torgomit dhe së bashku me vëllezërit e tij, Kartlos ose Kar, Bardos ose Bardan, Movakos ose Movkan, Lekos ose Lekan, Heros ose Heran, Kaukaz ose Kavkan, Egros ose Ajar, jetonin në tokat në jug të Maleve Kaukaze, në veri të Mesopotamisë, ndërmjet dy deteve. E gjithë ajo zonë njihet si Mbretëria e Torgomit (Toka e Togarmahut).

Kur djemtë e Torgomit u rritën dhe erdhën në moshë, ai nuk dëshiroi t'i mbajë ata nën një çati me të. Ai mendoi, se kishte ardhur koha, që t'i jepte secilit pjesën e tokës, që i takonte si trashëgimi, me qëllim që të mos krijonte probleme trashëgimie më pas. Kështu, ai ua ndau tokat bijve të tij dhe i ndihmoi ata të ndërtonin qytete si vendbanime. Secili prej djemve të tij mori pjesën e tokës, që i takonte. Torgomi dëshironte për fëmijët e tij, që ata të kishin secili tokën e vet dhe pavarësinë e vet brenda mbretërisë së vet, ashtu siç kishte vepruar edhe i jati i tij, Tirasi, me të dhe me motrat e vëllezërit e tij, që morën tokën dhe pavarësinë e të vepruarit brenda pronës së tyre, kur ata erdhën në moshë madhore. Vëllezërit Torgomianë ishin të gjatë dhe kockëmëdhenj; pra, ata përfaqësonin pasardhësit e tjerë të Xhafet Oste. Ata ishin luftëtarë të fortë dhe

të aftë. Ata kishin lëkurë të bukur në ngjyrë të hapur dhe flokë po në ngjyrë të hapur (bjondë) siç i kishin edhe pasardhësit e tjerë të Gomerit. Gomeri ishte paraardhësi i Cimmerianëve, Gomeraeg ose Uellsianëve, dhe i shumë kombeve të tjera. Torgomi ndihmoi Gogun, që të luftonte nomadët e veriut, sepse Gomeri ishte aleat i Gogut. Bibla e Shenjtë (Ezekiel 38 dhe 39) përshkruan se si, kur Gogu dhe Gomeri i dërguan ushtritë e tyre kundër Izraelit, Torgomi dhe pasardhës dhe të afërm të tjerë të Tirasit mbajtën anën e Gomerit dhe Gogut në këtë luftë. Në këtë rast, termi Izrael është përdorur në Biblën e Shenjtë për të përshkruar vendndodhjen gjeografike për atë, që në atë kohë ishte toka e popujve Kanaanitë dhe Hamitikë. Emri Izrael i është dhënë vendit, që është njohur si Izrael në kohën e Abrahamit, i cili ka jetuar disa gjenerata më pas.

Ndonëse njerëzit, që shërbenin në ushtrinë e Torgomit, ishin të famshëm si harkëtarë të shquar dhe kalorës të aftë, Torgomi nuk luftoi kundër ushtrive të Kushit, sepse ai e dinte, që do të ishte një çmenduri të luftoje kundër Titanëve në fushë të hapur. Gjithashtu, ai nuk shihte unitet ndërmjet mbretërve, që mund të luftonin kundër Kushit. Torgomi, në mënyrë të tërthortë, siguroi mbështetje për pajisjen e kuajve të luftës dhe ai financoi për ata, që vendosën t'i bashkoheshin atij kundër Kushit dhe Titanëve.

Në periudhat e luftës Torgomi dhe pasardhësit e tij qëndruan përkrah Thrakëve dhe pasardhësve të tjerë të Xhafetit. Në kohë paqeje ai mbarështoi dhe stërviti kuajt më të mirë në botën e njohur të deri më atëhere dhe ua shiti ata mbretërve dhe fisnikëve në vendet, ku kuajt ishin të rrallë dhe ku kishte kërkesë të madhe për këtë lloj malli. Torgomi kishte shumë shërbëtorë dhe vartës, të cilët kryenin shumicën e punëve; sidoqoftë, Torgomi dhe djemtë e tij, gjithashtu, ndihmonin kur duhej ndihma e tyre për t'i kryer punët në kohë. Torgomi dhe djemtë e tij shpenzuan shumë kohë duke stërvitur kuajt dhe luftëtarët e tyre, ashtu siç ishte zakon për mbretërit dhe fisnikët e kohës.

\* \* \*

Sipas legendës, një prej këtyre ftesave arriti pranë Hajkut dhe vëllezërve të tij, djemve të Torgomit. Hajku ishte i gjatë, trim dhe i fortë, me sy ngjyrë blu, flokë të verdhë dhe lëkurë në ngjyrë të hapur të shndritshme. Hajku vendosi të marrë pjesë në ndërtimin e Kullës së Madhe. Ai u çlirua nga detyrat e tij në ruajtje të pronës, pasi ai kishte lejen e të jatit, Torgomit, për ta lënë mbretërinë e të jatit, dhe të bashkohej me trimat që kishin shkuar për të kontribuar në ndërtimin e Kullës së Babelit. Hajku u bë gati të nisej; ndërkohë vëllezërit e tij qëndruan në shtëpi për të bërë punët, që Torgomi kishte përcaktuar për ta.

Torgomi kishte qenë një luftëtar i zoti, kur kishte shërbyer në ushtrinë e Gomerit, dhe ai e kishte fituar famën e tij përpara se të martohej dhe të bëhej me fëmijë. Pas vdekjes së Tirasit, Torgomi vendosi të tërhiqej nga jeta ushtarake. Ai merrej me tregtinë e kuajve dhe të mallrave të tjera në këmbim të arit, kallajit dhe mallrave të tjera, që i nevojiteshin për nevojat e familjes dhe Mbretërisë. Për këtë qëllim ai ndërmori udhëtime të shumta dhe njohu rrugët. Ai mësoi se si duhej të sillej me popuj të ndryshëm. Ai fitoi respektin e fqinjëve dhe të fisnikëve të vendeve të tjera; pas kësaj, ai vendosi të udhëtojë bashkë me Hajkun për të garantuar sigurinë dhe respektin e djalit të tij në vendet e huaja. Torgomi dëshironte, që Hajku ta shijonte udhëtimin e tij në Babiloni; kështu, përgjatë rrugës për në Qytetin e Madh, ai u kujdes që të ndalonte në çdo qytet ku kalonte dhe bleu diçka në secilin prej tyre, me qëllim që Hajkut t'i ngeleshin në mendje këto momente. Në rrugën për në Babiloni, Torgomi tregonte histori rreth vendeve, që kishte vizituar dhe njerëzve me të cilët kishte pasur të bënte. Hajku ishte shumë i kënaqur teksa kalonte nëpër fshatra dhe qytete të mbretërive të tjera, dhe veçanërisht u emocionua shumë gjatë vizitës në Babilon dhe kur pa punimet në Kullën e Madhe, e cila do t'i lejonte njeriut të takonte Zotin. Shumë herë kishte ëndërruar ai se si mund të dukej Qielli. Kur ata arritën

në Babilon, Hajku u mrekullua aq shumë nga bukuria e tij, sa që mendoi se Babiloni ishte reflektimi i Qjellit në Tokë.

Torgomi i siguroi Hajkut një takim me Nimrodin, djalin e Kushit, me Joktanin, djalin e Eberit, dhe me Feneçin, djalin e Dodanimit, me qëllim që të tre drejtuesit e ndërtimit të Kullës së madhe të Babelit të mund të njiheshin me të. Torgomi i kërkoi Nimrodit, që të mund të siguronte mjetet e nevojshme të jetesës për djalin e tij, pasi Nimrodi ishte Mbret i Babilonisë. Nimrodi u ndje i nderuar, që Torgomi i kërkoi atij të siguronte mjetet e nevojshme të jetesës për Hajkun, në vend që t'ja kërkonte këtë favor Feneçit, një pasardhësi të Xhafetit. Feneçi ishte në krye të pasardhësve të Xhafetit në Babilon. Torgomi dhe Hajku, gjithashtu, ishin pasardhës të Xhafetit, dhe Torgomi kishte shumë respekt për Feneçin; sidoqoftë, Torgomi, duke e ditur që Nimrodi ishte mbret i Babilonit, e trajtoi çështjen e Hajkut me Nimrodin, duke pasur ndër mend të ardhmen e Hajkut në mbretërinë e Nimrodit. Bel Nimrodi e vendosi Hajkun në kampin e Titanëve, i cili ishte nën kujdesin e tij. Nimrodi i premtoi Torgomit se Hajku do të ishte nën kujdesin e tij, pas së cilës Torgomi, i cili tashmë i kishte shitur kuajt, e pagoi Nimrodin për strehimin dhe ushqimin



Pamje e Babilonisë

e Hajkut. Torgomi u kthye në mbretërinë e tij për t'u kujdesur për familjen dhe vartësit e tij.

Hajku ju bashkua Titanidëve, që ishin nën udhëheqjen e Bel Nimrodit, Mbret i Assirisë dhe Babilonisë, për ndërtimin e Kullës legjendare të Babelit, e cila ishte paracaktuar të takonte Tokën me Qiellin dhe njerëzit me Zotin. Për shumë vite rradhazi Hajku punoi së bashku me Titanët dhe shumë trima të tjerë, të cilët dëshironin të arrinin Zotin e Qiellit.

\* \* \*

### Pasioni i Nimrodit për pushtet dhe madhështi

Përgjatë qëndrimit të tij në Babilon, ai (Hajku) u martua dhe u trashëgua me djemtë e tij: Aramaniak, Khor dhe Manavaz, si edhe me shtatë vajza.

Fatkeqësisht, unë nuk isha i aftë të gjej emrin e gruas së Hajkut dhe të shtatë vajzave të tij. Gruaja e tij mund të ketë qenë me prejardhje Hamitike, Semitike ose Xhafetike, sepse ai u martua në Babiloni. Ka mundësi, që Hajku të ketë pasur më shumë se një grua. Për fat të keq, informacioni rreth gruas dhe vajzave të Hajkut do të mbetet një çështje e hapur, përderisa studjuesit të mund të gjejnë të dhëna të mjaftueshme dhe fakte mbështetëse për një përgjigje të saktë.

E njëjta legjendë pohon, se Torgomi e vizitonte Hajkun dhe familjen e tij një herë në vit. Ai shiste kuaj dhe mallra të tjera në Babiloni. Ai paguante Nimroditin për shpenzimet e Hajkut për strehim dhe ushqim, si edhe i jepte Hajkut disa monedha ari dhe sende të tjera, që t'i kishte për nevoja shpenzimi vetiak dhe për familjen. Kjo provon, se Torgomi ishte një baba i përkushtuar dhe një gjysh i dashur.

Sipas Biblës së Shenjtë, u desh një punë e stërmundimshme dhe shumë vjeçare deri sa Kulla e Babelit u bë aq e madhe, sa u bë e dukshme për Zotin në Qiell. Kulla ishte aq e madhe, sa duheshin tre

ditë për t'i ardhur rreth e përqark. Atëhere, Zoti i vërtetë mundi të kuptojë se çfarë po ndodhte në Tokë dhe Ai (Zoti) mallkoi gjuhët e njerëzve dhe njerëzit filluan të flasin gjuhë të ndryshme dhe nuk po arrinin ta kuptonin më njeri tjetrin, duke e lënë kështu të pambaruar Kullën vigane.

Në realitet, kur Nimrodi dërgoi ftesa për njerëzit që të merrnin pjesë në ndërtimin e Kullës së Madhe, njerëzit nga vendet pranë Babilonisë arritën të parët. Më vonë, me kalimin e muajve dhe viteve, filluan të vijnë gjithnjë e më tepër njerëz; tashmë ata vinin nga Skithia, Kina, Baktria, Lumi Indus, Afrika, Tirrenia dhe vendet Bretone. Çdo ditë arrinte nga një grup i ri dhe Nimrodi i caktoi ata në kampingjet e tyre, pranë sipërfaqes ku punohej. Secilit i caktohej detyra sipas mjeshtërisë që kishte. Disa përgatishnin tullat, pasi shkëmbinjtë dhe gurët ishin të rrallë në Babiloni dhe ishte e vështirë të transportoheshin sasi të mëdha materialesh ndërtimi për shkak të terrenit dhe shpenzimeve, të cilat lidheshin me këtë detyrë. Të tjerë punonin në ndërtim. Ishte me kosto më efektive përgatitja e tullave duke përdorur rërë, gëlqere dhe materiale të tjera, që gjendeshin me shumicë në rrethinat e qytetit.

Kishte një pengesë gjuhësore. Shumë njerëz ishin të paaftë të komunikonin dhe të merreshin vesh me njeri tjetrin, sepse flisnin gjuhë të ndryshme dhe e vetmja gjë që i bashkonte, ishte dëshira për të punuar aq shumë sa mundnin dhe sa më gjatë që të mundnin, me qëllim që të kishin fatin të shikonin Zotin. Njerëz nga të gjitha anët e Botës, që njihej deri më atëhere, jetonin dhe punonin në ndërtimin e objektit. Ata, të gjithë së bashku, punonin në ndërtimin e Kullës së Madhe. Ata punuan për shumë vjet, por puna dukej të ishte një detyrë që nuk kishte të mbaruar. Të gjitha rezervat njerëzore dhe materiale të botës së njohur ishin investuar në realizimin e këtij projekti. Tashmë kishte më pak njerëz që merreshin me bujqësi; si rezultat filloi të mungojë ushqimi. Gjithashtu, u pakësuan mundësitë për materiale ndërtimi. Punës nuk po i dukej fundi, pasi ajo shkonte gjithmonë për prodhimin e mijëra tullave çdo ditë dhe

për transportimin e tyre deri tek Kulla, ku muratorët vendosnin tullat njera pas tjetrës, duke përdorur gëlqere dhe rërë në rolin e lidhësit ndërmjet tyre.

Libri i Xhasherit (Jasher) pohon, se pjesë të Kullës u shembën për shkak të gabimeve në projekt dhe punës së dobët, duke vrarë qindra burra nga ata që punonin brenda Kullës. Ata, që punonin jashtë dhe i mbijetuan shembjeve vdekjeprurëse të pjesëve të Kullës, kundërshtuan të vazhdonin të punonin më tej ose e braktisën vendin e punës, pasi ishin të frikësuar; kështu, u vendos që ndërtimi i Kullës të lihej i papërfunduar...

Hajku dhe shumë të tjerë u ndjenë të zhgënjyer, kur Nimrodi vendosi të ndalojë punimet tek Kulla. Hajku kishte shpenzuar pjesën më të madhe të jetës së tij në Babiloni, larg prej prindërve dhe vëllezërve të tij, me qëllim që të punonte për ndërtimin e Kullës, që ishte bërë ëndrra e jetës së tij. Ai u martua dhe u bë atje me tre djem dhe shtatë vajza. Hajku i kishte premtuar familjes së tij, që ndonjë ditë, kur të kishte përfunduar së ndërtuari Kulla e Babelit, pasardhësit e tij do të ishin në gjendje të shihnin Zotin, dhe tani ja...

Ai jo vetëm ndjeu që ishte mashtruar, por u ndje keq se kishte gënjyer edhe familjen e tij, dhe se ai së bashku me gjithë familjen e tij kishin jetuar brenda një mashtrimi të madh për kaq shumë vjet. Torgomi kishte dëgjuar rreth shembjes së Kullës së Babelit dhe vendimit të Nimrodit për të ndaluar punimet për ndërtimin e Kullës së Madhe. Gjithashtu, njerëzit e njohur i treguan atij, se Hajku dhe njerëzit e tij nuk ishin dëmtuar dhe ishin mirë. Kështu, Torgomi u përgatit për kthimin e Hajkut. Për disa arsye, Hajku qëndroi në Babiloni. Torgomi ishte i shqetësuar për Hajkun. Atë vit, ndërsa priste Hajkun, Torgomi u sëmur dhe nuk arriti të dërgojë kuaj në Babiloni. Tregtarët, që blenin drithë prej Torgomit, u ftuan në pallat, ku Torgomi u kërkoi miqve të tij tregtarë, që të flisnin me Hajkun kur të shkonin në Babiloni dhe ata i dhanë fjalën, se do t'ja kryenin këtë kërkesë...

\* \* \*

Hajku shpresonte të shihte të jatin përsëri, pasi edhe ai ishte i shqetësuar për Torgomin; ndërkohë, nuk pati asnjë lajm nga i jati. Tregtarët, të cilët zakonisht bashkëpunonin me Torgomin, erdhën në Babiloni për të tregtuar mallrat e tyre. Hajku i njohu ata, dhe i pyeti për të jatin. Ata i thanë Hajkut se Torgomi ishte në pritje të kthimit të tij. Hajku e kishte ndjerë mungesën e të jatit dhe të vëllezërve të tij. Ai ishte ndjerë i zhgënjyer nga dështimi i Kullës së Babelit. Hajku dëshironte të kthehej në shtëpi, për më tepër edhe sepse tregtarët i kishin treguar atij se Torgomi ishte i sëmurë. Ai u kërkoi tregtarëve nëse mund ta merrnin atë dhe familjen e tij e ta kthenin në shtëpi, pranë babait dhe vëllezërve. Tregtarët pranuan kërkesën e tij.

Atë mbrëmje, Nimrodi dërgoi një lajmëtar për të, dhe Hajku, së bashku me djemtë dhe njerëzit e tjerë të tij u paraqit në hyrjen ballore të Pallatit të Belit, ku populli ishte mbledhur për të dëgjuar fjalën e Nimrodit. Ata shpresonin se Nimrodi do t'i lejonte ata të ktheheshin pranë vendeve dhe familjeve të tyre, dhe u ndjenë të tronditur, kur ai i vendosi ata në njësitë e tij ushtarake (i mobilizoi në ushtri).

Pasi Nimrodi shpalli vendimin për ndalimin e punimeve tek Kulla e Babelit, njerëzit që kishin punuar për ndërtimin e saj u ndjenë të zhgënjyer dhe dëshironin të ktheheshin në vendet e tyre dhe të bashkoheshin me familjet e tyre. Manitoni dhe Nimrodi ishin veçanërisht të mërzhitur, pasi kishte qenë ideja e tyre për të ngritur Kullën, dhe dështimi i Kullës ishte dështimi i tyre. Ndonëse njerëzit nuk flisnin për këtë gjë, Nimrodi e pa se çfarë ndjente populli për Babiloninë dhe çfarë opinioni kishin krijuar për të, dhe e vetmja rrugë për t'i shpëtuar turpërimit për dështimin në ndërtimin e Kullës ishte një luftë.

Hajku dhe familja e tij vështruan me dëshpërim se si tregtarët e

lanë Babiloninë, ndërkohë që ata ishin të detyruar të qëndronin atje për shkak të urdhërit të Nimrodit. Hajku ftoi të gjithë krushqinë e tij për drekë pranë familjes së tij, pasi tashmë ai kishte marrë vesh se Nimrodi po përgatitej për të filluar një luftë. Ai u tha atyre që të përgatiteshin, se ishin në prag të një lufte, se qenë mobilizuar në ushtri, dhe se lufta do të mund të zgjaste shumë vite dhe mund të merrte shumë jetë, ndoshta edhe të tyre, gjithashtu...

Me qëllim që të mbante rezervat njerëzore, që kishte grumbulluar në Babiloni, Bel Nimrodi vendosi t'i përdorë ata si ushtarë. Nimrodi shpalli se askush nuk lejohej të braktiste Babiloninë pa miratimin e tij dhe ai gjente gjithnjë ndonjë arsye për të penguar njerëzit të largoheshin; kështu, ai kurrë nuk miratoi largimin e ndonjerit. Ai i vuri Titanët, që t'i mbanin nën vëzhgim njerëzit; askush nuk kishte guxim të përballej me Titanët. Me njerëzit që kishte, Nimrodi krijoi njësi këmbësorie dhe kalorësie. Në varësi të aftësisë së gjithsecilit, ai i bashkoi në njësi, ku ata mund të shpalosnin më mirë aftësitë e tyre.

Ushtritë e Belit filluan të pushtojnë mbretëri të vogla dhe të zmadhonin territoret e mbretërisë së Belit. Hajku ishte emëruar në krye të një njësie kalorësie të përbërë prej treqind burrash trima, të cilët ishin miq të tij ose të lidhur me të nëpërmjet martesave të bijve dhe vajzave të tij. Hajku dhe trimat e tij e ndihmuan Bel Nimrodin t'i pushtonte këto mbretëri. Nimrodi nuk e ndante plaçkën e luftës me trimat e tij, as edhe nuk i jepte titull nderi ndokujt për shërbimet e tij, pasi ai mendonte, se njerëzit e kishin detyrim t'i shërbenin atij, pasi ai ishte personifikimi i Zotit në Tokë. Njerëzit i shërbenin Nimrodit prej frikës, dhe për shërbimin e tyre ata merrnin vetëm dy ose tre herë në ditë nga një racion ushqimi.

Ushtria e Nimrodit përbëhej prej kalorësisë, qerreve luftarake, deveve dhe elefantëve luftarakë. Nimrodi kishte, gjithashtu, edhe një këmbësori të madhe dhe një njësi speciale Titanësh. Qytet-shtetet Mesopotamiane nuk e kishin luksin që të pajisnin dhe mbanin një ushtri, e cila të mund të krahasohej me atë të Nimrodit. Për shkak të mungesës dhe koston së lartë të kuajve dhe elefantëve, shumë

nga qytet-shtetet Mesopotamiane mund ta pajisnin vetëm me deve kalorësinë e tyre dhe me disa kuaj për qerret luftarake, por devetë ishin të ngadalshme përkundrejt kuajve dhe të dobëta përkundrejt elefantëve. Këmbësoria e tyre ishte shumë më e pakët në numër në krahasim me atë të Nimrodit. Gjithashtu, Nimrodi kishte Titanët, të cilët kishin shërbyer nën Kushin dhe tashmë ishin nën shërbimin e tij si një ushtri e zgjedhur me luftëtarë të pavdekshëm. Ashtu si edhe i jati, Nimrodi i vendosi Titanët nëpër qerre për të maksimalizuar lëvizshmërinë e tyre dhe për të shpërndarë frikë në rradhët e armikut.

Disa qytet-shtete në Mesopotami kundërshtuan t'i dorëzoheshin Nimrodit, por ai arriti t'i mposhtë ata. Disa u mposhtën nëpërmjet tradhtisë, disa nuk mundën t'i mbijetojnë rrethimit, dhe disa të tjerë u mposhtën me forcë. Nimrodi urdhëroi ushtarët e tij që të vrisnin të gjithë ata, të cilët guxuan të kundërshtojnë atë dhe nuk tregoi mëshirë për të gjithë ata që u dorëzuan, pasi ai nuk kishte respekt për frikacakët që dorëzoheshin dhe ai i trajtoi ata si skllëvër. Nimrodi i pëlqente njerëzit që ishin trima dhe rrezikonin jetën e tyre për lavdinë e tij. I tillë ishte edhe Leonoti, komandanti i ushtrive të Nimrodit, i cili e fitoi pozicionin e tij në Babiloni dhe punonte fort për të mbajtur atë që kishte arritur. Beli, gjithashtu, vlerësonte Titanët, pasi ata i kishin shërbyer mirë atij, po ashtu si edhe baballarët e tyre i kishin shërbyer në kohën e tyre babait të tij, Kushit.

Bel Nimrodi nuk ishte korrekt në marrëdhëniet e tij dhe nuk i mbante kurrë premtimet e tij. Ai shpesh përdorte mashtrimin për të pushtuar të tjerët. Nimrodi dhe ushtritë e tij shkatërruan gjithçka ata pushtuan. Ai i lëvizte vartësit e tij nga një vend në tjetrin. Ai ndërtoi qytete dhe vendbanime të reja. Pastaj, ai i mbushte ato me vartës nga mbretëria e tij, të cilët nuk ishin vendas autoktonë. Nimrodi bëri gjithçka, me qëllim që t'i mbante të zënë me punë vartësit e tij, me qëllim që atyre mos t'u shkonte mendja për lirinë. Ai, gjithashtu, u përpoq të krijonte një qytetërim Babilonas, duke detyruar shtetasit e tij të merrnin gra të racave të ndryshme dhe nga grupe të ndryshme etnike.

Ndërkohë që përpiquej të krijonte një komb të ri në Babiloni duke përzier Afrikanë, Mesopotamianë dhe popuj të tjerë, të cilët i shërbenin atij, shumë shpejt ai e kuptoi, se po provonte të realizonte një tjetër projekt, i cili po shkonte drejt dështimit, pasi burrat duhej të kërkonin lejen e tij për t'u divorcuar nga gratë e tyre të reja. Disa prej grave me prejardhje fisnike, gjithashtu, kërkonin lejen e tij për t'u ndarë prej burrave të tyre. Shumë gra nuk ishin të lumtura për shkak të martesave të detyruara me burra, që nuk i kishin zgjedhur vetë; sidoqoftë, ato nuk u lejuan të ankoheshin. Kështu, ato i bënë burrat e tyre të ndjeheshin fatkeqë, dhe burrat ishin të detyruar të kërkonin ndarjen. Kjo ishte zgjidhja më e mirë për secilin që zgjidhte të ndërpriste martesën e vet të palumtur.

Pas pak kohe, disa prej burrave më trima vendosën ta braktisin ushtrinë e Belit, dhe Beli i kapi ata dhe i ndëshkoi publikisht, gjë që shkaktoi akoma më shumë frikë ndërmjet shtetasve të tij. Kjo bëri që më trimat të mendoheshin mirë për pasojat, që mund të shkaktonte largimi prej Babilonisë. T'i shërbeje Nimrodit ishte si një vendim jetësor për nënshtetasit e Perandorisë Babilonase, dhe ata që i shërbenin Nimrodit, i shërbenin atij deri në vdekje....

Hajku i shërbeu ushtrisë së Nimrodit për shumë vjet, deri sa arriti të përpunojë në fshehtësi një plan sekret për të lënë diktatorin dhe të kthehej në shtëpinë e babait të vet. Bel Nimrodi ishte në Uruk me ushtrinë e tij, kur Hajku së bashku me njerëzit e tij ishin caktuar me detyrën e repartit të sigurisë për natën në Qytetin e Babilonit. Hajku vendosi të shfrytëzojë rastin dhe të largohej nga Babilonia një herë e mirë...

Natën, kur të gjithë ishin në gjumë, Hajku dhe familja e tij e përdorën errësirën e natës dhe u larguan nga Qyteti i Babilonit me ndihmën e treqind burrave trima, të cilët i shërbenin Hajkut. Hajku dhe trimat e tij morën të gjithë kuajt, në mënyrë që Babilonasit të mos kishin mundësi t'i ndiqnin dhe u larguan nga qyteti. Mëngjesin e së nesërme, teksa u zgjuan, Babilonasit i gjetën dyert e qytetit të çkyçura, dhe nuk kishte asnjë roje që t'i ruante ato.

Kastelani (gubernatori) i Qytetit të Babilonit ishte Babi, i biri i Nimrodit, të cilit i ishte caktuar detyra e ruajtjes së Babilonit. Menjëherë ai vendosi roje të reja që të mbronin qytetin. Ai, gjithashtu, dërgoi një lajmëtar për të njoftuar Nimrodin, se Hajku dhe treqind të tjerë kishin vjedhur kuajt dhe ishin larguar nga Babiloni. Kastelani dërgoi një mijë ushtarë mbi deve për të gjetur dezertorët, që ata të përballëshin me drejtësinë e Nimrodit në gjykatë...

Hajku dhe familja e tij, së bashku me treqind trimat dhe familjet e tyre, kishin pak orë avantazh ndaj ushtarëve Babilonas, dhe me kalimin e ditëve, distanca midis njerëzve të Hajkut dhe ushtarëve Babilonas që i ndiqnin ata, u kthye në një diferencë ditësh...

Hajku mbante mend rrugët, që ai dhe i ati i tij morën për të shkuar në Babilon, dhe ai vendosi të përdorte të njëjtat rrugë për të garantuar sigurinë e njerëzve të tij. Ata marshuan midis tokave të vasalëve Babilonas duke përdorur errësirën e natës. Më pas, ata marshuan midis tokave të disa popujve Mesopotamas, të cilët dukeshin ndryshe nga Babilonasit. Ata gjithashtu marshuan midis tokave të popujve Asuri ose Asirianë dhe më pas tokave të popujve Lulu ose Lulubi (Lulubi ose Lu-lu-Ibi do të thotë “Adhures të Zjarrit”; nga fjala “Lu”, që do të thotë “person”, ose “Lu-lu”, që do të thotë “njerëz”, në gjuhët Sumeriane dhe Hurro-Urtiane, dhe “Ibi”, që do të thotë “tym” dhe përfaqëson “zjarrin” në gjuhët Sumeriane dhe Hurro-Urtiane) në mënyrë që të arrinin tokat e Torgomit. Si populli Asirian, ashtu dhe ai Lulubi, ishin të nënshtruar të Bel Nimrodit në atë kohë. Ata e pandehën Hajkun dhe trimat e tij si ushtarë të Nimrodit; ndaj, populli Asuri dhe ai Lulubi u ofruan atyre ushqime dhe i lejuan të kalonin nëpër tokat e tyre.

Sipas historianëve Armenë, Ghevond Alishan dhe Katolikos (Kathoghikos) Hovhannes Draskanakerci, ishte një ditë Gushti e bukur dhe me diell, 2500 vite para lindjes së Jezu Krishtit, kur Hajku dhe treqind trimat e tij, së bashku me familjet e tyre, arritën në kufijtë e mbretërisë së Torgomit, ku rojet e kufirit Torgomian konfirmuan identitetin e tij dhe e lejuan të hynte në mbretëri. Hajku

i tha vëllezërve të tij, se Babilonasit mund të vinin pas tij dhe trimave të tij, dhe vëllezërit e tij ofruan ta ndihmonin.

Garda Babilonase, ndërkohë, arriti në kufirin e tokave të Torgomit, ku Hajku dhe aleatët e tij ishin duke i pritur. Papritur, me qindra shigjeta fluturuan në drejtim të trupave të gardës Babilonase. Me qindra prej tyre u rrëzuan nga gamilet. Disa vdiqën, të tjerë u plagosën. Komandanti i gardës Babilonase urdhëroi njerëzit e tij të tërhiqeshin, dhe shpejt pas kësaj, ata vendosën të ktheheshin në Babiloni pa dezertorët...

Bel Nimrodi ishte duke i pritur, ndërkohë, që ata u shfaqën. Nimrodi u zemërua nga fakti që ata dështuan në detyrën e tyre dhe u kthyen në Babiloni si frikacakë. Ai i uli ata të gjithë në statusin e skllavit. Ai i ndau ata në grupe të vegjël dhe i dërgoi në vende ndërtimi për të kryer dënimin e tyre me punë të rëndë.

Hajku dhe trimat e tij u vendosën në tokat, të cilat Hajku i kishte trashëguar nga i jati, Torgomi. Familja e Hajkut ndërtoi një qytet në (Hark) Harq dhe e quajti atë Hajkashen. Hajku, së bashku me treqind trimat e tij, vëllezërit e tij, djemtë dhe nipërit e tij, si edhe pasardhësit e vëllezërve dhe trimave të tij, ndërtuan Mbretërinë e Torgomit dhe e bënë atë të bukur e të fortë. Mbretëria e tyre arrinte nga perëndimi deri në Frigji, pranë Detit të Perëndimit (Deti i Zi), dhe shkonte deri në Kaspiane, tek tokat e nipit të Hajkut, Kaspit, i cili ishte pasardhës i Movkanit. Kaspiani ishte vendosur pranë Detit të Lindjes (Detit Kaspik). Mbretëria e Hajkut arrinte nga Malet e Mëdha (Kaukasus) në veri deri në kufijtë e Mannaeas, Lulubit dhe Assirisë në jug. Hajku dhe aleatët e tij ndërtuan fortesa të reja për të siguruar mbrojtjen e venbanimeve të reja. Ata, gjithashtu, ndërtuan vende adhurimi, ndërkohë, që popullsia rritej dhe vendbanimet lulëzonin. Hajku përdori eksperiencën e tij në artin e përgatitjes së tullave dhe të ndërtimeve prej murature në vendet ku shkëmbinjtë dhe gurët ishin të rrallë. Ai, gjithashtu, stërviti ushtrinë e tij që të ishte e gatshme për luftë kundër ushtrive Babilonase. Njohuritë e tij në ndërtim dhe eksperiencia e fituar prej tij në përvetësimin e

arritjeve strategjike dhe taktike të Nimrodit në beteja dhe në politikë ishin kyçi i sukseseve të tij si udhëheqës.

Mbretëria e Hajkut vazhdonte të lulëzonte. Ata kultivonin fruta dhe perime, barishte dhe erëza, peshkonin peshk dhe gjuanin zogj dhe kafshë për t'i përdorur si ushqim. Torgomianët ishin të famshëm në mbarështimin e kuajve. Ata kishin ushqim të bollshëm, gjë që ndikoi në shtimin e popullsisë. Hajku dhe vëllezërit e tij rekrutuan akoma më tepër njerëz për ushtrinë e tyre. Hajku gjithnjë falenderonte Zotin për atë çfarë ai u kishte siguruar për të ngrënë dhe për të gëzuar. Kështu, ata ndërtuan më shumë objekte kulti ku adhuronin Zotin e Adamit dhe Noes, dhe Zoti i deshi vëllezërit Torgomianë dhe pasardhësit e tyre, dhe Zoti i bekoi ata me gjërat, që atyre u nevojiteshin për të gëzuar shëndet dhe lumturi.

Hajku dhe aleatët e tij festuan fitoren e tyre mbi Babilonasit dhe kthimin e Hajkut në shtëpi së bashku me pasardhësit e tij. Vëllezërit e Hajkut dhe njerëz të tjerë të rëndësishëm të mbretërisë së Torgomit sollën dhurata të kushtueshme dhe argjendurina për Hajkun dhe e pranuan atë si mbretin e tyre, pasi kjo ishte edhe dëshira e Torgomit, që të bënte Hajkun mbret mbi vëllezërit Torgominë dhe fisnikët e tjerë të mbretërisë. Kështu, populli në tërë vendin filloi të festojë Navasardin ose Nauazardin dhe kjo u bë një traditë. Navasard ose Nauazard në gjuhën Ariane do të thotë Zbukurimet e Reja (Dekoratat, Medaljet e Reja). Ai shënon ditën e parë të muajit të parë të Vitit të Ri sipas kalendarit të vjetër Armen (Navasardi shënon Vitin e Ri të kalendarit të vjetër Armen deri sa u pranua Kalendarit Julian në vitin 46 B.C. në Romë dhe në provincat e tjera të Perandorisë Romake) dhe ai festohet gjatë javës së dytë të Gushtit duke nderuar kampionët e Lojrave të Navasardit me zbukurime (dekorata, medalje) të reja.

Pas festimeve, Hajku foli me një person të quajtur Nihor ose Nehur, i cili ishte në krye të një tribuje Hurriane, e cila jetonte në tokat në jug të Liqenit Van. Hajku e nderoi Nihorin duke i emëruar Malet Nihorakan, sipas emrit të fisnikut Hurrian, sepse Nihori dhe Hurrianët e tij i erdhën atij në ndihmë dhe luftuan kundër trupave

Babilonase. Hajku e rregulloi që nipi i tij, Kadmosi, të merrte për grua vajzën e Nihorit.

Kështu, Kadmosi u martua me vajzën e Nihorit. Ai mori si pajë toka së bashku me njerëzit që banonin në to. Nihori dhe Hajku shpallën vendimin e tyre për të marrë në ngarkim dhe në kujdestari tokat dhe njerëzit, që i përkisnin Nihorit. Sipas disa historianëve, emri i saj ishte Zab (Zabel në Armenisht) dhe lumi Zab (Zabu elu në gjuhën Akkadiane) është emërtuar sipas emrit të saj. Lumi Zab është një prej degëve, që furnizojnë Lumin Tigër.

Malet Nihorakan (Koh-i-Niho-rakan në gjuhën Perse) janë një varg malesh të vendosur ndërmjet Liqenit Van dhe Liqenit Kaputan (Liqeni Urmia). Këto male shënonin kufirin ndërmjet tokave të Kadmosit (Distrikti Kartunik i Provincës Korçajk) dhe tokave të Herosit (Distrikti Tamber dhe Distrikti Mari Gavar të Provincës së Parskehajkut) në atë zonë. Gjithashtu, Malet Nihorakan janë vendi i zanafillës së Lumit Zab dhe shumë burimeve të tjera, që janë shumë të rëndësishëm në atë zonë.

Kadmosi ishte një djalosh trim, dhe ishte ngarkuar me detyrën e udhëheqësit të ushtarëve të Nihorit dhe të njëjste patrulluese të kufirit, që Hajku kishte caktuar për të. Nihori dhe njerëzit e tij ishin ngarkuar ta ndihmonin Kadmosin në kryerjen e detyrës së tij. Kadmosi ishte gjithmonë përgjatë kufirit, megjithatë, ai gjente kohë që t'i dhuronte dashuri dhe kujdes gruas dhe fëmijëve të tij. Ai punonte shumë, me qëllim që me arritjet e tij të justifikonte përpara Hajkut, Aramaneakut dhe Nihorit besimin që i kishin dhënë.

Sistemime të tilla ishin bërë edhe për pasardhës të tjerë të Hajkut, të cilët u martuan me aleatë të Hajkut, për ta bërë bashkimin e tyre sa më të fortë. Hajku ishte duke kopjuar strategjitë, që më parë ishin përdorur nga Gomeri, Tirasi dhe Torgomi. Ai e dinte se familja është një grup njerëzish, të cilët janë të lidhur ndërmjet tyre me një lidhje të veçantë, dhe ai u përpoq të bëjë më të mirën e mundshme për të bashkuar aleatët e tij, si të ishin një familje e madhe. Kështu, u bënë

shumë martesë dhe ditëlindje nëpër tërë mbretërinë e Hajkut dhe njerëzit ndjeheshin të lumtur.

Lajmet rreth mbretërisë së Hajkut dhe vëllezërve të tij po përhapeshin me shpejtësi dhe njerëzit po thurrnin legjenda për të. Nimrodit nuk i bëhej fort vonë për këtë, pasi ai e njihte mirë vendin e Torgomit si një vend të ftohtë, ku nuk mund të rritej asgjë për shkak të maleve të lartë dhe të mbuluar me dëborë. Nimrodi e dinte se Noe u mundua, në njëfarë mënyre, të rriste vreshta rrushi në atë vend, por ai (Nimrodi) vetë kishte shumë më tepër rrush dhe ushqime se sa mund të imagjinonte Hajku. Kështu që, mbretëria e Hajkut nga pikëpamja ekonomike nuk kishte ndonjë farë interesi për të.

Bel Nimrodi ishte akoma i inatosur për faktin që Hajku dhe të treqind trimat e tij e braktisën shërbimin dhe vodhën kuajt e tij. Nimrodi donte që t'i kthenin kuajt dhe t'i dënonte dezertorët publikisht për vjedhjen e kuajve dhe braktisjen e detyrës. Ikja e Hajkut nga Babilonia i dha shpresë edhe shumë të tjerëve, dhe shumë prej tyre u përpoqën, por pa sukses. Ata u kapën dhe u dënuan, sepse Nimrodi i kishte paraprirë tentativave të tyre për ikje dhe kishte marrë masat për t'i penguar. Nimrodi mendonte se kishte plot gjëra të tjera më të mira për të bërë në mbretërinë e tij, se sa të shpenzonte kohën duke menduar për ndëshkimin e Hajkut si prioritet. Kështu, për momentin, Nimrodi ishte i zënë me çështje të rëndësishme të mbretërisë së tij...

\* \* \*

## Beteja e parë e Hajkut kundër Titanëve

Legjenda thotë se, pasi dështoi në ndërtimin e kullës së Babelit, Nimrodi donte të bënte diçka të re për të rivendosur dinjitetin e tij të cënuar dhe t'i vinte vulën e madhësisë, kështu që vendosi të pushtojë gjithë botën e njohur prej tij. Pas pushtimit të shumë mbretërive, Nimrodi u ndje i realizuar; sidoqoftë, ai u bë lakmiqar

dhe vazhdoi ta zgjeronte mbretërinë e tij duke pushtuar dhe skllavëruar të tjerët, dhe sa më tepër që pushtonte aq më tepër i shtojte makutëria...

Qytet-Shtetet si Kushi, Giza, Tiri, Babiloni, Ur, Uruk, Akkad, Assur, Elam, Susa dhe Kalneh ju nënshtruan Nimrodit. Ai sundoi në mënyrë të tillë, që Babiloni, nga një qytet që përfaqësonte Parajsën, u shndrrua në perandorinë e Ferrit. Njerëzit, që arrinin të arratiseshin prej Nimrodit, gjenin strehë pranë mbretërisë së Hajkut dhe Hajku i mirëpriti ata me krahë hapur. Tashmë, Nimrodi kishte pushtuar të gjitha tokat Hamitike, shumicën e atyre Semitike, dhe disa prej atyre Xhafetike, kur papritmas i erdhi një parashikim nga Mbreti Maniton, mësuesi dhe këshilltari i tij i besuar. Manitoni parashikonte, që Bel Nimrodi do të vritej prej një pasardhësi të Xhafetit; kështu, pasardhësi i Xhafetit do të pushtonte botën me aq sa e njihnin ata...

Parashikimi erdhi pikërisht në kohën kur Nimrodi kishte planifikuar të pushtonte akoma më tepër toka, që i përkisnin pasardhësve të Xhafetit; kështu që, parashikimi i Manitonit e bëri Nimrodin të zemërohej shumë, pasi Mbreti i Mannaeanëve e kishte këshilluar atë që të kënaqej me atë që kishte dhe të mos bënte asnjë lëvizje kundër pasardhësve të Xhafetit. Bel Nimrodi thirri vëllezërit dhe këshilltarët e tij në një takim, ku ai argumentoi pikëpamjen e tij kundër parashikimit të Manitonit, dhe ai bindi këdo, përfshirë këtu edhe mësuesin e tij, të pajtohej me të në atë që Zotat donin prej tij, që ai t'i vriste pasardhësit e Xhafetit, pasi vetëm duke vlarë të gjithë pasardhësit e Xhafetit, ai do të mund të ishte në gjendje të ndalonte vrasjen e tij prej tyre, ashtu siç parashikonte Manitoni. Nimrodi e shpjegoi parashikimin e Manitonit si një shenjë, që ai ishte destinuar të shkatërronte racën Xhafetike ose të shkatërrohej prej tyre...

Pas një vargu konsultimesh serioze dhe pas analizimit të informacioneve të mbledhura, Bel Nimrodi së bashku me Mbretin Maniton, Leonotin, i cili ishte komandant i ushtrisë së Nimrodit, Manu (Manuk, nga rrënja Manu, është një emër i zakonshëm Armen), i cili ishte komandant i ushtrisë së Manitonit, vëllezërit e



Pamje e Betejës. Pikturuar prej Andre Castaigne gjatë viteve 1898-1899

Nimrodit, dhe Këshilltarët Mbretërorë të të dy mbretërive, vendosën që secili prej tyre të ndiqte planin e përbashkët për pushtimin e secilit prej kombeve Xhafetike. Ushtritë e Nimrodit u nisën për luftë me objekt tokat, të cilat i përkisnin pasardhësve të Xhafetit. Pa e çuar fare ndërmend që kundërshtari i tij mund të shpëtonte dhe mund të hakmerrej, Bel Nimrodi u tregua i pamëshirshëm me vendet që pushtoi, pasi kjo ishte ideja e tij për të ndaluar profecinë e Manitonit.

Sipas një tjetër legjende, Paflagoni ishte djali i Feneçit, dhe kur Paflagoni dëgjoi se si e vrau Nimrodi Feneçin në Babiloni, ai mbajti zi për vdekjen e babait. Paflagoni ishte i qartë për pamundësinë e tij për të vlarë Nimrodin, gjë që kishte krijuar tek fisnikët Fenikas idenë e Paflagonit si një mbret të dobët. Fisnikët Fenikas ngritën krye kundër Paflagonit dhe i kërkuan Nimrodit të ishte mbret i tyre. Paflagoni mori familjen e tij dhe njerëzit që ishin besnikë të tij dhe e lanë Tirin. Ata gjetën strehë tek mbretëria e stërgjyshit të tij (Mbretëria e Rifatit). Kështu, Paflagoni mbeti mbret i Paflagonias dhe Rifati u njoh si paraardhës i Paflagonianëve.

Pak pasi kishte pushtuar tokat e pasardhësve të Tubalit, Nimrodi

u dha atyre rastin që të dorëzoheshin; sidoqoftë, ata vendosën të hipin nëpër anije dhe të ikin larg prej andej, në vende përtej detit. Gaudi dhe pasardhësit e tij, gjithashtu, ja lanë tokat e tyre Nimrodit, pasi kishin humbur disa beteja, dhe edhe ata lundruan larg drejt perëndimit, dhe ata që nuk mundën të hipnin nëpër anije, u përpoqën të shpëtojnë duke gjetur strehim në tokat e Thrakasve (Azia e Vogël) dhe u njohën si Galatianë apo Keltë. Pasardhësit e Mesheçit i lanë tokat e tyre dhe gjetën strehim në tokat e Hajkut. Nimrodit i dukej i çuditshëm fakti që, në vend që t'i dorëzoheshin atij, pasardhësit e Mesheçit kërkuan të gjejnë strehim në mbretërinë e Hajkut.

Bel Nimrodi solli parasysh historinë e Hajkut dhe djemve të Torgomit, të cilët ishin gjithashtu pasardhës të Xhafetit. Ai ishte i shqetësuar për çka kishte ndodhur me Hajkun dhe vëllezërit Torgomianë. Këshilltarët e tij i treguan atij rreth vendit të Hajkut dhe vëllezërve Torgomianë dhe njerëzve të tyre. Nimrodi vendosi se tani kishte ardhur çasti të merrej me Hajkun dhe vëllezërit Torgomianë, duke ndëshkuar në këtë mënyrë Hajkun dhe treqind dezertorët për vjedhjen e kuajve nga Babiloni. Ai (Nimrodi) thirri një nga zyrtarët e tij mbretërorë, i cili kishte marrë pjesë në negociimin e ngjarjeve politike dhe pushtimin e tokave në favor të Babilonisë. Nimrodi e dërgoi këtë njeri si lajmëtar tek Hajku me kërkesën që ky t'i kthente të njëjtin numër kuajsh e me të njëjtën cilësi si ato të kuajve, që ishin vjedhur në Babel. Nimrodi, gjithashtu, i kërkoi që t'i nënshtroheshin atij dhe të bëheshin pjesë e mbretërisë së tij. Menjëherë pas marrjes së urdhërave, lajmëtari e la Babilonin hipur mbi një deve.

Lajmëtari u takua me vëllezërit Torgomianë në qytetin Hajkashen. Hajkashen do të thotë – ndërtuar nga Hajku. Lajmëtari i informoi ata rreth kërkesave të Nimrodit, i cili kërkonte prej Hajkut, që ky t'i kthente të treqind dezertorët së bashku me kuajt e vjedhur përpara se të fillonin bisedimet për paqe, në vend që të zhvillonin një nga luftrat më shkatërrimtare që ishte parë deri më atëhere. Hajku dhe vëllezërit e tij e dëgjuan me qetësi lajmëtarin për gjithë sa tha. Lajmëtari i Nimrodit provoi ndjesi të trazuara

prej qëndrimit të vëllezërve Torgomianë, dhe duke menduar se me aftësinë e tij mund të përhapte frikë ndërmjet tyre, ai vazhdoi edhe me kërkesa të tjera... Bel Nimrodi kërkonte prej Hajkut dhe vëllezërve Torgomianë, gjithashtu, që të ndihmonin ushtritë e tij me luftëtarë kur t'u bëhej thirrje.

Hajku e njihte mirë Nimrodin dhe e dinte se kishte edhe diçka më tepër se sa ato që shprehte lajmëtari; për këtë arsye ai e kapi lajmëtarin dhe e rrahu deri sa ai i tregoi gjithë të vërtetën. Lajmëtarit i rridhte gjak nga hunda dhe nga buzët, dhe ai ndjeu frikë prej Hajkut; prandaj, ai i tregoi vëllezërve Torgomianë se si Mbreti i Madh kërkonte prej vëllezërve Torgomianë, që ata t'i paguanin atij si tribute gurë të çmuar, ar dhe argjend, bronz dhe metale të tjera, kuaj dhe bagëti, dele dhe dhi, qilima si edhe mallra të tjera. Lajmëtari pushoi për një çast dhe vështroi drejt Hajkut dhe vëllezërve të tij. Pastaj, ai mendoi se do të ishte më mirë për të që t'u tregonte se ishte diçka normale për vartësit e Nimrodit të dërgonin vajza të reja, një prej çdo vendi, të cilat do t'i shërbenin dëshirave të mbretit. Duke u përpjekur të përmbante shpërthimin e emocioneve, Hajku e shtyu lajmëtarin mënjanë dhe e pyeti nëse Nimrodi kishte kërkesa të tjera. Menjëherë pasi Hajku kishte bërë pyetjen, ai kuptoi se kërkesat e Nimrodit nuk mbaronin këtu...

Beli vinte si konditë, që t'i lejonte të jetonin dhe të punonin në mbretërinë e Nimrodit, me kusht që, Hajku dhe pasardhësit e Torgomit të pranonin të adhuronin Zotat e Babilonit dhe të flisnin gjuhën e popullit të Babilonit (gjuhën Kushite). Vetëm atëhere, Hajku dhe pasardhësit e Torgomit do të lejoheshin të vendoseshin diku në ndonjë vend të perandorisë së Nimrodit – në tokat e Torgomit apo në qytetin e Babilonit, në varësi të asaj se si do të sillleshin të gjithë Torgomianët ndaj kërkesave të Bel Nimrodit. N.q.s Hajku dhe vëllezërit e tij do t'i plotësonin vetëm pjesërisht këto kërkesa, atëhere ata do të ishin të detyruar të braktisnin tokat e tyre dhe të gjenin strehim në toka të largëta, përtej detit ashtu siç kishin bërë edhe frikacakët e tjerë. N.q.s. do

t'i kundërshtonin Belit, atëhere ata do të vdisnin, nga i pari tek i fundit. Pasi i kishte shpalosur të gjitha kërkesat, lajmëtari i tregoi Hajkut dhe vëllezërve Torgomianë, se ata mund të takoheshin me Bel Nimrodin në Babilon për të saktësuar kushtet përfundimtare, me kusht që, Hajku duhej të sillte me vete tek Nimrodi dezertorët dhe kuajt si shenjë nënshtrimi.

Hajku e njihte mirë Nimrodin dhe ai e dinte se oferta e Nimrodit nuk ishte gjë tjetër përveçse një truk, dhe se kërkesat e tij ishin një çmim tepër i lartë për cilindo mbret për t'u paguar. Hajku i tha lajmëtarit të qëndronte disa ditë, deri sa ai dhe vëllezërit e tij të mund të merrnin një vendim dhe të kishin një përgjigje për Nimrodin. Hajku caktoi dhjetë ushtarë roje, për të siguruar lajmëtarin në fortesë, nën komandën e djalit të tij, Manavazit. Hajku e dinte se kthimi i treqind dezertorëve, që ndihmuan familjen e tij të arratisë prej Babilonit, do ta dëmtonte ushtrinë e tij. Kthimi i kuajve tek Nimrodi do të ishte një tjetër gabim fatal. Hajku u këshillua me vëllezërit e tij dhe së bashku vendosën lirinë ose vdekjen në vend të një jete në skllavëri dhe poshtërim; vëllezërit Torgomianë i refuzuan kërkesat e Belit.

Manavazi dhe rojet shoqëruese e përcollën lajmëtarin deri tek porta kryesore e Hajkashenit. Pasi i treguan lajmëtarit, që përgjigja unanime e tyre për Nimrodin ishte se ata do të pranonin më mirë vdekjen si njerëz të lirë se sa të jetonin si skllavë, ata e lanë të lirë lajmëtarin të largohej nga Hajkasheni. Lajmëtari mori rrugën e kthimit me të njëjtën gamile, me të cilën edhe ishte nisur nga Babiloni. Ai u drejtua drejt jugut, dhe pas disa çastesh, që kishte dalë nga dera e madhe, ai nuk dukej më në horizont.

\* \* \*

Hajku e parashikoi faktin, që herët ose vonë Nimrodi do të bënte diçka kundër Hajkut dhe treqind trimave të tij, të cilët e braktisën

Babiloninë së bashku me kuajt e tyre. Hajku solli ndër mend farkëtarët Babilonas tek përgatisnin armë dhe veshje mbrojtëse për Titanët. Ai e dinte që farkëtarët Babilonas e përdornin bakrin për të bërë armatura trupore, ndërsa për të përgatitur armë dhe përkrenare për Titanët, ata përzienin bakrin me kallaj, që të krijonin një lidhje të fortë bronzi. Luftëtarët e tjerë të ushtrisë Babilonase kishin armatura trupore prej lëkure dhe armët e përgatitura prej bronzi farkëtarët i bënë me lidhje të bakrit me arsenikun. Kur farkëtarët përdornin bakrin dhe arsenikun për të prodhuar bronzin, produkti ishte bronz i varfër dhe relativisht i lirë. Kjo bëhej për arsye ekonomike, pasi kallaji ishte me pakicë në Babiloni, dhe ishte shumë e kushtueshme blerja dhe importimi i bakrit dhe kallajit prej pasardhësve të Kittimit, të cilët jetonin në Qipro. Arseniku i vinte për mbarë farkëtarëve Hamitikë (Kushitë) pasi ai shkrihej edhe me zjarr druri. Shkrija me zjarr druri i vinte për mbarë farkëtarëve Hamitikë, sepse në këtë mënyrë ata kishin mundësi të punonin edhe gjatë ditëve të nxehta në Babiloni dhe Egjypt.

Sipas Riçard Koven (Richard Coven) në U.C.Davis (University of California Davis), Departamenti i Gjeologjisë, bakri përzihej me kallaj ose arsenik për t'i bërë armët të zgjasin më gjatë dhe të qëndrojnë të mprehta. Hekuri në gjendjen e tij natyrale është më i butë se bronzi dhe ai mund të ndryshket; si rrjedhim, hekuri nuk përdorej për të bërë armë. Farkëtarët në Azinë e Vogël dhe Lindjen e Mesme e shkrinin hekurin për të bërë zbukurime, tenxhere dhe tiganë që 2500 vjet B.C. Farkëtarët përdornin zjarr të përgatitur prej druri për të shkrië bakër, kallaj, arsenic dhe metale të tjera. Të shndroje hekurin në çelik kërkohej temperaturë e lartë dhe temperatura e lartë mund të prodhohej vetëm nga djegja e qymyrdrurit. Qymyrdruri prodhonte karbon, i cili i përzier me hekurin krijonte çeliku. Armët e prodhuara prej çeliku ishin më të forta dhe më të lehta se armët e përgatitura prej bronzi. Kështu, shigjetat e përgatitura prej çeliku ishin më të forta dhe më të lehta se shigjetat e përgatitura prej bronzi; kështu që, ato fluturonin më lehtë dhe më larg. I vetmi metal që

mund të depërtonte apo çante bronzin dhe bakrin ishte hekuri ose çeliku i prodhuar prej hekuri, gjatë Epokës së Bronzit. Hajku dhe aleatët e tij duhet ta kishin ditur këtë fakt; sidoqoftë, ekonomikisht ishte shumë e vështirë të pajisje gjithë ushtrinë me armë të tilla. Përkrenaret përmbanin sasi të vogla çeliku në krahasim me shpatat dhe armët e tjera.

Kishte shumë miniera kallaji në Malet Tauros (Tavros në Armenisht) në Azinë e Vogël. Së bashku me Malet Amanos, Malet Taurus ndanin Kilikinë (Cilicia) nga Azia e Vogël dhe Lindja e Mesme. Legjenda thotë se topat e zjarrit dhe të dritës kapërcenin nga një majë në tjetrën në Malet Tauros, a thua se Zotat e lashtë ishin duke luajtur me këta topa magjikë. Kjo zakonisht ndodh gjatë ditëve dhe netëve vjeshtore dhe dëgjohen zhurmat e bubullimave çdo herë që topat e zjarrtë shfaqen në majat e maleve. Ky është një fenomen, të cilin njerëzit mund ta shohin me sytë e tyre. Kështu, këto aktivitete jo të zakonshme në Malet Taurus kanë krijuar një burim të pasur metalesh dhe mineralesh në Azinë e Vogël. Malet Taurus ishin, gjithashtu, vende të rëndësishme për të nxjerrë ar, argjend, hekur, bakër, arsenik, plumb, zink dhe metale e minerale të tjera që në Epokën e Bronzit.

Një kamë me teh hekuri është gjetur në një varr Hattik në Azinë e Vogël, e cila është bërë rreth 2500 vjet B.C. Sipas artikullit të Wikipedias të titulluar “Ferrous Metallurgy”, artifaktet më të vjetra prej hekuri të gjetura, të cilat janë gjetur në Iran, janë të bërë prej hekur-nikeli meteorik. Këto artefakte prej hekuri datojnë në mijëvjeçarin e 5<sup>të</sup> B.C. Burime të ndryshme shkrimore tregojnë që kalimi nga Epoka e Bronzit në atë të Hekurit është bërë në kohë të ndryshme në vende të ndryshme të botës, dhe teoria, që armët prej hekuri janë prodhuar fillimisht prej Hittitëve, nuk qëndron më në fuqi.

Duke marrë parasysh se Hajku dhe familja e tij u kthyen në nbretërinë e Torgomit në Gusht 2500 vjet përpara lindjes së Jesu Krishtit ose B.C., ne na duhet të pranojmë, se Hajku dhe aleatët

e tij qenë gjallë dhe e jetuan periudhën e kalimit të njerëzimit nga Epoka e Bronzit në atë të Hekurit. Historianët dhe arkeologët kanë gjetur se Epoka e Hekurit në Malësitë Armene dhe Azinë e Vogël ka filluar mijëvjeçarë përpara se të arrinte në Europën Perëndimore dhe Veriore.

Hajku e dinte faktin se bronzi copëtohej në pjesë kur ai përplasej me një material më të fortë. Ai e dinte se do ta gjente atë material special, i cili do të bënte të mundur coptimin e armaturave prej bronzi të Titanëve, me qëllim që të fitonte luftën kundër Nimrodit. Hajku vendosi t'i urdhëronte farkëtarët të bënin shigjeta prej këtij materiali special, që mund të ishte hekuri ose çeliku. Legjenda Armene e Hajkut dhe Belit thotë, që Hajku përdori një hark të madh dhe një shigjetë të gjatë për të vrarë Belin. Kjo do të thotë, që Hajku dhe aleatët e tij përdornin harqe të mëdhenj ose të gjatë, dhe shigjetat prej hekuri apo çeliku ishin më të mëdha apo më të gjata se ato të zakonshmet, sepse tani ato ishin më të lehta se shigjetat e përgatitura prej bronzi...

\* \* \*

Lajmëtari i Nimrodit ja dorëzoi Nimrodit mesazhin e Hajkut kur arriti në Babilon. Bel Nimrodi nuk e priste një fyerje të tillë nga Hajku dhe vëllezërit Torgomianë. Ai dërgoi spiunë kudo për të mbledhur informacion prej vendeve të Torgomit. Spiunët, që ishin maskuar si tregtarë, shkuan në tokat e Hajkut dhe vëllezërve të tij, dhe kur u kthyen raportuan se Hajku dhe vëllezërit e tij dukeshin të fortë, dhe do të ishte më mirë për të shfrytëzuar tokat e Mbretit Maniton për të sulmuar vendet e Bardos dhe Movkanit, ku djemtë e Torgomit e prisnin më pak se kudo tjetër një sulm të mundshëm nga ana e ushtrisë Babilonase.

Bel Nimrodi u këshillua me Mbretin Maniton dhe dërgoi një ushtri me 60 (gjashtëdhjetë) Titanë për të ndihmuar Mannaeantë në

pushtimin e tokave lindore të mbretërisë së Hajkut. Që nga koha që kishte refuzuar kërkesat e Belit dhe priste të kishte kundërveprim nga ana e tij, Hajku kishte vënë spiunë, të cilët vrojtonin lëvizjet e armikut. Spiunët i raportuan Hajkut se Beli kishte dërguar një ushtri prej gjashtëdhjetë Titanësh tek Mannaeënët. Hajku e dinte se Bel Nimrodi dhe Mbreti Maniton ishin miq të ngushtë; nga kjo ai kishte arritur në përfundimin se Mannaeënët dhe Titanët po përgatiteshin të marshonin së bashku kundër vëllezërve të tij, Herosit, Bardosit dhe Movkanit, dhe rezultati i kësaj beteje do ta inkurajonte armikun të pushtonte akoma më tepër toka, që i përkisnin Hajkut dhe vëllezërve të tij. Ai e dinte, që Nimrodi dhe Manitoni nuk do të ndalonin deri sa të merrnin gjithçka...

Hajku ju drejtua Madajanëve për ndihmë, sepse ata ishin popull Xhafetik; megjithatë, Madajanët refuzuan të luftonin kundër Manitonit dhe Nimrodit. Ata mendonin se lufta ishte ndërmjet Hajkut dhe Nimrodit. Ata i dhanë Hajkut fjalën e tyre dhe sigurinë se ata nuk do t'i bashkoheshin Nimrodit dhe as nuk do të lejonin Manitonin dhe Nimrodin që të përdornin tokat Madajane për të sulmuar kundër vëllezërve Torgomianë, dhe n.q.s. Manitoni dhe Nimrodi do të hynin me forcë në tokat Madajane, atëhere ata do të kishin një arsye për të luftuar kundër armiqve të Madaias.

Madai ishte martuar me vajzën e Shemit (Libri i Ngjarjeve) dhe banonte në tokat e Shemit. Për fat të keq, unë nuk qeshë në gjendje të gjeja burime të besueshme informacioni ose punime të shkruara, të cilat do të mund të përmbanin emrat e pasardhësve të Madait...

Manitoni dhe Nimrodi e kuptuan se të përdornin tokat në lindje të Liqenit Blu (Azure) ose Liqenit Kaputan për të hyrë në tokat e vëllezërve Torgomianë do të thoshte të fillonin luftë kundër popullit Madaian me prejardhje Xhafetike, gjë e cila mund të çonte me shumë mundësi në bashkimin e tyre me Torgomianët dhe popujt e tjerë Xhafetikë. Ndonëse Nimrodi ishte i prirur të vriste secilin prej pasardhësve Xhafetikë për të evituar profecinë e Manitonit, ai

synoi ta bëjë këtë duke pushtuar secilin më vete, një e nga një, pasi e kuptonte, që e kishte të pamundur t'i pushtonte dhe t'i vriste të gjithë njëkohësisht. Nimrodi pretendonte, se ai vetëm sa donte t'i ndëshkonte Hajkun dhe ata që braktisën shërbimin pranë tij dhe i vodhën kuajt, dhe për këtë rast, sipas gjyqit të Nimrodit, Hajku ishte fajtor për të dyja krimet. Kur Nimrodi u takua me Madajanët dhe pasardhësit e tjerë të Xhafetit, ai e justifikoi veprimin e tij për të ndëshkuar Hajkun si reagim të tijin për paturpësinë e Hajkut dhe të refuzimit të Hajkut për të kthyer kuajt. Çdokush e dinte, se Hajku dhe treqind të tjerët së bashku me familjet e tyre morën kuajt dhe braktisën detyrat e tyre në Babiloni, dhe shumë prej tyre u pajtuan me idenë e Nimrodit për të luftuar kundër Hajkut.

Nimrodi dhe Manitoni planifikuan që Mannaeanët së bashku me gjashtëdhjetë Titanët të hynin në tokat e popullit të Marit, ndërsa Kushitët do të hynin në tokat e Kadmosit. Sipas llogarive të Nimrodit, Hajku nuk do të ishte në gjendje të luftonte njëkohësisht kundër Manitonit dhe Nimrodit. Aleatët e Hajkut do ta braktisnin atë, me qëllim që të mbronin tokat dhe familjet e tyre. Kështu, Hajku do t'i humbiste aleatët, dhe Nimrodi do t'i ndëshkonte ashpërsisht...

Në përputhje me planin e tyre, Manitoni ishte parashikuar të priste deri sa të arrinin ushtritë e Nimrodit në kufirin, i cili ndante tokat e Assurit prej tokave të Kadmosit. Nimrodi ishte akoma në Babiloni kur të gjashtëdhjetë Titanët arritën në Usnu apo Ushnu, që ishte kryeqyteti i Mannaeas. Duke pasur gjashtëdhjetë Titanë nën komandën e tij, Manitoni u ndje i fuqishëm. Mbreti Maniton ishte një mbret krenar dhe shumë lakmiqar. Ai mendoi se do të mund të arrinte ta pushtonte mbretërinë e Hajkut me repartin e gjashtëdhjetë Titanëve dhe njësitë e këmbësorëve dhe kalorësve të Mannaeanasve të tij. Mbreti Maniton donte që të mbante plaçkën dhe tokat si shpërblim për dorëzimin e Hajkut dhe treqind dezertorëve me zinxhirë tek Nimrodi.

Mbreti Maniton nuk priti për Nimrodin. Ai e lëvizi kalorësinë

dhe këmbësorinë e tij prej jugut në perëndim të Liqenit Kaputan ose Liqenit Blu (Azure), ku tokat e sheshta e lejonin ushtrinë dhe qerret e tija luftarake të manovronin drejt tokave të popullit të Marit dhe tokave të Herosit. Manitoni kishte kohë që ja kishte vënë syrin tokave të Marit dhe ai dëshironte që i tërë Liqeni Blu (Azure) të bëhej pjesë e Mbretërisë Mannaeane. Sidoqoftë, ai kurrë nuk do të kishte guxuar të luftonte kundër Torgomit ose Madaianëve i vetëm, pa aleatë. Tani, që kishte mbështetjen e Titanëve dhe Nimrodin si aleat, ai mendoi se kishte ardhur çasti të realizonte ëndrrat dhe qëllimin e vet. Mbreti Maniton hyri në veprim...

Sipas Ghevond Alishanit, Mannaeanët dhe të gjashtëdhjetë Titanët i përdorën tokat e popullit të Marit për t'ju afruar mbretërisë së Hajkut. Tokat e Marit ishin në lindje të tokave të Kadmosit, ndërmjet Maleve Nihorakan (Malet Nihorakan ishin pjesa veriore e Maleve Zagros) dhe Liqenit Kaputan ose Liqenit Blu (Azure). Lumi Marask (Lumi Marask është një lumë i vogël, që e ka burimin në Malet Nihorakan, e që është i vendosur ndërmjet Liqenit Van dhe Liqenit Urmia) kalon nëpër tokat e popullit të Marit dhe zhytet në brigjet jugperëndimore të Liqenit Kaputan ose Liqenit Blu. Lumi Marask përdorej si kufi ndërmjet tokave të Marit dhe Mannaeanëve.

Kur njerëzit e Marit panë ushtrinë e Mannaeanëve të rreshtohesh pranë urës, të cilën ata e përdornin për import-eksportin e mallrave me Mannaeanët, ata informuan Zotin e tyre fisnik, i cili ishte një fisnik i quajtur Marut. Maruti (Marut ose Mari-Ut ka qenë, ndoshta, një titull i barabartë me atë të Guvernatorit sot, pasi Mar nënkupton popullin e Marit ndërsa Ut nënkupton disa gjëra; p.sh.: Utikune ose Udikune do të thotë Guvernator në gjuhën Hurro-Urartiane; Uti nënkupton me Ngrënë ose të përfitosh nga toka në gjuhën Hurro-Urartiane; Uti ose Udi ishte populli që banonte në krahinën e Utikut të Urartu-së, që është një shqiptim Assirian për fjalën Ararat, dhe mbretërinë Armene pas Urartiane, etj.) dërgoi lajmëtarë për të kërkuar ndihmë pranë Torgomianëve dhe Madajanëve. Pastaj Maruti arriti bashkë me trupat e tij tek ura, ku takoi Mbretin Maniton për

të biseduar për arsytet e fillimit të një lufte kundër tij dhe popullit të Marit. Manitoni i foli për Titanët dhe fuqinë e Mannaeanëve. Ai (Manitoni) i kërkoi Marutit të dorëzohej ose vendi i tij do të shkatërrohej prej Titanëve të fuqishëm (Kushitëve) dhe ushtarëve Mannaeanas. Maruti kërkoi kohë disa ditë për të shqyrtuar kushtet e dorëzimit të parashtruara nga Manitoni dhe Manitoni u pajtua me idenë që t'i jepte kohë Marutit të mendohej.

Ashtu siç edhe priste Maruti, lajmëtarët e Marit u kthyen me përgjigje. Lajmëtari i parë u kthye nga Madaia me refuzim. I dyti u kthye me premtimin e Hajkut për të ndihmuar popullin e Marit, pas së cilës Maruti informoi Manitonin për vendimin e tij. Maruti kishte vendosur të mos dorëzohej. Manitoni u zemërua dhe urdhëroi Titanët të fillonin sulmin. Ushtarët e Marit u përpoqën ta shembnin urën ndërkohë që Titanët ishin duke kaluar Lumin Marask nëpërmjet kësaj ure. Ura ishte ndërtuar me gurë dhe gëlqere dhe armët e mjetet e tyre prej bronzi nuk bënë punë në këtë rast. Disa nga ushtarët e Marit i panë Titanët mbi urë. Titanët po përparonin drejt tyre. Ata nxorrën shpatat e tyre dhe nxituan të luftojnë Titanët mbi urë. Titanët ishin më të mëdhenj dhe më të fuqishëm; kështu që, ata ja arritën të përparojnë mbi urë duke vrarë këdo që u dilte përpara. Maruti e kuptoi që ai mund të humbte ushtrinë dhe jetën në këtë betejë, prandaj ai urdhëroi tërheqjen e ushtrisë në drejtim të veriut për nga Lumi Mar, ku ata mund të fshiheshin në male dhe të prisnin për arritjen e trupave të Hajkut. Titanët panë se si ushtarët e Marit vraponin për të shpëtuar jetën; sidoqoftë, Titanët nuk u vunë në ndjekje të ushtrisë së Marit. Titanët siguruan një zonë të gjerë pranë urës dhe sinjalizuan ushtrinë Mannaeanë që të kalonte nga ana tjetër. Ushtria Mannaeanë ia doli të kalonte në anën tjetër të urës dhe avancoi drejt vendit të popullit Mar. Ata morën kontrollin e qytetit të quajtur Shnavh dhe pasi përfunduan së plaçkituri çdo gjë që mundën të gjenin atje, Manitoni urdhëroi ushtrinë e tij të marshonte drejt veriut, pasi fitorja e tij ishte shumë e lehtë dhe ai donte të pushtonte të gjithë Mbretërinë Marastane.

Alarodianët, Burburët, dhe të tjerë, që i kishin shërbyer Torgomit, zotuan besnikërinë e tyre ndaj Hajkut. Tributë e Abeliankut, Setkit, Kajenkut, dhe të tjerë, të cilët ishin të afërm të Hajkut dhe vëllezërve të tij nëpërmjet martesave, iu bashkuan ushtrisë së vëllezërve Torgomianë. Popujt Hurrian, Nairi, dhe të tjerë, të cilët ishin pjesë e mbretërisë së Torgomit, gjithashtu iu bashkuan ushtrisë së Hajkut, dhe së bashku ata nxituan të ndalonin pushtimin e Titanëve dhe Mannaeanëve...

Hajku dhe aleatët e tij arritën me njësitë e tyre ushtarake në vendin ku Hajku kishte planifikuar të luftonte armikun. Maruti dhe populli Mar zotuan aleancën e tyre ndaj Hajkut. Hajku zgjodhi pozicionin më të lartë për ushtrinë e tij dhe i lejoi Mannaeanët që të kishin sipërfaqen e sheshtë, duke bërë në këtë mënyrë që armiku të ishte në fushë të hapur, sepse do i bënte ata shënjestra më të lehta për harkëtarët e Hajkut. Ai e dinte se Titanët do të vinin me koçi (qerre luftarake), pasi kjo ishte mënyra e tyre e lëvizshmërisë në betejë, prandaj ai i lejoi qerret e luftës që të kishin një sipërfaqe të sheshtë që të sulleshin ndaj tij dhe aleatëve të tij, deri sa ata të arrinin në zonën e rrëpirët, ku qerret do të ndalonin brenda rrezes, ku harkëtarët e tij do të kishin mundësinë t'i jepnin fund Titanëve me shigjetat e tyre. Ai e dinte se, pasi ai të hiqte Titanët nga forca e tyre ushtarake, ushtria Mannaeanë mund të mundej lehtësisht. Hajku e pozicionoi ushtrinë e tij sipas planit.

Hajku nuk kishte asnjë deve, dhe ai përdori kuajt e tij për kalorësinë dhe për njësitë e qerreve të luftës. Hajku e dinte se kuajt nuk e duronin erën e deveve; ndaj, ai e mbajti kalorësinë dhe qerret e tij larg njërive kalorsiake të armikut. Hajku i kishte parë Titanët në betejë kur kishte shërbyer në ushtrinë e Nimrodit. Ai e dinte se Titanët ishin forca elitare e Bel Nimrodit dhe secili prej atyre Titanëve mund të vriste dhjetë ose më tepër ushtarë këmbësorë në dyluftim me shpata. Ai e kuptoi se qerret e luftës së Titanëve ishin veçanërisht të rrezikshme. Hajku nuk kishte një ushtri të madhe. Ai i pozicionoi pasardhësit e tij dhe pasardhësit e

vëllezërve të tij në kalorësi dhe qerre lufte dhe mbajti këto njësi si rezerva në vijën e pasme, dhe vuri harkëtarët dhe këmbësorët në vijën e parë për të luftuar Titanët dhe kalorësit Mannaeane. Ishte hera e parë që pasardhësit e Torgomit përballëshin me Titanët në fushën e betejës. Hajku zgjodhi që vendi i betejës të ishte në një luginë të vogël pranë Lumit Mari, midis maleve dhe Liqenit Kaputan, ku Hajku kishte planifikuar të shkatërronte krejtësisht ushtrinë e Titanëve dhe agresorëve Mannaeane, duke shpresuar që ta trembte Nimrodin me fitoren e tij.

Shpejt, Titanët dhe Mannaeanët ndaluan, kur panë ushtrinë e formuar nga Hajku me vëllezërit e tij së bashku me popullin e Marit. Hajku dhe aleatët e tij ishin gati të luftonin kundër tyre. Manitoni i përdori kuajt për qerret luftarake dhe si kalorësi përdori gamilet. Duke vendosur Titanët në qerret luftarake, ai u vu në krye të ushtrisë Mannaeane. Njësitë e kalorësisë Mannaeane u vendosën pas qerreve luftarake për të siguruar mbështetje për Titanët. Mbreti Maniton e la në rezervë këmbësorinë për në sulmin e dytë, për të larë njëherë e mirë hesapet me Torgomianët. Ai pa që ushtria e Hajkut ishte pozicionuar për të përballuar një betejë mbrojtëse, ndërsa ushtria e tij ishte pozicionuar me formacion sulmi. Ai e dinte që nuk mund të mbështetej tek Titanët për të çarë vijën mbrojtëse të Hajkut; sidoqoftë, ai urdhëroi Titanët që të sulmonin. Titanët e hipur në qerret luftarake u turrën kundër trupave të Hajkut. Kalorësia Mannaeane nuk mundi të mbajë ritmin e Titanëve, pasi gamilet vraponin shumë më ngadalë se kuajt.

Kur qerret luftarake arritën në zonën e rrëpirët të luginës, pranë maleve, dhe hynë në rrezen ku mund të kapeshin nga shigjetat, Hajku urdhëroi harkëtarët e tij të godisnin Titanët. Harkëtarët e Hajkut dolën në vijën e parë. Ata kishin harqe dhe shigjeta të mëdha dhe të bëra me metal special, që ishte më i lehtë dhe më i fortë se shigjetat e bëra prej bronzi. Harkëtarët Torgomianë i përdorën këto shigjeta më të mëdha dhe më të forta për të vrarë Titanët, pasi Hajku e dinte se Titanët përdornin një armaturë më të trashë për mbrojtje. Me

qindra shigjeta u lëshuan në drejtim të Titanëve dhe goditën mbi ta. Të gjashtëdhjetë Titanët ranë nga qerret e tyre luftarake, pasi shigjetat depërtuan nëpër armaturat e tyre prej bronzi dhe nëpër organet e tyre jetësore, duke i lënë në vend të vdekur ose duke i dëmtuar rëndë. Humbja e papritur e Titanëve ndryshoi gjithçka, duke e lënë Manitonin pa ndihmë dhe të hutuar në fushën e betejës. Manuja (Manuk) i kërkoi mbretit të tij të përdorte magjinë dhe të ndihmonte Mannaeanët. Manitoni ishte kaq i sigurtë në fitoren e tij sa nuk ishte kujdesur të merrte me vete barërat magjike të tij. Manitoni zbriti nga karroja e tij dhe tha disa fjalë të huaja, të cilat Manuja (Manuku) nuk i kuptoi. Manuja (Manuku) ishte duke dëgjuar mbretin e tij, me qëllim që të kuptonte, nëse mbreti i tij ishte duke u lutur për ndihmë apo ishte duke lëshuar ndonjë mallkim për ndëshkimin e armikut. Ndërkohë që Manuja (Manuku) vështronte mbretin e tij, kalorësia Mannaeanë ishte ndaluar dhe shkatërruar po prej atyre harkëtarëve dhe këmbësorëve, të cilët kishin vrarë edhe Titanët. Këmbësorët e Hajkut dhe harkëtarët përparuan në drejtim të këmbësisë së Mbretit Maniton, ndërsa kalorësia dhe njësitë e qerreve luftarake dolën nga zona e thyer, dhe së bashku e shkatërruan këmbësinë e Manitonit.

Duke parë se magjia e tij ishte e pafuqishme përballë Zotit, që donte Torgomianët, Manitoni ndërpreu gjithçka ishte duke bërë dhe hipi mbi qerren e tij. Manuja (Manuku) dhe Mbreti Maniton kthyen qerret e tyre dhe u përpoqën të shpëtojnë; megjithatë, Lumi Marask bllokoi rrugën e tyre të ikjes, dhe ndërkohë edhe forcat aleate të Hajkut e kishin marrë urën nën kontroll. Manuja (Manuku) dhe Mbreti Maniton e kuptuan që do të ishte e pamundur të kalonin lumin me armaturat e tyre të rënda dhe qerret shumë të rënda, kështu që, ata u kthyen dhe u turrën kundër ushtrisë së Hajkut. Hajku shpresonte që ata të dorëzoheshin; sidoqoftë Manitoni dhe Manuja (Manuku) ishin burra krenarë. Ata e dinin, që Nimrodi nuk do t'ua falte atyre humbjen e gjashtëdhjetë Titanëve dhe do t'i gjykonte ata si frikacakë; kështu, ata vendosën të vdesin në betejë. Harkëtarët e

Hajkut e vranë Manunë (Manukun) dhe Mbretin Maniton në betejë. Vetëm një pakicë luftëtarësh të plagosur Mannaeanë arritën të gjejnë kuaj apo gamile dhe të shpëtojnë nga fusha e betejës. Ata shkuan në perëndim drejt maleve. Kalorësit e Hajkut dominonin t'i ndiqnin, por Hajku urdhëroi t'i linin të iknin. Ai donte që Mannaeanasit, që po iknin, të mund të shkonin tek Nimrodi dhe t'i tregonin atij për bëmat e Torgomianëve. Hajku shpresonte, që fitorja e tyre do ta demoralizonte Nimrodin dhe do ta bënte të tërhiqej nga ideja e vazhdimet të ndjekjes së tyre apo e një lufte të re.

Hajku urdhëroi që të tregohej kujdes për të plagosurit e të dyja palëve. Pastaj ai urdhëroi një ceremoni mortore për të gjithë ata, që ranë në betejë. Ai urdhëroi, që trupi i Mbretit Maniton të digjej në majën më të lartë të malit, në mënyrë që varri i tij të ishte i dukshëm nga të gjithë. Në këmbë të të njëjtit mal Hajku urdhëroi të digjeshin trupat e luftëtarëve Mannaeanë të vdekur nga njera anë dhe nga ana tjetër trupat e luftëtarëve Titanë. Trupat e trimave të vrarë të Hajkut u morën për t'u dërguar pranë familjeve të tyre. Ky ishte viti 2492 përpara lindjes së Jezu Krishtit, dhe shënonte vitin e tetë të kthimit të Hajkut në Vendlindje.

\* \* \*

## Beteja ndërmjet Hajkut dhe Belit

Lajmet e këqija arritën në pallatin e Belit dhe ky u zemërua shumë. Zemërimi i tij ishte shkaktuar nga humbja e Manitonit dhe e gjashtëdhjetë Titanëve. Nimrodi kishte pushtuar shumë vende dhe kishte fituar shumë beteja dhe nuk kishte humbur asnjë Titan. Për herë të parë në jetën e tij, Titanët humbisnin një betejë dhe ai humbiste gjashtëdhjetë Titanë në një betejë të vetme. Pikërisht atëhere, kur çdokush i trembej Titanëve (Kushitëve) si racë, që ishte më e fortë fizikisht se çdo racë tjetër njerëzore, Hajku tregoi se Titanët mund të vriteshin. Nimrodi u shqetësua për tërësinë e



Lufta e Hajkut dhe Belit (Pikturë e Juliano Zasso)

mbretërisë së tij në Babiloni dhe rreth faktit që Hajku mund të ishte ai prej pasardhësve të Xhafetit, i cili ishte parashikuar nga profecia e Manitonit për të shkatërruar Nimrodin dhe Babiloninë.

Nimrodi nuk po dinte se si të sillej me humbjen e tij dhe qëndroi në atë gjendje tronditjeje për më tepër se një cikël hënor. Mbreti, që nuk njihnte frikën, i cili mendonte se ishte shembëllimi i gjallë i Zotit në Tokë, ishte duke provuar ndjenja të çuditshme, të cilat nuk ishte në gjendje t'i shpjegonte. Ai u pa prej shumë mjekëve, të cilët e kontrolluan dhe e gjetën në gjendje të shkëlqyer shëndetsore. Ajo, që mjekët nuk guxuan t'i thoshin Nimrodit, ishte fakti se, paniku dhe ankthi i shfaqur tek ai ishte pasojë e frikës, që e kishte pushtuar prej Hajkut. Mjekët e Nimrodit e dinin fare mirë, se ç'pasoja do të kishin ata dhe familjet e tyre, n.q.s. ata do ta përshkruanin sëmundjen e tij si diçka e shkaktuar prej frikës.

Kur Nimrodi doli nga gjendja e tronditjes, ai pa delegatët e fisnikëve Mannaeane. Mannaeaneët i kërkuan atij të bëhej mbreti i tyre; kështu, ata ja nënshtruan popullin dhe vendin e tyre Nimrodit. Ata i kërkuan atij mbrojtje prej Hajkut. Nimrodi nuk priste, që Mannaeaneët t'i nënshtroheshin atij, ndonëse, Hajku e kishte organizuar që t'i dërgonte Mannaeaneët në oborrin e tij pas vrasjes së Mbretit Maniton, dhe për këtë ata i ishin mirënjohës. Nimrodi mendoi se ky ishte një mesazh i dërguar prej Zotave që atij tashmë nuk i duhej më Manitoni si këshilltar. As në ëndërr ai nuk e kishte çuar nëpër mend që të prekte Mannaeaneët për shkak të respektit për Manitonin, dhe të njëjtët Zota, që Manitoni adhuronte, ja dorëzuan atij tashmë Mbretërinë e Mannaeas për ta qeverisur. Nimrodi ishte i lumtur që po merrte kontrollin e Mannaeas; sidoqoftë, kjo nuk mund ta mbushte boshllëkun, që ishte krijuar brenda tij nga vrasja e Mbretit Maniton dhe e gjashtëdhjetë Titanëve, të cilët ishin shumë të shtrenjtë për të. Ai ishte i dëshpëruar për humbjen e kaq shumë miqve të tij dhe për vdekjen e tyre ai fajësonte Hajkun.

Hajku e kuptonte, që ishte për vullnetin e mirë të Zotit, që ai kishte mundur të mposhtëte armikun; për këtë, ai urdhëroi që të ndërtohej një “dastakert” në vendin ku u zhvillua beteja, e cila u mbyll me fitoren e tyre, dhe ky vend të respektohej si vend kult, ku ai dhe populli i tij bënë kurban desh dhe gjela në nderim të Zotit. Ata e falenderuan Zotin për ndihmën që u erdhi nga Qielli dhe u lutën për heronjtë e rënë. E përkthyer, fjala “dastak” do të thotë “dorë” dhe fjala “kert” do të thotë “e bërë”, kështu që “dastakert” do të thotë “diçka e bërë me dorë” ose “diçka e bërë nga dora e njeriut” dhe shërben si vend adhurimi (kulti). Gjatë mbretërimit të Hajkut u ngritën shumë tempuj “dastakerte”, ku populli mund të falej dhe t'i lutej Zotit.

Hajku ishte i shqetësuar për sigurinë e mbretërisë së tij dhe të popullit të tij; prandaj, ai dërgoi më tepër njësi kalorësie për të patrulluar në kufijtë jugorë. Kufijtë me Madaian, Azhi, Mannaea, Lulubi, Assuri dhe Ishuva ishin në qendër të vëmendjes së tij. Hajkut

i duheshin më shumë aleatë; për këtë ai bëri çmos për të përmirësuar marrëdhëniet me fqinjët e tij. Ai i kushtoi një vëmendje të veçantë Madaias dhe Ishuvas, pasi ata ishin popuj Xhafetikë. Ishuva, e cila dikur ishte mbretëri brenda perandorisë së Tirasit, ishte bërë një mbretëri sovraane kur mbreti Tiras i kishte ndarë dhe dhuruar tokat e tij, në formën e trashëgimisë, djemve dhe vajzave të tij. Është një fakt i njohur, që Ishuvanët ishin popull Hurrian (Sipas shumë historianëve dhe studjuesve, Ishuva dhe Mittani ishin mbretëri Hurriane; megjithatë, unë i klasifikoj Hurrianët tek populli Armen ose të afërmit e tij, sepse Hurro-Urartianët kanë qenë historikisht popull Armen, gjithashtu Milid ose Melitene ka qenë emri i lashtë për Malatia, që ishte një qytet Armen deri sa atë e pushtuan Turqit dhe zbatuan një spastrim etnik, që njihet si Genocidi Armen) dhe Milid ishte kryeqyteti i Ishuvas. Ishuvanët ishin të njohur edhe për mbarështimin e kuajve; sidoqoftë, pavarësisht nga respekti për Torgomin, ata nuk i afruan kurrë klientët e tij, madje edhe pas vdekjes së tij, sepse Kartlosi dhe vëllezërit e tij vazhduan të tregtonin kuaj me klientët e Torgomit ndërsa Hajku ishte në Babilon.

Në atë kohë Mannaea, Assuri dhe Lulubi ishin aleatë të Nimrodit. Nimrodi dërgoi njerëz edhe tek Madaia dhe Ishuva për të kërkuar aleancën e tyre. Në këtë mënyrë ai do të ishte i aftë të pengonte aleancën Xhafetike kundër tij. Hajku ishte në dijeni të faktit, që Nimrodi ishte i aftë të negocionte paqe në këmbim të aleancës me Madaian dhe Ishuva, dhe ai shpresonte, që fqinjët e tij Xhafetikë nuk do t'i bashkoheshin armikut. Nimrodi, nga ana e tij, e dinte që nuk kishte unitet ndërmjet popullit Xhafetik dhe atij Thrakas pas vdekjes së Tirasit; prandaj, ai nuk mendonte se Madajanët dhe Ishuvanët do të mund të ishin aleatë të besueshëm për Hajkun. Nimrodi e rriti influencën e tij mbi Mannaeanët, Azhi, Assurianët si edhe mbi vasalët e nënshtetasit e tjerë të mbretërisë së tij.

Si Hajku, ashtu dhe Nimrodi, krijonin ngjarje politike dhe diplomatike kundër njëri-tjetrit. Ata mendonin se lëvizjet e tyre do të ndihmonin në krijimin e pozitave favorizuese për luftën

e pashmangshme. Nimrodi e dinte se Hajku ishte pasardhës i Xhafetit, i destinuar për ta vrarë atë, dhe nëse Nimrodi nuk mund të vriste pasardhësin e Xhafetit, Hajku mbetej një kërcënim për Nimrodin dhe Babiloninë. Hajku e dinte se Nimrodi ishte një tiran, i cili nuk tregonte mëshirë ndaj askujt, dhe po ashtu, ishte i vetëdijshëm, se ai dhe familja e tij ishin kthyer në armiq të Nimrodit. Ndaj, për të dy mbretërit ishte një çështje për jetë a vdekje të shkatërronin njëri-tjetrin...

Hajku dërgonte më tepër spiunë në Babilon. Spiunët e tij maskoheshin si tregtarë ose lypës. Ata përdornin rrugë të ndryshme për të shmangur dyshimet. Ata hynin në Babilon në kohë të ndryshme dhe rrinin në vende të ndryshme të qytetit. Spiunët tregtarë këmbenin materialet dhe mblidhnin informacione nga qytetarët dhe rojet e Babilonit. Spiunët lypës qëndronin afër pallatit të Nimrodit dhe “zigguratëve” ku Nimrodi lutej. Lypës të tjerë dhe njerëz të pastrehë gjithashtu rrinin pranë pallatit dhe zigguratëve, ndaj qëndrimi pranë strukturave kyçe të qytetit ishte një taktikë e lehtë për t’u përdorur. Edhe pse rojet Babilonase i detyronin ata që të largoheshin nga këto vende, lypësit dhe të pastrehët ktheshin në ato vende, pasi disa nga priftërinjtë u jepnin herë pas here një copë bukë të vjetër ose ushqime të mbetura. Ushqimi ishte një motivues për lypësit dhe të pastrehët që të toleronin fyerjet dhe të qëndronin pranë strukturave të ndaluara. Rojet përshtynin mbi ta, i godisnin, i shkelmonin, ose i detyronin të largoheshin me mënyra të tjera; megjithatë, asnjë roje nuk vriste ose arrestonte lypësit dhe të pastrehët për shkak të statusit të tyre.

Zigguratët ishin tempuj me origjinë Sumeriane, të cilat përbëheshin nga dhoma dhe ndërtime, dhe mbi to qëndronte një faltore, ku vetëm priftërinjtë dhe anëtarët e familjes mbretërore dhe fisnikët lejoheshin të hynin. Për përdorim publik, ishin ndërtuar tempuj më të vegjël e më pak të rëndësishëm. Çdo ziggurat ruhej nga rojet, që ndalonin hyrjen e popullit në tokë të shenjtë. Rojet shpesh herë i detyronin lypësit të largoheshin; ndaj, spiunët lypës lëviznin

nga një vend në tjetrin dhe mundoheshin të kapnin fjalë ose çdo gjë që mund të dëgjonin mbi qëllimet e Nimrodit lidhur më humbjen e Mbretit Maniton dhe gjashtëdhjetë Titanëve, ose për planet e tij për mundësinë e një lufte të re...

Gjatë një rituali kremtimi, Bel Nimrodi hyri në Zigguratin e Babilonit dhe i premtoi publikisht zotave dhe njerëzve të tij se do ta bënte Hajkun dhe vëllezërit e tij, së bashku më pasardhësit e tyre, ta paguanin për vrasjen e gjashtëdhjetë Titanëve dhe Mbretit Maniton. Ai deklaroi, se planifikonte të ndëshkonte armiqtë e tij duke e vrarë publikisht Hajkun dhe bijtë e Torgomit, dhe të detyronte pasardhësit e tyre të shërbenin si skllëvër të Titanëve dhe familjes Mbretërore deri sa të vdisnin...

Edhe pse Nimrodi kërkonte hakmarrje për Titanët dhe mikun e tij të besuar, Manitonin, ai nuk reagoi menjëherë, sepse e dinte që Hajku dhe njerëzit e tij e prisnin një luftë të re dhe do të ishin të përgatitur për të luftuar. Në vend të kësaj, Beli urdhëroi që të mblidheshin në mënyrë sekrete ushtritë e tij, që ai të mund t'i përgatiste ato për një luftë fitimtare kundër Hajkut. Bel Nimrodi në mënyrë sekrete stërviste trimat e tij, ndërkohë që, publikisht sillej si të ishte ende duke vajtuar vdekjet e miqve të tij të afërt.

Humbja e Mbretit Maniton, këshilltarit të besuar të Belit, e bënte këtë të fundit të mendonte më shpesh për parashikimin e Manitonit dhe sa më tepër mendonte për Hajkun, aq më tepër mendonte për bijtë e Xhafetit që e vrisnin atë, dhe aq më tepër ky parashikim ngjante si realitet. Sikur vetëm ta kishte ditur për parashikimin kur e kishte pasur Hajkun në Qytetin Babilon, ai mund të kishte shpëtuar veten nga humbja e gjashtëdhjetë Titanëve, e Mbretit Maniton, dhe nga shumë telashe...

Për herë të parë në jetën e tij, Bel Nimrodi ndjente diçka, që nuk e kishte ndjerë më parë... Ai ishte i frikësuar nga vdekja, dhe çfarë e bënte më keq ishte se ai ishte, gjithashtu, i frikësuar nga Hajku. Ideja se Hajku, si pasardhës i Xhafetit, ishte i destinuar ta vriste, e tmerronte

atë. Hajku ishte askushi... Hajku ishte një harkëtar, i cili u ngrit në një pozitë ku drejtonte treqind “askushë” të tjerë. Hajku u ngrit në detyrë vetëm falë mirësisë së Nimrodit. Papritur, Hajku ishte kthyer në atë, që Mbreti Maniton kishte parashikuar se do të shkatërronte mbretin më të fuqishëm, që bota kishte parë ndonjëherë, një zot për së gjalli, të cilit të gjithë i frikësoheshin dhe të cilin të gjithë e njihnin si Ba'al ose Bel, që do të thoshte Perëndi ose Zot. Ai mund të kishte inskenuar vdekjen e Hajkut si një aksident gjatë ndërtimit të Kullës së Babelit, ose Hajku mund të kishte vdekur në një prej betejave të shumta, ose ai mund të kishte urdhëruar një prej Titanëve të tij ta vriste Hajkun. Megjithatë, Hajku jetonte për të përmbushur profecinë e Manitonit... Këto mendime i vinin shpesh Bel Nimrodit, dhe ai u mundua shumë që të gjente një shpëtim nga mendimet e tij. Ai lutej duke i kaluar ditët e tij nëpër ziggurate të ndryshme, ai vizitonte femrat e tij të preferuara, vizitonte vëllezërit dhe miqtë e tij, pinte verë, por asgjë nuk e ndihmonte. Më pas, ai vendosi të përballej me frikën e tij. Ai vazhdoi të stërviste ushtritë e tij, duke shpresuar ta kuronte dobësinë e tij me kurajë, dhe dukej se kjo gjë e ndihmonte. Gjuetia, gjithashtu, e ndihmonte, pasi çdo herë që vriste një kafshë, ai mendonte për vrasjen e Hajkut, dhe kjo i jepte atij fuqi.

Fitorja e vëllezërve Torgomianë krijoi shpresë për popujt, që ishin nën sundimin e Nimrodit. Shpejt filluan lëvizjet kryengritëse nëpër gjithë mbretërinë e tij. Mbreti i Titanidëve ishte përqëndruar në luftimin kundër rebelëve për të ruajtur të pacënuar perandorinë e tij të fuqishme. Beli i vrau rebelët e çdo rebelimi dhe e ripozicionoi veten si mbreti më i fuqishëm i botës së njohur prej tij. Çdo fitore ndaj rebelëve e ndihmonte atë të rifitonte besimin se një ditë ai do të ishte i aftë që të mposhtëte Hajkun. Nimrodi humbi shumë nga trimat e tij si edhe shumë vjet duke luftuar kundër rebelëve; prandaj, atij i duhej të ngrinte një ushtri të re për të luftuar kundër Hajkut dhe vëllezërve Torgomianë.

Beli nuk u kishte besim vasalëve, por nuk kishte zgjidhje. Ai kishte Titanët dhe ushtarë të tjerë shumë të aftë; megjithatë, atij i duhej një ushtri e madhe për të treguar fuqinë e tij dhe për këtë

vasalët e tij e ndihmuan me sasinë e ushtarëve që i duheshin. Ai e dinte që mund të mbështetej tek Titanët e tij dhe Babilonasi (Kushitët) për të luftuar dhe kjo mund të krijonte tek vasalët e tij dëshirën për të bërë të njëjtën gjë.

Kishin kaluar shumë vjet që nga koha e betejes së gjashtëdhjetë Titanëve dhe ushtrisë Mannaeane. Hajku gjithashtu kishte ngritur një ushtri. Ai e stërviti ushtrinë e tij në malet e vëllait të tij, Kaukazit. Ai i stërviti njerëzit e tij në vende, ku terreni ishte i vështirë, dhe ku spiunëve të Nimrodit nuk do t'ju shkonte ndër mend. Hajku kishte një ushtri të vogël me ushtarë të besuar dhe të shkathët. Hajku e njihte mirë Nimrodin, dhe ai e dinte se Nimrodi nuk e vriste fort mendjen për vasalët. Ai e dinte se vasalët e Belit thirreshin vetëm sa për mbushur numrin e ushtrisë së Babilonisë. Hajku urdhëroi farkëtarët e tij të prodhonin akoma më shumë shigjeta speciale, të cilat e provuan më së miri aftësinë e tyre luftarake kur harkëtarët e tij i përdorën ato shigjeta për të vrarë gjashtëdhjetë Titanët dhe ushtrinë e Mannaeanëve.

Shumë historianë Armenë kanë përmendur se Hajku ishte i gjatë sa gjatësia e tridhjetë e gjashtë burrave të hipur mbi njeri tjetrin, gjë që në fakt nuk është gjë tjetër, përveçse një paraqitje mitologjike e të tridhjetë e gjashtë tribuve apo kombeve, që ishin aleatë dhe mbështetës të tij, dhe mbështetësit e Hajkut vinin duke u shtuar, për shkak të refugjatëve, që lëviznin nga vendet e Gogut dhe Askanazit, si edhe prej vendeve të pushtuara prej Nimrodit. Ata kërkonin liri; prandaj, ata shkuan tek Hajku, pasi ai u dha atyre toka dhe shpresë.

Hajku mirëpriste këdo, pasi ai kishte kuptuar, që njerëzit i bënin mirë ekonomisë dhe tokës. Sa më tepër njerëz që lëviznin, aq më shumë njerëz i bashkoheshin ushtrisë së Hajkut për të luftuar Bel Nimrodin. Pasardhësit e vëllezërve Torgomianë ndërtuan qytete dhe vendbanime të reja për djemtë dhe vajzat e tyre. Hajku bëri gjithë çfarë kishte mundësi për t'ju siguruar kushte njerëzve të tij që të kishin sa më shumë fëmijë. Mushi dhe Moksi u ndërtuan për pasardhësit e Mesheçit, Urtsa ose Ur-Sa u ndërtua për refugjatët nga Uri, Gugarku ose Gogarene u ndërtua për pasardhësit e Gogut,

Kolkida u ndërtua për Kolçisin, Xhavaku u ndërtua për Xhavakosin, si edhe shumë qytete e vendbanime të tjera u ndërtuan për pasardhësit e aleatëve të Hajkut. Gjithashtu, u ndërtuan edhe shumë vendbanime të reja për pasardhësit e Hajkut.

Shpejt pasi ishin ndërtuar vendbanimet e reja në tokat e Torgomianëve, Hajku e dërgoi shumicën e njerëzve të tij në shtëpi për pushime dhe mbajti pranë vetes vetëm ata pak ushtarë pa eksperiencë, me qëllim që të vazhdonte t'i stërviste. Hajku i dërgoi njerëzit nëpër shtëpira, sepse ishte koha për të festuar një ditë të shënuar, që ishte Ekuinoksi i Pranverës. Hajku e kuptonte që njerëzit kishin nevojë të ndihmonin në mbjelljen e zarzavateve nëpër fermat e tyre, me qëllim që, njerëzit e tij të mos vuanin nga uria për shkak të mungesës së ushqimeve, pavarësisht nga rezultati i luftës. Në këtë mënyrë, Hajku shpresonte, se me dërgimin e njerëzve pranë familjeve, ai do të mund të shtonte ndihmën, që i duhej familjeve në këto raste në mbarë mbretërinë e tij.

Marrëdhënia e njeriut me punimin e tokës është e veçantë, që nga koha kur njeriu u shndrrua nga gjahtar në bujk. Njerëzit filluan të mbjellin dhe kultivojnë fruta, zarzavate si edhe të mbarështojnë kafshët në Afrikë, Azinë e Vogël dhe Lindjen e Mesme. Në sajë të këtij aktiviteti, njerëzit vendosën të ngrenë vendbanime, gjë që çoi në ndërtimin e qytet-shteteve dhe formimin e qytetërimeve. Hajku e kishte kuptuar këtë marrëdhënie dhe ai e dinte se njerëzit e tij do të luftonin më mirë, n.q.s. ata do të mund të shihnin të dashurit e tyre dhe do të mund t'i ndihmonin ata sado pak në punët e bujqësisë përpara se të fillonte lufta. Ai e dinte këtë fakt, sepse kjo ishte mënyra se si i kishin përgatitur paraardhësit e tij njerëzit e tyre, përpara se të fillonin luftën.

Spiunët e Hajkut më së fundi u kthyen nga Babilonia. Ata raportuan se Nimrodi ishte personalisht i angazhuar në trajnimin e ushtrisë së tij; prandaj, Hajku e kuptoi se Nimrodi ishte duke stërvitur ushtrinë Babilonase për të filluar një luftë; ndërkohë, Nimrodi ishte duke pritur për diçka, një ngjarje, që do t'i lejonte Nimrodit të

ndërmerre një lëvizje kundër Torgomianëve. Hajku ishte lodhur duke pritur lëvizjen e Nimrodit, por në të njëjtën kohë ushtria e tij nuk ishte mjaftueshëm e madhe sa për të marshuar kundër Babilonisë; prandaj, ai duhej të bënte diçka për ta nxitur Nimrodin, që të marshonte kundër tij. Vendimi i Hajkut për të takuar njerëzit e tyre të dashur për periudhën e festës, e krijuan rastin, që Nimrodi priste. Spiunët e Nimrodit u kthyen në Babiloni dhe raportuan që Hajku i kishte dërguar në shtëpi ushtarët e tij për ditët e festës, dhe gjithkush, i cili ishte i rëndësishëm në mbretëri, nuk ishte më pjesë e ushtrisë së Hajkut, pasi ndërkohë po merreshin me rritjen e fëmijëve dhe të nipërve. Nimrodi i ballafaqoi faktet e mbledhura dhe pa një rast për t'i dhënë fund sukseseve të mbretërisë së Hajkut...

\* \* \*

Shumë studjues të mitologjisë përmendin se Nimrodi ishte një gjigant (Titan) i gjatë sa gjatësia e gjashtëdhjetë burrave të hipur mbi njeri tjetrin. Nuk ka ndonjë dokument shkencor, që të pohojë ekzistencën e qënieve humane të këtyre përmasave në Tokë. Ajo është thjesht një paraqitje mitologjike e gjashtëdhjetë tribuve apo kombeve, që ishin aleatë dhe mbështetës të tij. Disa nga aleatët kryesorë të Nimrodit ishin Kushitët, Egjiptianët, Libianët, Kanaanitët, Babilonasit, Akkadianët, Elamitët, Suzanët, Assirianët, Lulubët, Mannaeanët, Azhit dhe qytet-shtete të tjera vasale.

Lufrat krijojnë mundësi për njerëzit që të përfitonin tituj dhe pasuri; prandaj, shumë trima ishin të gatshëm të rrezikonin jetën e tyre për të patur një shans për të përmirësuar mënyrën e tyre të jetesës. Kështu, brenda disa ditëve që nga njoftimi i urdhërit të tij, një ushtri e madhe trimash nga të gjitha vendet, që përfshiheshin në perandorinë e Nimrodit, erdhën në qytetin e Babilonit për t'ju bashkuar ushtrisë së tij. Ata erdhën për të luftuar një betejë, që bota kurrë më parë nuk e kishte parë, dhe Nimrodi u premtoi

atyre para, pasuri dhe lavdi, gra, skllëvër dhe gjërat, që mund të dëshirojë një burrë. Me mijra ishin ushtarët, që u rreshtuan në rradhët e ushtrisë Babilonase.

Sipas legjendës, Nimrodi mblodhi gjithë komandantët e ushtrisë së tij dhe i informoi ata rreth vendimit të tij për të marshuar drejt veriut kundër Hajkut. Disa ditë më pas, Bel Nimrodi dhe ushtritë e tij kishin dalë nga portat e Babilonit. Trimat panë familjarët e tyre, teksa i përshëndesnin, dhe ata u ndjenë më të fuqishëm. Trimat mendonin se do ta fitonin betejën dhe do të ktheheshin si heronj fitimtarë për shkak se në krye të tyre ishte Bel Nimrodi, dhe Nimrodi nuk kishte humbur kurrë një luftë në jetën e tij. Trimat mendonin, se kjo luftë mund të ishte një rast për t'i bërë krenare familjet e tyre. Gratë qanin, ndërsa shihnin të largoheshin burrat e tyre. Ata burra ishin fëmijët, burrat, vëllezërit, kushërinjtë e tyre, dhe gratë do të mrekulloheshin, n.q.s. do të kishin mundësi t'i shihnin përsëri të dashurit e tyre...

Ushtritë e Nimrodit marshuan mespërmes tokave të Mesopotamisë deri sa arritën në Assur. Këtu Nimrodi i lejoi ushtrive të tij të pushonin. Nga Assuri, ai dërgoi Leonotin me ushtrinë Mannaeane, që duke kaluar përmes maleve, të merrte nën kontroll Mannaeanë. Në këtë mënyrë, ai mendonte të siguronte krahun e djathtë përkundër ndonjë sulmi të Hajkut nga ana e Mannaeasë. Leonoti u kthye dhe raportoi se nuk kishte parë ndonjë shenjë të ushtrisë së Hajkut në Mannaea. Nimrodi nuk kishte dëshirë të bënte të njëjtin gabim, që i kushtoi jetën Manitonit dhe gjashtëdhjetë Titanëve të tij, duke sulmuar tokat e vëllezërve të Hajkut, pasi Hajku zotëronte pozicione të mira mbrojtëse atje dhe ai nuk mund të lejonte që të humbte shumë ushtarë, duke fituar pothuajse asgjë prej kësaj beteje. Nimrodi donte që të sulmonte tokat e Hajkut dhe të shkatërronte udhëheqjen e armikut të tij duke e vrarë Hajkun, gjë që do të çonte në shpërbërjen e mbretërisë Torgomiane në territore më të vogla, të cilat do ta kishte më kollaj t'i përthithte brenda perandorisë së tij. Kështu, ai kishte planifikuar ta mposhtëte Hajkun dhe pastaj të

pushtonte mizorisht secilin prej vëllezërve dhe aleatëve të Hajkut. Ai dërgoi spiunë që të kontrollonin kufirin. Ai donte të dinte nëse Hajku ishte i përgatitur të luftonte për të mbrojtur kufijtë dhe të mbronte tokat e Kadmosit. Ai thirri në mbledhje Leonotin dhe këshilltarët e tij, ku diskutuan dhe planifikuan sulmin e tyre kundër mbretërisë së Hajkut.

\* \* \*

Hajku u dha burrave të tij një muaj leje për ta kaluar me familjet e tyre, menjëherë para luftës, që do t'i jepte mjaftueshëm kohë burrave për t'u shpłodhur dhe për të kuptuar arsyen, se përse duhej të luftonin me armikun, dhe kjo arsye ishte mbrojtja e njerëzve të tyre të dashur dhe tokave të tyre. Kjo kohë ishte e mjaftueshme për spiunët e Nimrodit që të arrinin në Babiloni për t'i treguar mbretit të tyre atë që panë. Hajku po shpresonte se Bel Nimrodi do të përfitonte nga kjo mundësi për të marshuar me ushtritë e tij drejt Hajkut dhe aleatëve të tij. Hajku mbante Rojet Mbretërore pranë vendeve të rëndësishme të mbretërisë së tij, dhe rojet kufitare ishin mjaft të aftë ta ruanin tokën të paprekur. Hajku priste që ushtarët e tij të ktheheshin së shpejti pas Festave, ashtu si i kishte urdhëruar.

Nimrodi po mbështetej në psikologjinë njerëzore, sipas së cilës burrat do të preferonin më mirë të rrinin në shtëpi, ku ishin të sigurt dhe në gjendje rehatie, se sa të rrezikonin jetët e tyre në betejë. Nimrodi mendonte se Hajku bëri një gabim të madh kur i dërgoi burrat e tij nëpër shtëpitë e tyre. Ai mendonte se njerëzit e Hajkut nuk do të rrezikonin jetët e tyre për Hajkun. Bel Nimrodi mendonte se njerëzit luftonin për drejtuesit e tyre dhe se drejtuesit luftonin luftrat për shkak të lakmisë. Ai nuk e kuptoi se njerëzit, gjithashtu, luftonin edhe për të mbrojtur gjërat, që vlerësonin dhe që ishin të rëndësishme për ata. Ishte fakt që, njerëzit e Nimrodit kishin qenë gjithnjë pushtues dhe s'kishin luftuar asnjëherë një luftë

për mbrojtje. Nimrodi po mbështetej në frikën, që Titanët përhapnin tek armiqtë; ndaj, ai ishte i sigurt, se shumë prej mbështetësve të Hajkut nuk do të guxonin të përballëshin me Titanët dhe turmat e mëdha të ushtrisë Babilonase...

Së shpejti, ashtu si shpresonte Hajku, Kadmosi dërgoi një lajmëtar për të informuar se Bel Nimrodi dhe Leonoti, së bashku me një ushtri Titanësh dhe aleatë e të nënshtroar të tjerë të mbretërisë Babilonase kishin mbërritur në kufirin Asuri. Lajmëtari tha se Kadmosi ishte përgatitur të luftonte ushtritë e Belit në kufirin pranë lumit të quajtur Idigina, në mënyrë që ta ndalonte hyrjen e armikut në mbretërinë e Hajkut; megjithatë, ai do të kishte nevojë për pak ndihmë nga të afërmit e tij. Hajku e dinte se burrat e Nimrodit ishin të stërvitur për të pushtuar, dhe se mund ta pushtonin lehtë një kufi. Në fakt, kur Hajku kishte shërbyer në ushtrinë e Nimrodit, ai kishte parë se sa mbretër bënin të njëjtin gabim dhe vuanin humbje të mëdha kur vendosnin të luftonin për kufirin e tyre. Ata mbretër humbisnin beteja të rëndësishme në kufijtë e tyre dhe më pas humbisnin gjithçka. Hajku nuk kishte ndër mend të sakrifikonte burrat e tij në një betejë, që e dinte se nuk mund ta fitonte. Ai e kuptoi se Kadmosi ishte i përgatitur të luftonte për kufirin; megjithatë, Hajku kishte në plan të lejonte burrat e Nimrodit të kalonin kufirin pa një luftë, sepse kishte plane të tjera...

“Idigina” do të thotë “Uji i Madh” (Idigina ishte emri i lashtë i Lumit Tigër) ose “Lumë i Shpejtë” në gjuhën Sumeriane, sepse niveli i tij rritej në stinët me shira dhe e përmbyste zonën përreth. Lumi Idigina ndante Asirinë nga tokat Torgomiane në Mesopotaminë veriore. Gjatë vjeshtës dhe pranverës, niveli i lumit rritej për shkak të shiut dhe shkrirjes së borës nga malet. Uji ishte aq i lartë sa për të mbuluar Titanin më të gjatë, dhe ai mund të mbyste dhe shkatërronte ushtritë e Nimrodit; megjithatë, ishte muaji i Solsticit Veror dhe nuk kishte rënë shi prej muajsh, ndaj dhe ujrat ishin mjaft të cekët. Ushtritë e Nimrodit kishin ngritur kamp pranë lumit, si të ishin duke pritur për dikë ose diçka... Kadmosi i kishte pozicionuar

njerëzit e tij në një vend, nga ku mund të shihte të gjitha lëvizjet e armikut. Nimrodi dërgonte spiunë përtej lumit për të zbuluar zonën, në mënyrë që të njihje pozicionet e ushtrisë së Hajkut. Ndaj, ai ishte në dijeni të faktit, se një njësi e vogël e Hajkut i ruante ata në mënyrë sekrete, dhe ai mendoi se ata po prisnin Hajkun dhe të tjerët që të mbërrinin në vendin e betejës. Prandaj, Nimrodi i dha më tepër kohë ushtrisë së Hajkut që të mbërrinte, që ata të mund të luftonin në kufi.

Hajku dërgoi lajmëtarin sërish të Kadmosi me një mesazh për të mos e sulmuar armikun, por për ta bërë atë të ndiqte njësitë Kadmeane dhe Nihorakane dhe t'i çonte drejt një vendi të quajtur Hajoc Cor (Hayots Dzor), ku Hajku dhe aleatët e tij do të ishin duke pritur armikun. Hajku planifikonte se kjo manovër do të bënte armikun të ndiqte familjet e Nihorit (Nehurit) dhe Kadmosit, ç'ka do t'i jepte Torgomianëve vendndodhjen ekzakte të armikut dhe kohën tepër të vyer, që Hajku të përgatiste ushtrinë Torgomiane për betejë. Ata kishin marrë urdhrat e Hajkut për të mos luftuar me armikun, por për t'u tërhequr dhe për t'u bashkuar me ushtrinë e Hajkut në një vend që quhej Cor, ku fillimisht ishin stërvitur për të luftuar me ushtrinë e Nimrodit. "Cor" do të thotë "luginë e ngushtë" në gjuhën Armene. Ajo u quajt Hajoc Cor (Hayots Dzor) pasi ishte vendi i zgjedhur nga Hajku dhe aleatët e tij për të luftuar për lirinë e tyre. Kadmosi e dinte se ç'duhej të bënte; ndaj, ai i urdhëroi njerëzit e tij të largoheshin me qetësi nga pozicionet e tyre. Kadmosi dhe Nihori larguan njerëzit e tyre nga rreziku i afërt dhe nga zona...

Njerëzit e Nimrodit raportuan se njësi e vogël në anën tjetër të lumit i përkiste Kadmosit, nipit të Hajkut, i cili ishte një lord fisnik i asaj toke. Kur Nimrodi e kuptoi se ishte njësi e nipit të Hajkut, dhe Kadmosi ishte në krye të rojeve të kufirit, ai urdhëroi burrat e tij që ta kapnin njësinë e nipit të Hajkut dhe t'ja sillnin atij menjëherë. Nimrodi po shpresonte se duke patur nipin e Hajkut si të burgosur, kjo do t'i jepte atij një avantazh mbi Hajkun. Nimrodi mendoi se Hajku do të dorëzohej duke këmbyer jetën e tij për atë të Kadmosit dhe ai mund ta shkatërronte Hajkun pa patur nevojë të luftonte në



Foto e Malit Artos dhe Liqenit Van në Krahinën e Hajoc Corit (Hayots Dzor), ku Hajku vrau Bel Nimrodin.

fushë të hapur. Edhe nëse Hajku nuk dorëzohej, ai mund të vriste publikisht nipin e Hajkut, gjë që do të ndikonte në marrëdhënien e Hajkut dhe burrave të tij dhe do të thyente besnikërinë e tyre. Ndaj, Nimrodi krijoi këtë plan për t'u hakmarrë ndaj armikut të tij për vrasjen e Manitonit dhe gjashtëdhjetë Titanëve të tij.

Pak pasi Kadmosi dhe njerëzit e tij u larguan nga pozicionet e tyre, spiunët e Nimrodit raportuan se nuk kishin gjetur asnjë shenjë të Hajkut dhe se njësia e vogël, që kishin parë më parë, nuk ishte më aty. Nimrodi u mërzi me njerëzit e tij dhe me mënyrën se si ata i kishin lënë njerëzit e Hajkut të largoheshin. Ai mendoi se njerëzit e Hajkut ishin frikacakë dhe urdhëroi ushtritë e tij të avanconin brenda mbretërisë së Hajkut. U deshën shumë orë që ushtritë e Nimrodit të kalonin lumin. Kadmosi dhe trimat e tij nuk ishin larg nga armiku. Ata lejonin armikun të dinte pozicionin e tyre duke lëshuar shigjeta

drejt njerëzve të Nimrodit, ose me mjete të tjera, dhe lëviznin sërish për të gjetur një vendndodhje të re, që do t'i lejonte të shqetësonin ushtrinë e Nimrodit, por duke patur mundësinë të largoheshin në mënyrë të sigurt nga ushtarët e Nimrodit. Ata lëviznin nga një vend në tjetrin, deri sa Nimrodi e kuptoi, se pa vetëdijen e tij, ai po bënte atë që donte Hajku. Ai e kuptoi, se Kadmosi po e drejtonte ushtrinë Babilonase drejt një kurthi. Nimrodi e ndaloi ushtrinë e tij në Lumin Xherm pranë Maleve Arnoi. Nimrodi kujtoi faktin, se lajmëtari i tij ishte dërguar në Qytetin Hajkashen, i cili ishte në anën e kundërt të Liqenit Van. Ai ndërroi drejtimin e lëvizjes drejt perëndimit në mënyrë që të arrinte Hajkashenin, vendbanimin e Hajkut.

“Xherm” do të thotë “i ngrohtë” në gjuhën Armene dhe Mali Arnoi kishte marrë emrin nga Noe dhe fjalë për fjalë do të thoshte “Arrn-Noy” ose “i marrë nga Noe”. Kadmosi e kuptoi se Nimrodi kishte ndryshuar drejtim drejt perëndimit përgjatë Lumit Xherm, dhe kishte frikë se mund të kishte bërë diçka gabim për ta shkaktuar lëvizjen e armikut drejt perëndimit, që ishte ana e kundërt nga ku i ishte thënë që duhej ta drejtonte armikun. Lëvizja e Nimrodit e ndryshoi planin e Hajkut; ndaj, Kadmosi e la njësinë e tij nën komandën e vjehrrit të tij, Nihorit, dhe nxitoi drejt Corit për t’u konsultuar me Hajkun. Nihori dhe njësia qëndronin pranë ushtrisë Babilonase dhe vazhdonin ta shqetësonin armikun, në mënyrë që ta ngadalësonin dhe të fitonin kohën që i duhej.

\* \* \*

## Trashëgimia e Hajkut

Hajku po kontrollonte pozicionet e njerëzve të tij, kur arriti Kadmosi. Ai ishte i gëzuar që po shihte nipin e tij, dhe pasi Kadmosi i tregoi atij se çfarë i kishte ndodhur, Hajku nuk e shpenzoi kohën më kot. Ai mori ushtrinë e tij prej pozicioneve pranë Maleve Artos dhe Pashat (Pshat) dhe i çvendosi ata drejt perëndimit. Ushtria e Hajkut

u takua me ushtrinë e Nimrodit në tokat e quajtura Ishajr (Ishair ose Ish-Ajr, sepse Ish do të thotë Ishuva dhe Ajr do të thotë Burrë, kështu Ishajr do të thotë Ishuvan burrë; kjo, një dukuri e qartë që Ishuvanët i prematuan mbështetjen e tyre Hajkut) pranë Lumit Ketsan (Ketsan ose Kets do të thotë “i qëndrueshëm” në gjuhën Armene) ose Lumit të Qëndrueshëm, ku disa prej familjeve Ishuvan kishin vendosur vendbanimet për familjet e tyre.

Nuk dihet nëse Ishuvanët ju bashkuan Hajkut apo jo, sepse ushtritë e Nimrodit hynë në tokat e Ishuvanëve. Ndoshta ushtritë e Nimrodit hynë në tokat e Ishuvanëve për shkak të aleancës me Hajkun. Sidoqoftë, është fakt, se ushtritë e Nimrodit hynë në tokat e Ishuvanëve. Gjithashtu, është mbajtur shënim një aleancë ndërmjet Ishuvanëve dhe Hajkut (Armenëve)...

Ndonëse nuk ka asnjë dokument të shkruar që Paflagonët u rreshtuan përkrah Hajkut, mua më duket e mundur, që Paflagonët, direkt ose indirekt, e mbështetën Hajkun, sepse historia provon se Paflagonët gjithnjë qëndruan përkrah Thrakëve dhe popujve Arianë. Për shembull, Paflagonët u bashkuan me Trojanët kundër Grekëve. Paflagonët u bashkuan me Persianët Akemenidë kundër Grekëve. Paflagonët u bashkuan me Mitridatin e IV Pontus kundër Romakëve dhe armiqve të tjerë të Pontusit. Arsyeja, që unë mendoj se Paflagonët mund t'i jenë bashkuar Hajkut, qëndron në faktin se Feneçi ishte një udhëheqës kampi gjatë ndërtimit të kullës së Babelit, dhe Nimrodi e vrau atë, pasi Feneçi nuk u kthye kurrë nga Babilonia. Historia ka provuar se Paflagoni gjeti strehim në mbretërinë e Rifatit (Paflagonia) dhe Fenikasit ju nënshtuan Nimrodit. Kështu, Paflagoni pati rast dhe motiv për të qëndruar në krah të Hajkut.

Si vend për të zhvilluar betejën Hajku zgjodhi vendin pranë maleve, ku bashkohen Lumenjtë Xherm dhe Ketsan. Hajku e pozicionoi ushtrinë për luftë. Nga njera anë, ai rreshtoi djemtë e Aramenakut dhe të familjeve të tyre së bashku me ata të familjeve Lekan dhe Mohakan. Nga ana tjetër, ai pozicionoi djemtë e Khorit dhe Manavazit dhe të familjeve të tyre, së bashku me ata të familjeve

Bardos dhe Heros. Hajku me vëllezërit e tij, Kartlos, Kaukaz dhe Egros dhe familjet e tyre u pozicionua në qendër. Hajku mbajti si njësi rezervë pasardhësit e Gogut, Mesheçit, dhe refugjatë të tjerë, të cilët i ishin bashkuar ushtrisë së tij. Ishuvanët dhe aleatë të tjerë ishin pozicionuar në malet përreth për të mbrojtur ushtrinë e Hajkut nga ndonjë njësi manovruese e Nimrodit dhe për të vepruar si njësi manovruese e Hajkut, kur ky ta shihte të nevojshme. Ishte një betejë vendimtare, ku Hajku dhe aleatët e tij kishin për të luftuar kundër pasardhësve të Kush Titanit për të mbrojtur lirinë e tyre. Për Hajkun dhe popullin e tij kjo luftë ishte vendimtare, ishte një luftë për mbijetesë, ndërsa për Nimrodin dhe popullin e tij kjo ishte një luftë për të kënaqur krenarinë dhe lakminë e tyre. Hajku vrojtoi ushtritë e Belit, që ishin shtrirë nga të dy anët e lumit Xherm. Xhermi është një degë furnizuese e Lumit Purattu (Purattu është një emër i vjetër i lumit Eufrat). Hajku urdhëroi njerëzit e tij të prisnin deri sa armiku të vinte brenda distancës ku arrinin shigjetat. Shpejt, ushtritë e Belit u bënë të dukshme, dhe hynë në rrezen e goditjes së harkëtarëve të Hajkut. Njerëzit e Hajkut i përshëndetën Titanët dhe mbështetësit e Belit duke u hedhur nga malet gurë të mëdhenj mbi koka. Ata gjithashtu lëshuan shumë shigjeta në drejtim të ushtrive të Nimrodit, por trimat e Belit ishin të shumtë në numër. Ata luftuan gjithë ditën dhe i ndaluan luftimet kur u err. Hajku i urdhëroi njerëzit e tij të ishin në gatishmëri për gjatë gjithë natës.

Nimrodi kuptoi që ishte gabuar në analizën, që i kishte bërë besnikërisë së aleatëve të Hajkut. Ai gjithashtu kuptoi, se njerëzit luftonin më mirë, kur ata luftonin për të mbrojtur gjënë e tyre më të dashur. Nimrodi e kuptoi, se njerëzit e Hajkut e njihnin më mirë terrenin dhe e përdornin mirë këtë element kundër ushtarëve Babilonas, të cilët nuk ishin stërvitur të luftonin në kushte të tilla. Ushtria e Hajkut kontrollonte pozicionet më të larta, dhe terreni nuk lejonte përparimin e ushtrisë Babilonase. Harkëtarët e Hajkut ishin më të mirë dhe materiali special i shigjetave të tyre ishte shkatërrimtar.

Bel Nimrodi donte të kthehej mbrapsht dhe t'i merrte njerëzit e tij me vete për në Babilon. Ai donte, gjithashtu, të merrte me vete disa prej shigjetave të Hajkut, të cilat t'ua jepte farkëtarëve Babilonas, që ata të mund të përgatisnin materiale luftarake për Titanët po me të njëjtin material. Por ndërkohë, i erdhi ndërmend turpi dhe çnderimi, që do të sillte me vete, n.q.s ai dhe njerëzit e tij do ktheheshin si frikacakë në Babilon. Ai mendoi për revoltat e mundshme nëpër gjithë perandorinë. Ai mendoi për vasalët dhe për shumë nga nënshtetasit e tij, që mund të ktheheshin kundër tij. Ai e përfytyroi Hajkun duke komanduar në Babilon... Atëhere, vendosi ta vazhdonte luftën.

Nimrodi u këshillua më këshilltarët e tij. Shumë prej këshilltarëve e këshilluan, se do të ishte më e udhës t'i linin ushtarët të pushonin, dhe vetëm disa pak prej komandantëve dëshironin ta vazhdonin betejën, me arsyetimin se natën harkëtarët e Hajkut nuk do të kishin efektivitetin e ditës... Nimrodi i dëgjoji të gjitha sugjerimet dhe vendosi t'i lerë ushtritë e tij të pushojnë gjatë natës. Leonoti caktoi njerëzit e tij të bënin roje dhe i kontrolloi vazhdimisht deri sa u zbardh.

\* \* \*

Mëngjezi u shfaq me reflektimin e rrezeve të diellit mbi sipërfaqen e lumit dhe ngjyrosjen me të kuqe të reve lart në qiell. Ajri ishte i freskët dhe i ftohtë. Zogjtë cicëronin, bretkosat kuakitnin. Çdo gjë ishte e bukur, dhe jeta ishte vetëm çështje kohe...

Nimrodi u zgjua herët në mëngjes dhe vendosi të ndërrojë taktikat e tij, me qëllim që të realizonte objektivin që i kishte vënë vetes. Në të zbardhur, ai mori gjysmën e ushtrisë për të realizuar një manovër rreth pozicioneve të Hajkut, me qëllim që ta godiste atë nga dy fronte. Nimrodi la Leonotin në krye të gjysmës tjetër. Ai dha urdhër, që të mos sulmonin Hajkun, por vetëm ta mbanin të

mbërthyer në vend, deri sa ai me gjysmën e ushtrisë, që kishte me vete, t'i dilte fortifikimeve të Hajkut nga prapa. Bel Nimrodi kishte planifikuar të zhvillonte një manovër për qark Maleve Mokat (Malet Mokat e kanë marrë emrin prej Mokat ose [Moksit], i cili ishte një pasardhës i Mesheçit, që kishte qenë në krye të tribusë Mushki në Moks) dhe Lumit Ketsan, ku ishin vendosur fiset Hurrian, Ishuvan dhe Mushki. Pasi e kryen manovrën për qark maleve, Nimrodi dërgoi një spiun për të kontrolluar zonën. Spiuni u kthye dhe i raportoi Nimrodit mbi situatën në zonë, duke i shpjeguar se pushtimi do të ishte i vështirë, pasi zona ishte në mbrojtje nga një njësit i ushtrisë së Hajkut. Me qëllim që të mos ngjallte ndonjë dyshim, i cili mund ta bënte të pavlefshëm planin e tij të ri, Nimrodi e lëvizi ushtrinë e tij nga zona dhe u drejtua për nga lindja.

Lumi rridhte me një zhurmë të tillë, a thua se po ecte me ritmin e një beteje tjetër, të cilën Hajku dhe trimat e tij duhej ta zhvillonin për të ruajtur lirinë e tyre. Njerëzit e Hajkut ishin bërë gati për betejën e rradhës dhe pothuajse nuk e vinin re lindjen e bukur të diellit. Hajku po u mbante një fjalim mobilizues e kurajues njerëzve të tij, megjithatë ushtritë e Bel Nimrodit nuk dukej se kishin ndër mend të sulmonin. Atëhere Hajku dërgoi spiunë për në kampin armik. Spiunët u veshën me rrobat që ja u kishin marrë ushtarëve të vdekur të ushtrisë së Nimrodit dhe kështu ata mundën të depërtojnë brenda kampit armik.

Shpejt, spiunët u kthyen nga kontrolli. Ata raportuan se Bel Nimrodi e kishte lënë gjysmën e ushtrisë dhe kishte marrë shumicën e Titanëve me vete. Leonoti ndërkohë ishte duke kaluar çaste të vështira duke ushtruar një kontroll të rreptë mbi trimat e vendeve vasale, të cilët nuk kishin dëshirë të vdisnin për Nimrodin. Hajku dhe aleatët e tij vendosën të përfitojnë nga rasti. Ata vendosën që të sulmojnë ushtrinë e Leonotit, me qëllim që të eliminonin frontin e parë, duke rritur edhe shanset për të luftuar kundër Nimrodit.

Ishte mëngjes i vonë, kur ushtria e Hajkut u derdh poshtë maleve. Ata nuk gjetën kurrfarë rezistence dhe luftëtarët armiq ju dorëzuan

Hajkut pothuajse pa luftë. Leonoti e dorëzoi shpatën e tij dhe kërkoi t'i kursehej jeta. Hajku pranoi, që atyre t'u kursehej jeta, me kusht që, do t'i lironte vetëm pasi të kishte mundur Belin në betejë, pas së cilës, Leonoti dhe ushtarët e tij do të mund të ishin të lirë të ktheheshin pranë familjeve të tyre. Leonoti dhe disa të tjerë i treguan Hajkut rreth planit të Nimrodit për të manovruar për qark maleve me qëllim që të fuste Hajkun ndërmjet dy fronteve; gjithashtu ata i treguan pozicionin e përafërt të ushtrisë së Nimrodit. Hajku la dy nga vëllezërit e tij, Kartlosin dhe Kaukazin, pasardhësit e tyre dhe disa njësi rezervë që të ruanin robërit. Ai mori njësitë e kalorësisë dhe shkoi pas Bel Nimrodit, ndërsa vëllezërit e tij manovruan me njësitë e këmbëtorisë për të arritur kalorësinë e Hajkut. Hajku i gjeti njësitë e ushtrisë Babilonase. Beteja të vogla zunë vend ndërmjet Kalorësisë së Hajkut dhe njërive të Belit në malësitë në jug të Liqenit Van. Kalorësia e Hajkut i ngacmonte njësitë e Nimrodit, me qëllim që t'i mbante nën presion, t'i trembte dhe t'ua largonte dëshirën për të luftuar, por njësitë luftarake të Belit vazhduan misionin e tyre. Nimrodi e kuptoi, se dikush nga njësitet e Leonotit kishte zbuluar planin dhe vendndodhjen e tij, si edhe faktin, që tashmë ai nuk mund të mbante shpresë tek njësitë luftarake të Leonotit.

Hajku uronte për popullin e tij, që kjo të ishte beteja e fundit e tyre me Nimrodin. Ai dërgoi një lajmëtar për të njoftuar njësitë e tij të këmbëtorisë të zinin pozicion në Cor dhe të prisnin arritjen e tij. Cor do të thotë luginë ose ultësirë në gjuhën Armene. Cori (Hajots Cor) ndodhej në juglindje të Liqenit Van, ku ujrat e Lumit Koshav ose Koshab (Hosap në gjuhën Kurde), nëpërmjet shumë degëve, fillojnë nga afërsitë e maleve, që i jep emrin zonës së Hajoc Corit. Duke dredhuar nëpërmjet shumë pengesave dhe maleve të rrëpirët, Koshavi dhe degët e tij e gjejnë rrugën e tyre për në "shtëpi" dhe derdhen në Liqenin Van. Malet që rrethojnë Hajoc Corin (Luginën e Armenëve) janë quajtur si Malet Artos, të cilët janë të vendosur në jugperëndim të Lumit Koshav, Malet Pashat (Pshat), të cilët ndodhen në juglindje të Lumit Koshav, dhe Malet Varag, që ndodhen në veri

të lumit Koshav. Këto male ndihmonin në krijimin e një mbrojtjeje natyrale për Hajoc Corin, si edhe krijonin një mbrojtje natyrale dhe rrugë shpëtimi për mbrojtësit e zonës. Secili prej këtyre maleve kishte formën e një qosheje (këndi) dhe të tri malet së bashku formonin një trekëndësh të përkryer.

Nimrodi vuri re se njerëzit e tij po luftonin po me të njëjtën kalorësi. Ai mendoi se gjithçka kishte mbetur prej Hajkut ishte ajo kalorësi dhe pjesa tjetër e ushtrisë së Hajkut kishte vdekur në betejë me Leonotin. Në një farë mënyre ai u ndje mirë, i ngushëlluar me idenë se Leonoti me trimat e tij kishin luftuar dhe vdekur si heronj. Kështu që, ai vendosi të vihet në ndjekje të ushtrisë së Hajkut.

Kalorësia e Hajkut ndërkohë e tërhiqte ushtrinë e Nimrodit drejt vendit, që Hajku kishte zgjedhur për betejë, e cila ndodhej në juglindje të Liqenit Van. Nimrodi ishte i vendosur ta ndiqte kalorësinë e Hajkut, sepse ai e dinte se Hajku ishte me ta dhe ai mendonte se ishte duke ndjekur Hajkun, i cili nga ana e tij po tërhiqej, me qëllim që të shpëtonte jetën. Ndërkohë Hajku kishte në plan ta tërhiqte armikun pas tij deri në vendin e quajtur Cor (Hajoc Cor), ku Hajku kishte planifikuar që në fillim, që të zhvillonte betejën e tij kundër Nimrodit.

Cori ishte një fushë beteje e përkryer, ku ushtria e Hajkut mund të zhvillonte një betejë të fuqishme kundër armikut, pasi Beli në këtë vend mund të përdorte vetëm njësi të vogla kundër tyre për shkak të terrenit të vështirë. Më së fundi kalorësia e Hajkut arriti dhe pak më vonë, në vazhdim të ndjekjes së saj, arriti edhe ushtria e Belit. Harkëtarët e Hajkut lëshuan shigjetat e tyre kundër Babilonasve, gjë që frenoi përparimin e tyre. Nimrodi i urdhëroi njerëzit e tij të tërhiqeshin dhe të zinin pozicione larg prej hyrjes, atje ku shigjetat nuk do të mund t'i arrinin. Hajku vendosi disa nga njerëzit e tij mbi male nën komandën e Lekanit dhe Egros, me qëllim që të rrokullisnin gurë të mëdhenj mbi armikun, në rast se ata vdisnin në betejë dhe armiku fitonte. Ai e mbajti pjesën tjetër të ushtrisë pranë hyrjes së luginës. Spiunët i raportuan, se Nimrodi dhe njerëzit e tij kishin

ngritur kampin për të kaluar aty natën. Hajku i urdhëroi njerëzit e tij, që të qëndronin në gatishmëri dhe të ishin gati për të vepruar. Nimrodi dërgoi një lajmëtar për të kontrolluar, nëse kishte mbetur ndonjë njeri nga ushtria e Leonotit, dhe n.q.s. kishte të tillë, t'i kërkonte Leonotit dhe vasalëve të tij që t'i vinin në ndihmë.

Nimrodi organizoi rojet për gjatë natës dhe shkoi të flerë. Nata kaloi, dhe mëngjesi u gdhi me një lindje të bukur dielli. Liqeni Van ishte veçanërisht madhështor atë mëngjes. Rrezet e diellit e goditën liqenin pjerrtazi duke ja shtuar shkëlqimin. Liqeni ishte kaq ftues, ajri i lagësht ishte i parezistueshëm, por ushtarët nuk ishin atje për t'u larë e notuar, por për arsye të tjera...

Hajku i vendosi njerëzit e tij në hyrje të luginës në formë të një trekëndëshi. Në krahun e djathtë, ai vendosi njësitë e bijve të tij, Aramaniakut, Khorit dhe Manavazit për të mbuluar anën e liqenit, në rast se armiku do tentonte të vinte me not nga ana e liqenit, dhe në anën e majtë mbajti njësitë e vëllezërve të tij, Bardosit, Movakanit dhe Herosit, me qëllim që të mbulonte malet dhe hyrjen e ngushtë. Hajku urdhëroi njerëzit e tij, që të vrisnin sa më shumë armiq duke vënë në përdorim shigjetat dhe duke u përpjekur të shmagnin sa të ishte e mundur luftimin në afërsi. Tre vijat e para mbronin harkëtarët me mburojat e mëdha dhe shtizat e gjata. Hajku e kuptoi, se po të qëllonte me shigjeta trimat dhe udhëheqësit e ushtrisë armike, pjesa tjetër e ushtrisë Babilonase nuk do të guxonte të sulmonte. Hajku shpresonte, se Nimrodi së shpejti do të ngelej pa udhëheqës dhe nuk do të kishte zgjidhje tjetër, por do të vihej vetë në krye të asaj, që do të kishte mbetur nga ushtria e tij, dhe kur ai ta bënte këtë, ata do të kishin mundësi ta vrisnin Bel Nimrodin dhe ta fitonin luftën.

Nimrodi dhe burrat e tij e vështruan me kujdes terrenin për pothuajse një cikël të plotë hënor. Nimrodi po mudohej të ngjallte frikë në rradhët e njerëzve të Hajkut duke u shfaqur papritur dhe duke parë pozicionet e tyre çdo ditë. Ndërkohë, lajmëtari i Nimrodit u kthye me lajmin se njerëzit e Leonotit ishin kapur robër nga njësitë e ushtrisë së Hajkut. Ishte një lajm i rëndësishëm, që e

ndihmoi Nimrodin të merrte një vendim të mirë-informuar. Ai e kuptoi se kishte atë ç'ka i kishte mbetur nga ushtria e tij, dhe Hajku kishte vetëm ata burra, të cilët ishin pozicionuar në male. Nimrodi mendoi, se ai kishte ende më tepër ushtarë se Hajku; përndryshe, Hajku nuk do të ishte duke përdorur një taktikë mbrojtje. Ndaj, Nimrodi vendosi të përdorte një taktikë sulmi dhe t'i jepte fund njëherë e mirë armikut të tij...

Burrat e Nimrodit u rreshtuan për betejë. Nimrodi e kishte të pamundur të përdorte njësinë e qerreve të luftës për shkak të terrenit. Kuajt, që tërhiqnin qerret, po përdorshin për kalorësinë. Nimrodi i mbajti kuajt larg deveve, në mënyrë që mos t'i shqetësonte kuajt e tij. Ai lejoi që fisnikët e aleatëve të tij të ngjiteshin në kuajt e kalorësisë së tij, dhe e mbajti njësinë kalorsiake në vijën e pasme, së bashku me njësitë rezervë. Këmbësoria e Nimrodit u sul e para. Titanët qëndruan pas këmbësisë, që t'i shtynin ata përpara. Harkëtarët e Hajkut ishin duke i qëlluar me sukses njësitë këmbësore dhe duke i lënë ata të shtrirë në tokë. Titanët dhe këmbësoria u detyruan të tërhiqeshin.

Kalorësia e Nimrodit po përdorte kryesisht deve për sulmin e dytë. Ata u lëshuan kundër pozicioneve të ushtrisë së Hajkut. Ai po shpresonte se devetë e tij do të shqetësonin kuajt e Hajkut dhe të krijonin rrëmujë në kampin e Hajkut. Këmbësoria e Nimrodit u sul sërish duke përdorur njësinë kalorsiake si mbrojtje. Bel Nimrodi po e shihte betejën. Ai vuri re se si harkëtarët Torgomianë po vrisnin trimat e tij dhe kryesinë e ushtrisë së tij. Beli vendosi të tërhiqte kalorësinë, ose atë ç'ka kishte ngelur nga burrat dhe devetë e tij, dhe të përdorte harkëtarët e tij kundër atyre Torgomianë; megjithatë, shpejt ai kuptoi se harkëtarët e tij nuk ishin aq të dobishëm për shkak të terrenit. Si terreni, ashtu dhe shigjetat e veçanta të harkëtarëve të Hajkut, i ndihmonin ata të kishin epërsi ndaj harkëtarëve të Nimrodit. Pas betejës, Bel Nimrodi e pa Hajkun nga distanca. Ai kujtoi se si ëndërronte të vriste Hajkun. Ndaj, Nimrodi vendosi të përdorte Titanët për t'u afruar dhe për t'u përballur me

ushtrinë e Hajkut në betejë në afërsi. Nimrodi po shpresonte të vriste Hajkun në dyluftim me shpata. Ai po mbështetej tek fakti, se ai ishte më i madh dhe me shumë gjasa më i fortë se Hajku. Ai duhej të përdorte Titanët tani; përndryshe ai mund ta humbiste ushtrinë e tij afërsisht brenda një dite.

Papritur, ushtria e Belit u spraps, për të qëndruar larg rrezes se harkëtarëve Torgomianë, dhe i hapi rrugën Titanëve, të cilët ishin më të gjatë, më të shpejtë, dhe ushtarakë më të zotë. Titanët ishin të mbrojtur nga armatura e bronzit që kishin veshur dhe ata përdornin armë më të mira. Nimrodi ishte pas Titanëve duke i dhënë kurajë që të ecnin përpara dhe që pjesa tjetër e ushtrisë t'i ndiqte dhe të ndihmonte Titanët. Shpejt, Titanët bënë përpara dhe u përplasen kundër Torgomianëve pranë hyrjes. Hyrja ishte shumë e vogël dhe lejonte vetëm disa Titanë të kalonin njëkohësisht për të luftuar Torgomianët. Tronditja dhe rrëmuja krijuan një mundësi për Torgomianët, që të shtynin armikun larg hyrjes. Titanët u detyruan të tërhiqeshin, dhe pas kësaj ushtria e Nimrodit nuk guxoi më të sulmonte.

Hajku priti për pak kohë, që armiku të sulmonte sërish, por ata nuk sulmuan. Më pas, ai doli jashtë hyrjes për të vëzhguar armikun. Nimrodi e njohu atë, teksa Hajku doli nga hyrja. Si Hajku, ashtu dhe Nimrodi, ishin të plakur. Kishin kaluar shumë vite, por Hajku ende dukej i gjatë dhe i fortë. Ai dukej i plakur dhe i mençur. Bel Nimrodi bëri përpara. Hajku e vuri re Nimrodin. Ata të dy shkëmbyen vështrimet nga distanca. Papritur, Bel Nimrodi u sul drejt Hajkut dhe rojet e tij personale u sulën së bashku me të për të mundësuar mbrojtje për mbretin e tyre. Hajku me durim pa se si Babilonasit dhe mbreti i tyre po afroheshin. Hajku mori shenjë drejt Nimrodit dhe lëshoi shigjetën e tij, por vrau vetëm një prej rojeve, i cili kërceu përpara shigjetës, që të shpëtonte mbretin e tij. Nimrodi dhe rojet e tij ndaluan. Hajku eci drejt hyrjes me harkun dhe shigjetën në duar. Nimrodi mendoi se Hajku po kthehej pas, që të fshihej prapa hyrjes, ndaj ai vrapoi sërish drejt Hajkut, dhe këtë herë po bërtiste fjalë fyese

në gjuhën Babilonase. Hajku ndaloi tek hyrja dhe u kthye duke marrë në shënjestër Nimrodin. Ishte një shënjestër e pastër dhe Hajku përfitoi nga kjo mundësi duke lëshuar shigjetën. Shigjeta fluturoi në ajër dhe mbërriti tek Bel Nimrodi duke çarë tejpertej armaturën dhe zemrën e Belit. Beteja ndaloi, dhe të gjithë po shihnin se si Beli po ulërinte si një luan nga dhimbja. Nimrodi bëri një hap tjetër dhe kapi shigjetën me dorën e majtë. Ai hodhi shpatën që kishte në dorën e djathtë dhe duke përdorur të dyja duart, u përpoq të hiqte shigjetën nga zemra e tij, por nuk ja doli. Ai u përpoq të bënte dhe një hap tjetër, dhe menjëherë ra në gjunjë. Më pas, Nimrodi ra me fytyrë në tokë dhe vdiq. Të gjithë po shihnin shigjetën, që vrau Bel Nimrodin, e cila ishte dukshëm më e madhe se një shigjetë e zakonshme, pasi Hajku dhe aleatët e tij përdornin shigjeta më të mëdha kundër Titanëve. Hajku u afrua pranë Belit dhe e ktheu me kurriz në tokë. Bel Nimrodi nuk po merrte frymë. Hajku kontrollloi pulsën e Belit dhe deklaroi se Nimrodi kishte vdekur. Berossusi ka shkruar se Belusi ose Bel Nimrodi sundoi për pesëdhjetë e gjashtë vjet.

Hajku i dha ushtrisë së Belit dy zgjedhje. Ata mund të vazhdonin të luftonin dhe të vdisnin së bashku me Zotërinë e tyre ose mund të dorëzoheshin dhe të liheshin të gjallë. Ushtria e Nimrodit u dorëzua. Ushtria e Hajkut u afrua për të çarmatosur armikun, dhe luftëtarët armiq i dorëzuan armët e tyre. Hajku e mbajti fjalën e dhënë dhe u dhuroi lirinë të gjithë luftëtarëve të dorëzuar. Luftëtarët e Belit u gjunjëzuan dhe thirrën Ba'al, Ba'al, që do të thotë Mjeshtër ose Zotëri, që gjithashtu, ka kuptimin Zot në gjuhët Assiriane dhe Babilonase; me këtë formalitet, ata pranuan se njihnin Hajkun si mbretin e tyre. Hajku urdhëroi të ndihmoheshin të plagosurit. Secili iu përvesh punës dhe Hajku shihte se si njerëzit e tij, po ashtu si edhe ushtarët e kapur rob, ndihmonin të plagosurit, duke zbatuar kështu urdhërin e Hajkut. Mëngjesin tjetër, ai urdhëroi të digjeshin të vdekurit, të gjithë së bashku në një gropë të madhe, për të treguar që ai e pranonte popullin e Nimrodit si popull të tijin dhe se ai nuk bënte dallim ndërmjet trimave të tij dhe atyre të armikut. Hajku urdhëroi

një shërbim funeral për Bel Nimrodin dhe që Titani i Fuqishëm të varrosej në majë të një mali, që ndodhej në vendin e quajtur Baz dhe të fisnikëve Bznuni, në juglindje të Liqenit Van. Ky vend nuk ndodhej fort larg prej Harkut, kështu që ai dhe pasardhësit e tij do të kishin mundësi ta kishin gjithnjë parasysht varrin e Nimrodit. Mali u quajt Mali Nimrod sipas emrit të Titanidit Bel; në këtë mënyrë, ai mbeti varri i mbretit të fundit Kushit të Babilonisë.

Legjenda thotë se, pasi morën lajmin që Hajku e kishte mposhtur Belin dhe ushtritë e Nimrodit u zotuan për besnikërinë e tyre ndaj Hajkut, vëllezërit e Nimrodit, pasardhës të tjerë dhe të afërm të Kushit, si edhe ndjekës të tyre, i braktisën tokat e tyre. Disa prej tyre u kthyen në Afrikë, prej nga kishin ardhur, të tjerë shkuan drejt lindjes në kërkim të tokave të reja për t'u strehuar. Ata krijuan një vendbanim të ri. Vendbanimi i tyre i ri ndodhej në malet në lindje të Baktrisë. Në nderim të Kushit, ata e emëruan atë Kushania, N.q.s. ndjekim legjendën Hungareze të Drerit të Bardhë, Hunori dhe Magori ishin pasardhës të Nimrodit. Ata udhëtuan përmes tokave dhe maleve të Çemit (Persianët kanë pasë qenë quajtur Çem prej Turqve dhe Arabëve) në ndjekje të Drerit të Bardhë gjatë gjuetisë dhe arritën në tokat e reja, ku ata u vendosën dhe themeluan mbretërinë e tyre. Legjenda e Drerit të Bardhë, gjithashtu, thotë se pasi vdiq babai i tyre (Nimrodi), mbretëria e babait të tyre u pushtua nga një sundimtar i huaj. Kjo ka kuptim, sepse kur mbretëria e Nimrodit u pushtua nga Hajku, pasardhësit e Nimrodit udhëtuan drejt lindjes nëpër tokat dhe malet e Persisë dhe gjetën toka të reja, ku themeluan mbretërinë e tyre. N.q.s. ndjekim legjendën, Hunori dhe Magori ishin pasardhës të Nimrodit, dhe Nimrodi ishte djali i Kushit; si rrjedhim Nimrodi ishte një Kushit, dhe po kështu edhe pasardhësit e Nimrodit ishin Kushitë (Kushanë). Pra, Kushanët (Ka pasë ekzistuar një mbretëri e lashtë e quajtur Kushania ose Indu-Kush, e cila ka pasë qenë e vendosur ndërmjet Persisë dhe Indisë, dhe Kushanët ishin aleatë të Hunëve dhe armiq të Persisë Sassanide) dhe Hunët, si edhe Magjarët dhe popuj të tjerë të lidhur me ta, janë pasardhës të Kushit dhe Nimrodit.



Kur Hajku dhe ushtritë e tij mbërritën në qytetin e Babilonit, Hajku dërgoi një lajmëtar për t'u njoftuar Babilonasve mbërritjen e tij. Qytetarët e Babilonit dolën në mënyrë festive për të pritur ardhjen e mbretit të ri. Populli u grumbullua në turma përpara portës së hyrjes. Ata kishin dëgjuar për bëmat e Hajkut dhe ndjeheshin të gëzuar që ishin çliruar nga zgjedha tiranike e Belit. Erdhën njerëz edhe nga qytete e vendbanime të tjera për të parë heroin, që kishte mposhtur tiranin. Hajku rreshtoi ushtrinë e tij dhe atë të Bel Nimrodit në mënyrë të tillë, që të hynin krah për krah njera tjetrës në Qytetin e Madh, duke treguar me këtë, se ai nuk bënte dallim ndërmjet popullit të tij dhe atij Babilonas, pasi ai pranonte të ishte mbret i të gjitha kombeve. Fillimisht marshuan njësitë e këmbësorisë, të cilat hapën edhe rrugën për të hyrë në qytet njerëzit më të rëndësishëm mbi qerret e tyre luftarake; pas tyre vinin njësitë e kalorësisë, dhe në fund njësitë e hipura mbi gamile dhe elefantë, të ndjekura nga turma e popullit, që shetiste në rrugët e Babilonit.

Hajku vrojtonte fytyrat e njerëzve, që erdhën për të takuar njerëzit e tyre të dashur. Ai pa se si u shkëlqente buza njerëzve kur takonin të afërmit e tyre, për të cilët kishin pritur që të ktheheshin në shtëpi. Hajku pa njerëz që qanin... Disa qanin nga gëzimi, të tjerë prej dhimbjes. Ai pa fytyra, që ndjeheshin të dënuar për humbjen e tyre, si edhe ato të njerëzve që vazhdonin të kërkonin për ardhjen e njerëzve të tyre.

Ai i urdhëroi ushtritë të rreshtoheshin në sheshin kryesor të qytetit, përpara pallatit të Bel Nimrodit. Ai ju drejtua me një fjalim qytetarëve të Babelit. Në fjalën e tij, ai deklaroi vdekjen e Bel Nimrodit. Ai shpjegoi se sa keq ndjehej për familjet e heronjve të rënë në betejë dhe se si ai dhe populli i tij kishin qenë të detyruar të luftonin për jetët e tyre kundër ushtrive të Bel Nimrodit; të paktë në numër dhe pothuajse të rrethuar, ata kishin patur bekimin e

Zotit për të qenë të aftë për të mundur Bel Nimrodin dhe për të sjellë lirinë për shtetasit e Belit. Ai deklaroi, se ushtritë e Nimrodit i kishin kërkuar atij të bëhej mbreti i tyre, dhe ai erdhi në Babilon për të çliruar shtetasit e Nimrodit, pasi kishte qenë një kohë, kur edhe ai vetë kishte qenë pronë e Nimrodit. Kur Hajku mbaroi fjalimin, ai çliroi ushtrinë Babilonase nga formacioni dhe i lejoi ushtarët të shkonin nëpër shtëpitë e tyre. Hajku hodhi vështrimin mbi njerëzit dhe vuri se se vështrimet e tyre ishin mbërthyer mbi të. Ata thërritën Hajk Ba'al, Hajk Ba'al...

Hajku ishte pranuar si sundimtari i mbretërisë së Belit; kështu, ai u bë mbreti i një prej mbretërive më të mëdha, duke i bashkuar mbretërisë së Belit edhe tokat, që ishin pjesë e mbretërisë së tij dhe duke ndarë pasuritë e Belit me trimat e tij, vëllezërit, djemtë dhe nipat e tij. Hajku ja lejoi çdokujt të drejtën për t'ja kaluar pasurinë e tij pasardhësve të tij në formën e trashëgimisë. Hajku urdhëroi, që të ngrihej një tjetër “dastakert” dhe vend adhurimi për të përkujtuar vendin e betejës së fundit, ku ai vrau Nimrodin. Hajku dhe njerëzit e tij u lutën dhe falenderuan Zotin për ndihmën, që ai u solli nga Qielli dhe u lutën edhe për heronjtë e rënë.

Hajku vendosi të jetojë në Qytetin e Babilonit; ai u çvendos atje së bashku me gruan e tij, ku jetoi edhe vitet e fundit të jetës. Ai e decentralizoi qeverisjen nga Qyteti Babilon, duke u dhënë fuqi qeverive lokale të çdo qytet-shteti. Shpejt pasi kishte vendosur rezidencën në Babilon, Hajku ndërmori një udhëtim nëpër mbretërinë e tij dhe predikoi për Zotin e Adamit dhe Noes. Hajku u foli njerëzve për të mirën dhe të keqen dhe se si Kaini, djali i Adamit, ishte dëbuar në mërgim për vrasjen e vëllait të tij, Abelit, për shkak xhelozie. Ai predikoi se si Noe dhe djemtë e tij (Xhafet Oste, Sem Zrvan dhe Ham Titan) dhe vajzat (Astghik dhe Araza) i mbijetuan Përmbytjes dhe se si Zoti e ndaloi Arkën mbi Malin Ararat. Ai foli mbi mënyrën se si Zoti përgatiste barërat dhe erëzat, me të cilat njerëzit përgatisnin ilaçe, dhe se si Zoti përpiquej t'i furnizonte njerëzit me ushqime. Hajku u foli njerëzve mbi gjërat që ai dinte

dhe mbi ato që kishte mësuar gjatë jetës. Hajku u mësoi djemve të tij si të adhuronin Zotin e Adamit dhe Noes dhe të mos adhuronin Idhujt ose njerëzit si puna e Nimrodit, të cilët e mendonin dhe e barazonin veten me Zotin, pasi është vetëm një Zot i vërtetë dhe ai është krijuesi i gjithçkaje. Ai u tregoi bijve të tij të mësojnë dhe të kuptojnë natyrën, sepse në këtë mënyrë do të kishin mundësi ta shfrytëzonin atë për nevojat e tyre, dhe të mos i trembeshin asaj, pasi popujt që i trembeshin natyrës detyrimisht do të shkonin në drejtim të adhurimit të Idhujve si Zota, gjë që në këmbim do të zemëronte Zotin dhe do ta çonte jetën e tyre në një fund të dëmshëm. Ai ishte i drejtë kur gjykonte njerëzit, sepse ai e donte Zotin dhe i trembej ndëshkimit të Tij. Ai ndihmoi në ndërtimin e qyteteve dhe fshatrave të reja, si edhe të objekteve të kultit. Ndryshe nga Beli, ai i lejoi, si banorët autoktonë ashtu edhe ata të ardhur, të kishin vendet e tyre të adhurimit. Ai lejoi njerëzit e tij të merreshin me bujqësi dhe të përfitonin prej tokave të tyre. Hajku u kujdes për njerëzit dhe për këtë arsye njerëzit e deshën atë dhe e respektuan si Mbretin e tyre.

Sipas Ghevond Alishanit dhe Katolikosit Hovhannes të Armenisë (emri Hovhannes i Armenëve korrespondon me emrin Xhon të Anglezëve), Hajku vdiq në vitin 2446 përpara lindjes së Jezu Krishtit. Legjenda thotë, që përpara vdekjes, Hajku ja la mbretërinë dhe popullin e tij djalit të tij, Aramaneakut (Aramaneak – gjithashtu është i njohur si Armen ose Armenak në historinë Armene, dhe ai konsiderohet si themeluesi i kombit Armen, që munda t'i mbajë të grupuar tributë Armene si një komb i vetëm) dhe popullin e tij e quajti sipas emrit të djalit të tij. Aramaneaku u kurorëzua si Mbret ndër kohë që Hajku ishte akoma gjallë, dhe të gjithë i shprehën atij besnikërinë dhe mbështetjen e tyre. Emri Armen dhe Aram vjen prej djalit të Hajkut, Aramaneakut, dhe u bë një emër i zakonshëm për Armenët. Djemtë dhe vëllezërit e Hajkut ndihmuan që të transportohej trupi i tij prej Qytetit Babilon në Hajkashen, ku Hajku kishte shprehur dëshirën që të varrosej në majë të një mali, që më pas u quajt Hajkasar, jo larg prej varrit të Nimrodit, vend ku Hajkut,

kur ishte fëmijë, i pëlqente të shkonte të shëtiste. Hajku u varros atje dhe, sipas disa historianëve, vëllezërit dhe pasardhësit e tij ndërtuan vende adhurimi dhe statuja nëpër të gjithë mbretërinë e Hajkut.

Disa historianë dhe studjues e vënë në dyshim ekzistencën e Nimrodit dhe Hajkut dhe i konsiderojnë Nimrodin dhe Hajkun si figura me karakter mitik, pasi sipas tyre emrat e tyre nuk janë gjetur në ndonjë nga listat me emrat e mbretërve Babilonas. Sidoqoftë, ka shënime për emrat e zotave Babilonas të emërtuar Bekus dhe Hea ose Ea. Belus është Bel (Nimrod) dhe Ea është versioni Babilonas për Hignes (Heagnes), që është i njëjlojtë me Hajk, paraardhësi i Armenëve. Hea ishte zoti Babilonas i diturisë dhe ai ishte krijuesi i besimit, gjë që përkon me një përshkrim perfekt të figurës së Hajkut.

John Denison Baldwin në shkrimin e tij “Kombet pre-historike” (John Denison Baldwin është duke cituar William Gifford Palgrave’s “Journey through Central and Eastern Arabia”) shkruan se Hajeli është kryeqyteti i Shomerëve (Shomer ose Sumer është vendi i Sumerianëve) dhe Road është kryeqyteti i Nejed. Gjithashtu, ai shkruan se Hajeli ka pasur fortifikime njëzet këmbë të larta, me kulla, disa të rrumbullakta dhe disa të tjera katërkëndëshe, dhe me disa porta të palosshme në interval distancash. Pikërisht një gjë të tillë e hasim edhe në shumicën e fortesave Urartiane dhe Armene. Hajel ose Haj-el rrjedh prej së njëjtës fjalë si edhe Hajk.

Trashëgimia, që lanë vëllezërit Torgomianë, nuk kufizohej vetëm në faktin që ata luftuan për liri. Ajo nuk kufizohej vetëm në faktin që ata ja arritën të vrasin Belin, i cili ishte një Tiran, pasi ai ishte i destinuar të vritej, me qëllim që të ndaloheshin veprimet e tij të këqia mbi njerëzit e kësaj Toke, që adhuronin Zotin. Arritja më e madhe ishte fakti, që Hajku dhe aleatët e tij arritën të bashkojnë të gjithë folësit e së njëjtës gjuhë, të cilët tanimë quheshin Armenë. Kështu, ata ishin bashkuar nën udhëheqjen e Hajkut dhe vëllezërve të tij, si një komb i vetëm. Populli i Hajkut e quajti këtë komb Haj dhe ata e quajtën veten e tyre Hajer, që është forma e shumësit të Haj.

Pasardhësit e Hajkut u quajtën Hajkazuni dhe toka e Hajkut u quajt Hajk (Mec Hajk ose Mex Hajk), që ka kuptimin Armenia (Vendi i Hajkut të Madh ose Armenia e Madhe).

Hajku e jetoi jetën e tij si një trim dhe vdiq si Mbret i botës së njohur. Ai vdiq i rrethuar nga njerëzit e dashur, nga vëllezërit e tij, miqtë e tij dhe nga populli i tij, duke lënë një trashëgimi për çdo njeri, që të mund të jetonte i lirë dhe të luftonte për të ruajtur lirinë e tij dhe të drejtat e tij si njeri i lirë. Është detyrë e secilit që të mbrojë nderin dhe lirinë e tij, si edhe nderin dhe lirinë e njerëzve të tij të dashur. Çdo njeri është i destinuar të jetojë dhe të vdesë, por qofshin bekuar ata, që luftojnë për të jetuar të lirë dhe ata që vdesin duke luftuar për të mbrojtur lirinë e tyre...

\* \* \*

## Konkluzione

Shumë historianë dhe studjues të historisë së lashtë kanë shkruar për qytetërimet e lashta, dhe ne u jemi mirënjohës atyre për punën e tyre, sepse ata kanë shpenzuar kohë dhe energji për të siguruar informacion për brezat tanë dhe ata të ardhshëm. Në sajë të historianëve, studjuesve, njerëzve që studjuan mbishkrimet mbi shkëmbinjtë, si edhe në sajë të punës së arkeologëve dhe zbulimeve të tyre, tashmë ne kemi një informacion rreth popujve të lashtë dhe mënyrës së tyre të jetesës.

Problemi me disa historinë dhe studjues është, se secili prej tyre shkroi rreth subjektit që studjoi dhe njohuritë e tyre mbetën të kufizuara në specialitetin e tyre. P.sh., Aleksandër Fol, themeluesi i Institutit të Thrakologjisë, dhe ekipi i tij vendosën të studjojnë rreth madhësisë së Thrakëve, dhe ky ishte specialiteti i tyre. Virgjili shkruante, se Thrakët kanë qenë populli më i vjetër dhe më i madh i botës së lashtë. John Denison Baldwin, Drusilla Dunjee Houston

dhe studjues të tjerë shkruajtën, se Kushitët ose Etiopianët kanë qenë populli më i vjetër dhe më i madh, që kanë pasur një perandori, e cila shtrihej nga Afrika deri në Indi. Herodoti, Homeri dhe historianë të tjerë kanë shkruajtur se Grekët ose Hellasit kanë qenë populli më i madh dhe më i lashtë.

Robert Ellis ka shkruajtur, se populli më i lashtë dhe më i madh i botës së vjetër kanë qenë Armenët. Unë mundem, gjithashtu, të përmend emra studjuesish çifutë, të cilët kanë shkruajtur se Çifutët kanë qenë populli më i vjetër dhe më i madh, si edhe të tjerë që kanë shkruajtur për grupe të tjera etnike...

Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit është një tjetër ngjarje e rëndësishme, e cila nxiti nevojën tek disa Kushitë për të kërkuar për toka të reja. Kësisoj ata arritën në një vend ku malet ndanin Nënkontinentin Indian nga Azia. Shumë studjues thonë se ka pak dallim në tiparet e dy popujve të dy vendeve: Etiopianëve (Kushitëve) dhe Indianëve (Indo-Kushanëve ose Indo-Kushëve). Akoma mbetet e panjohur, se çfarë gjuhe kanë pasë folur Kushitët e lashtë të Babilonisë; sidoqoftë, ajo duhet të ketë qenë, me siguri, një dialekt i grupit Hamitik të gjuhëve.

Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit vendos një rregull kronologjik mbi historinë e njerëzimit. Pa faktet e rëndësishme, që unë kam parashtruar në këtë libër, historia që ne njohim do të ishte jo e plotë. Kështu, legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit na ushqen me shpjegime dhe përfundime lidhur me ngjarjet Biblike, që duken misterioze dhe mitike.

Unë ndjehem i nderuar që pata rastin dhe burimet e nevojshme, që më lejuan mua të plotësoj kërkimet dhe veprën time letrare. Unë ndjehem më i plotësuar për shkak të këtij informacioni, dhe shpresoj që edhe lexuesit e mi do ndjehen po njëjloj si unë. Aktualisht po punoj me shitës të ndryshëm që të më ndihmojnë ta përkthej këtë vepër në gjuhë të tjera, me qëllim që ky informacion të jetë i vlefshëm për të gjithë njerëzit.

Në mbyllje, unë do të dëshiroja të falenderoja Zotin, që më ushqeu me energjinë dhe pasionin për të përfunduar këtë punë. Dëshiroj të falenderoj paraardhësit e mi për ruajtjen e traditave Armene dhe që jetuan si trima. Dëshiroj të falenderoj prindërit e mi, vëllanë dhe motrën time, gruan time Eliza dhe djalin tim Mikel, xhaxhallarët, tezet, kushërinjtë dhe miqtë e mi për mbështetjen dhe mirëkuptimin për të cilin unë kisha nevojë, për të realizuar si duhet dhe për ta bërë këtë informacion të vlefshëm për t'u lexuar nga kushdo. Unë dëshiroj të falenderoj Z. Joseph Orazco dhe Z. Vardan Aristakesian në mbështetjen për ta nxjerrë këtë libër sa më mirë. Dhe në fund, por jo më pak i rëndësishëm, unë dëshiroj të falenderoj publikuesin tim, që pati besim në punën time, si edhe lexuesit për mbështetjen e tyre.

Zoti na bekoftë të gjithëve Ne!

# POEMA

## Pjesa II

Tashmë që mbaruat leximin,  
Më lini t'ju tregoj përfundimin.  
Lufta si u mbarua  
Dhe faktet si u zhvillua.  
Të Hajkut harkëtarë me shigjeta si çanë,  
Parzmoret e bronzit të trimave Titanë,  
Shigjeta e Hajkut si mundi të kalojë  
Dhe zemrën e Nimrodit aq fort ta shpojë,  
Dhe varri i Nimrodit emrin i dha  
Një mali që ndodhej pranë Harkut.  
Si ushtritë Kushite u shpartalluan,  
Si armiq të Hajkut u dorëzuan...  
Si dashuria e tyre për liri  
U zhvillua në të Hajkut mbretëri.  
Si dashuria e tyre për Zotin  
Ndhmoi ata, të keqen ta mposhtin.  
Kombe të rinj si u zhvilluan  
Kombe që Hajku dhe Nimrodi krijuan.  
Një palë qëndroi në të vetin atdhe  
Tjetra kërkoi një tjetër atdhe.  
Kushania i thanë Atdheut të ri  
Për Kushitët u bë e re mbretëri.

U bë vendi i popullit të njohur si Indo-Kushanë.  
 Thonë shumë studjues dhe historianë,  
 Se popujt Kushitë dhe Indianë,  
 Ngjyrën e lëkurës njëlloj e kanë.  
 Dhe po ashtu në fytyrë ngajjnë.  
 Hajku u bë i riu Bel  
 Dhe u çvendos për në Babel.  
 Mësoi të tjerët të besonin në Zot  
 Dhe gjë të keqe mos bënin më kot.  
 Hajku, për Babelin si mbret i ri  
 U respektua prej popullit të tij,  
 Gjithë kombet jetuan si t'ishin një  
 Në paqe, gëzim dhe harmoni.  
 Xhafetik, Hamitik dhe Semitik.  
 Pasi mbretëria e tij ishte bekuar me vende shumë të bukura.  
 Me dritë, shkëlqim të ngrohtë dhe rreze diellore vezulluese;  
 Dhe, populli i Hajkut mori emrin e djalit të Hajkut.  
 Dhe kur Hajku shkoi,  
 Djali e trashëgoi.  
 Pasardhësit e Hajkut vendosën të ken'  
 Nga ajo kohë emrin "Armen"...



Malet Ararat simbolizojnë rrënjët e popullit Armen.

# POPULLI ARMEN DHE POPUJT E AFËRT ME TË

\* \* \*

## Pasardhësit e Adamit dhe Evës

**Abeli**, djali i Adamit, ishte parardhësi i fisnikëve Abelianë. Abeli ishte burri i parë i Avanit; ndaj, ekzistonte një linjë familjare e fisnikëve Abelianë, gjë e cila provokonte xhelozitë tek Kaini (Bibla e Shenjtë e përshkruan xhelozinë e Kainit ndryshe) dhe bëri që Kaini të vriste vëllanë e tij Abel, që të merrte Avantin si gruan e tij. Prona Abelianë ndodhej në veri të Liqenit Van. Ata ndërtuan aty vendqëndrimin e tyre dhe e emërtuan atë Abelavan ose Abeghavan. Ai ishte një vend i pasur me ar dhe metale të tjera. Emri Abelavan i ka rrënjët tek emrat Abel dhe Avan, djali dhe vajza e Adamit. Forma të tjera të të thirrurit të emrit Abelian janë Apelian, Abeghian, Abeghyan, Abelean, etj. Të gjithë këta emra familjesh (mbiemra) rrjedhin prej të njëjtëve fisnikë Abelianë. Fisnikët Abelianë njihen, gjithashtu, edhe si fisnikët Abeluni.

Fisnikët Gebelianë vinin nga Gabal Abeli, një pasardhës i Abelit Biblik. Gabal Abeli i shërbeu Mbretit Artaksis (Artashe) të Armenisë. Gabal Abeli ishte një nga Zorapetët (Zorapet - Gjeneral i dhjetë mijë burrave) e ushtrisë Armene të Mbretit Artaksis. Fisnikët Gabelianë ose Gabeghianë ishin Kastelanët (Guvernatorët, Administratorët) e pronës Gabelianke, e cila ishte pranë pronave

Abelianke, Arsharunike, dhe Kamsarakane në Krahinën e Ajraratit.

Fisnikët Havnuni ose Abnuni (Abnuni ishte emri Havnuni në gjuhën Hurro-Urartiane) ishin një degë e fisnikëve Abelianë, të cilët ishin në krye të organizimit të udhëtimeve të gjuetisë së zogjve për Mbretërit Armenë dhe ata jetuan në Pallatin Mbretëror. Emri Havnuni erdhi nga “Hav” që do të thotë “Shpend” (*Shënim B.P.*: në fakt “hav” sot në gjuhën Armene do të thotë “pulë”).

\* \* \*

**Avani**, bija e Adamit dhe Evës, ishte gruaja e Abelit, dhe pasi Kaini e vrau Abelin, ajo u bë gruaja e Kainit. Liqeni Van dhe Liqeni Sevan e morën emrin e tyre nga Avani. “Avan” do të thotë “Ujë” në gjuhët Ariane, duke qenë se “Aban” ose “Apan” ishte fjala për “Ujë” në gjuhët Zoroastriane dhe Sanskrite. Avan ishte, gjithashtu, emri i një qyteti dhe rajoni të lashtë në Elam përgjatë mijëvjeçarit të tretë deri në 2700 p.e.s.. Avan ishte paraardhësja e popullit Soanes ose Sveni (Sveni njihen gjithashtu si Svani, Svaneti, Soanes, Sveons, Sviones, dhe emra të tjerë të ngjashëm) të cilët jetojnë në lindje të popullit Abkhaz në Malet e Kaukazit, dhe emrat e familjeve të tyre i ngjajnë emrave të familjeve Armene. Populli Sveni janë gjithashtu të lidhur me popullin Abkhaz dhe popuj të tjerë Kaukazianë. Emri i popullit Svani ose Svaneti vjen nga Sevani, pra nga Liqeni Sevan. Pasi Avani dhe Kaini u martuan (Për më tepër informacion, ju lutem referojuni Librit të Ngjarjeve, Ngjarja e Katërt) u vendosën në atë zonë, e cila ishte në veri dhe perëndim të Lumit Aghstev dhe rreth Liqenit Sevan, në Armeni. Pasardhësit e tyre e morën emrin nga Avani, pasi Kaini ishte fajtor se kishte vrarë vëllanë e tij Abelin. Emri i Sevanit, pra i Svanit ose Svenit, vjen nga Sa-Van që do të thotë “Toka e Avanit”. Sveonët ose Svionët ishin një degëzim i Soanëve ose Svenit, dhe ata janë të njohur për themelimin e Mbretërisë së Suedisë në Skandinavi.

\* \* \*

**Kaini** ose **Kajeni** ishte biri i Adamit dhe Evës. Vendbanimi i Kajenkëve, që ndodhej në veri dhe perëndim të Lumit Aghstev në Armeni, e mori emrin nga Kaini, i cili njihej edhe si Kajen, biri i Adamit. Libri i Ngjarjeve, në Ngjarjen e Katërt, pohon se Kaini mori motrën e tij, Avantin, si gruan e tij dhe u trashëgua me Enokun.

\* \* \*

**Sethi**, i biri i Adamit, ishte paraardhësi i fisnikëve Sethianë. Libri i Ngjarjeve, në Ngjarjen e Pestë, pohon se Sethi mori motrën e tij, Azurën, si gruan e tij, dhe u trashëgua me Enosin ose Enoshin. Fisnikët Setheanë ose Soteanë njiheshin, gjithashtu, si fisnikët Sodketsi. Ata fillimisht jetonin në vendbanimin e Setkut ose Sotkut përpara Përmbytjes së Madhe. Prona Sodk ndodhej në juglindje të Liqenit Sevan. Noe dhe bijtë e tij morën vetëm gra me prejardhje Sethiane. Sethianët ishin popull besimtar, sepse Sethi ishte i dashur dhe i bekuar nga Zoti, dhe ata i shpërndanin mësimet e Sethit gjatë gjithë Armenisë, Anatolit, dhe bregut lindor të Detit Mesdhe.

\* \* \*

**Azura** ishte bija e Adamit dhe Evës, dhe ajo ishte gruaja e Sethit. Liqeni Urmia është quajtur gjithashtu edhe Liqeni Azur dhe Liqeni Kaputan në historinë e lashtësisë. Liqeni Azur e mori emrin nga Azura. Azur, Azure ose Azura ka rrënjë Latine, Persiane dhe Arabe, dhe do të thotë “Blu”, “Qiel” ose “Parajsë”. Emri Armen për Liqenin Urmia ishte Kaputan Liç, nga fjalët Maqedonase dhe Romake – “Liknitis (Lychnitis), që do të thotë “Liqen”, pra do të

thotë “Liqeni Blu”. Emri për Liqenin Kaputan ose Liqenin Blu (Azur) u ndryshua në Urmia ose Ur-Mia gjatë sundimit Arab. Ur-Mia do të thotë “Ur”-“Tokë” dhe “Mia”-“Ujë” në gjuhët Arabe dhe Siriake, dhe ishte fillimisht emri i qytetit Urmia, i cili njihej si Qyteti-Ujë për shkak të vendndodhjes së tij, dhe më pas u kthye në emrin e Liqenit.

\* \* \*

## Pasardhësit e Noes

**Noe** ishte i biri i Lamekut (ose Ghamekut), dhe një pasardhës i Adamit. Noe dhe familja e tij i mbijetuan Përmbytjes nëpërmjet Arkës, të cilën ai dhe familja e tij e kishin ndërtuar në përputhje me fjalën e Zotit. Prej Noes rrodhën shumë familje dhe kombe, përfshirë edhe popullin Nairi ose Noi-Ri. Ri do të thotë “mashkull, burrë” (Mates – në Anglisht) në gjuhët Ballkanike dhe Anatoliane dhe Nai ose Noi është një tjetër variant i emrit Noe. Noe është quajtur, gjithashtu, Ksisuthros ose Ziusudra prej Grekëve dhe prej popujve Mesopotamianë, si nofkë ose si mbiemër për të mbijetuarit e Përmbytjes. Sipas Biblës së Shenjtë, Libri i Gjenezës, Arka e Noes ngeci në Malin Ararat, ku Noe dhe pasardhësit e tij patën fatin t’i mbijetojnë Përmbytjes dhe të ripopullojnë botën. Noe dhe gruaja e tij patën shumë djem dhe vajza, të cilët, gjithashtu, nga ana e tyre u çiftuan dhe u trashëguan me djem dhe vajza të tyre. Në kulturat Mesopotamiane dhe ato Ariane të lashta “em” ose “am” nënkupton femëroren; p.sh. Nojem nënkupton Znj. Noe ose gruaja e Noes; Mari ose Marija nënkupton burrë fisnik dhe Mariam nënkupton një grua fisnike, etj... Mali Ararat, që në Bibël është përmendur si vendqëndrimi i Noes pas përmbytjes, një herë e një kohë quhej Mali i Noes. Persianët e quanin atë Kuh-e-Nuh, që do të thotë Mali i Noes. Lugina Ararat një herë e një kohë quhej Vreshti i Noes. Armenia ka pasë qenë quajtur Nairian Ashkhar, që do të thotë Toka e Noi-Ri, dhe Armenët kanë pasë

qenë quajtur populli Nairi ose Nairian për shkak të Noes, populli i të cilit njihet si populli Nairi ose Noi-Ri.

Sipas Ghevond Alishanit dhe Moisi Korenacit, Noe dhe djemtë e tij, Xhafet Oste, Sem Zrvani dhe Ham Titani morën për gra pasardhëset e Sethit dhe vajzave të Noes, Astghik (Astlik) dhe Araza që i përkisnin fisnikëve Sethianë. Astghik do të thotë Yll dhe prej historianëve Grekë ajo njihet si Astraea. Lumi Aghstev e ka marrë emrin prej Astghikut. Lumi Araza, i njohur gjithashtu si Arazanias ose Aratsani, e ka marrë emrin prej Arazas. Nuk dihet ende nëse Astghiku ose Araza u martuan ndonjëherë; sidoqoftë Araza ishte nënë e dy figurave mashkullore, të quajtur Skita dhe Breton, prej nga rrodhën Skithët dhe Bretonët. Shumë karaktere Biblike janë emërtuar si djem të Noes në Biblën e Shenjtë; prandaj, ka një farë çoroditje për sa i përket faktit se kush janë në vërtetë djemtë e Noes dhe kush janë pasardhësit e Noes. Burime jo-Biblike, që kam pasur mundësi t'i shfletoj, përmendin vetëm tre djem dhe dy vajza si fëmijë të Noes. Të gjithë figurat e tjera Biblike, megjithatë, mund të konsiderohen si pasardhës të Noes. Libri i Ngjarjeve tregon se Noe u varros mbi Malet Ararat.

\* \* \*

**Semi** ishte djali i Noes Biblik. Mali Semsar i Malësive Armene dhe vendbanimi Zaravand në perëndim të Liqenit Urmia e kanë marrë këtë emër prej Sem Zrvanit. Arpaçshad ose Arphaksad (udhëheqësi dhe mbreti i Semitëve), Elem (Elamites), Ashura (Assirianët), Lud (Lidianët) dhe Aram (Arameanët ose Sirianët) kanë qenë djemtë e Semit Biblik, dhe Madai (Madajanët ose Medët) ka qenë dhëndri i Semit (burri i vajzës së Semit), i cili banoi në tokat e Semit.

\* \* \*

**Arpaçshadi** ka qenë djali i Semit Biblik. Lumi Arpa është një nga degët furnizuese me ujë të Lumit Araz ose Araks në Armeni. Lumi e ka marrë këtë emër prej Arpaçshadit, djalit të Sem Zrvanit dhe nipit të Noes.

\* \* \*

**Ludi** ka qenë djali i Semit Biblik. Disa studjues deklarojnë se Lidianët janë pasardhësit e Ludit; të tjerë deklarojnë, se populli Lullubi (Për më tepër informacion rreth popullit Lullubi, ju lutem referojuni seksionit Fjalor në fund të këtij libri) janë pasardhës të Ludit, sepse tokat e Ludit kanë qenë në perëndim dhe në afërsi të tokave të Madait.

\* \* \*

**Ham** Titani ka qenë djali i Noes Biblik. Vendbanimi Hamshen (Hamshen ose Ham-shen do të thotë “ndërtuar prej Hamit”) e ka marrë emrin prej Ham Titanit. Ka fakte dhe dokumenta historike, që Cimberianët kanë qenë vendosur në Hamshen; prandaj, shumë vende në Hamshen kanë emrin Kemer.

\* \* \*

**Xhafet** Oste ka qenë djali i Noes Biblik. Vendbanimi Ostan ka qenë vendosur në juglindje të Liqenit Van dhe e ka marrë emrin prej Xhafet Oste. Xhafet Oste është emri i Xhafetit Biblik, njerit prej tre

djemve të Noes dhe Oste (Oste ose Osto do të thotë “kockë, eshtër” në gjuhën Greke) është një nofkë ose mbiemër, që i është dhënë Xhafetit sepse ishte një njeri trupmadh ose kockëmadh. Ostan ka qenë një qytet në krahinën e Vaspurakanit të Mbretërisë Urartu dhe në Mbretërinë Armene pas-Urartiane. Ostan do të thotë Provincë (krahinë) dhe Ostandar në gjuhën Perse do të thotë Guvernator (Qeverisës). Kuh-e-Ostan është një mal në Persi. Ostan është emër familjeje. Oste është emër familjeje. Në Saksoni të Gjermanisë ka një lumë që quhet Lumi Oste.

\* \* \*

**Gomeri** është paraardhësi i përbashkët i Sumerianëve, popullit Mar ose Mari, dhe i Cimmerianëve (*Shënim B.P.*: mund të lexohet edhe: Kimmerianëve, Gimmerianëve). Mar ose Mari nënkupton Shenjt në gjuhën Assiriane dhe Mari ose (m)Ari nënkupton Fisnik në gjuhët Ariane. Fisnikët Muratsean dhe emrat e familjeve Marutean, Maribian, Mariphian, Maraphian (*Shënim B.P.*: mund të lexohen edhe: Muratsjan, Marutjan, Maribjan, Marifjan, Marafjan) dhe të tjerë janë pasardhës të popullit Mar ose Mari. Gomer është paraardhës i Cimmerianëve, i popullit Mar ose Mari, i Sumerianëve, i Gymri, Gamir dhe popujve të tjerë. Gomer ose Gamir është variant i lashtë i emrit Karmir (Garmir), që do të thotë “i kuq” në gjuhën Armene. Cimmerianët vishnin rroba me ngjyrë të kuqe. Disa popuj në Armeninë e lashtë vishnin rroba në ngjyrë të kuqe në ditë të veçanta të shënuara për ta, siç ishin p.sh. martesat dhe ditët festive, sepse Gomeri Biblik ka qenë njohur si Dragoi i Kuq. Gomeri Biblik ka qenë njohur si aleati i Gogut. Gog do të thotë Veri në gjuhën Uellsiane, dhe Gugark ose Gogarene ka ekzistuar gjithnjë si provincë veriore e Armenisë. Populli Uellsian e quan gjuhën e vet Gomereg dhe vendin e tij Uells, Kumru ose Gymru. Ka shumë fjalë të përbashkëta në gjuhën Armene dhe atë Uellsiane,

gjë që provon, se Uellsianët e lashtë ose Cimmerianët dhe Armenët e lashtë kanë qenë i njëjti popull ose popuj shumë të afërt. (Për të mësuar më tepër për fjalët Armene dhe Uellsiane shih translate.google.com).

\* \* \*

**Tiras** ose Thirak ishte djali i Gomerit dhe nip i Xhafetit. Prej Tirasit rrjedhin Thrakasit, Trojanët dhe shumë të tjerë. Tirasi ishte babai i Askanazit dhe Torgomit (Togarma) dhe duke qenë se Hajku ishte njëri prej shumë nipave të Tirasit, Armenët mund të konsiderohen edhe si popull Thrakas. Në mitologjinë Armene, Tirasi adhurohet si Tir, një prej zotave të shumtë në Armeninë e lashtë. Populli Thrakas ka qenë popull Arian, që banonte në Malësitë Armene dhe në Kaukazet përpara se ta shtrinte influencën e tij dhe të lëvizte në të gjitha drejtimet e botës së njohur prej tij. Ka shumë fjalë të përbashkëta në gjuhën Thrake dhe Armene, si edhe shumë ngjashmëri kulturore ndërmjet Thrakasve dhe Armenëve. Tirasi është identifikuar gjithashtu edhe si Taurus ose Bull. Thrakët e Dor-ëve në Kanaan u bënë Dorianët në Gadishullin Ballkanik. Pasardhësit Thrakë të Dido-s (Shih Eneidën e shkruar nga Virgjili) ishin dinastia e parë e Kartagjenës (Carthage). Populli Dido, gjithashtu, njihet edhe si populli Cez, dhe ata ekzistojnë akoma edhe sot në Dagestan. Tokat e popullit Thrak, duke u shtrirë shumë nga veriu, arritën deri në Skandinavi, e cila u emërtua sipas Askanazit ose Askanusit, vëllait të Torgomit ose Rifatit. Deti Azov në Rusi e ka marrë këtë emër për nder të pasardhësit të mbretit Thrakas të asaj zone, të quajtur Aes.

\* \* \*

## Pasardhësit e Torgomit

Togarma është versioni Grek i emrit Torgom. Torgom ose Tor-Gom (Tor – në gjuhën Armene dhe ato Ariane nënkupton “nip”, ndërsa Gom është njëlloj si Gomer ose Gamir) ishte djali i Tirasit dhe nipi i Gomerit. Prej Torgomit rrodhën Haos ose Hajku, Kartlos ose Kar, Bardos ose Bardan, Movakos ose Movkan, Lekos ose Lekan, Heros ose Heran, Kaukaz ose Kavkaz, dhe Egros ose Axhar, të cilët kanë qenë njohur si vëllezërit Torgomianë. Mbretëria e Torgomit ndodhej në jug të Mbretërisë së Askanazit. Mbretëria e Askanazit ndodhej në veri të Maleve të Kaukazit.

Pas vdekjes së Askanazit, Torgomi i adoptoi nipërit e tij dhe u përkujdes për ta së bashku me fëmijët e tij, dhe ata e pranuan Torgomin si mbretin e tyre. Torgomi ndërtoi Harkun si vendqëndrim të tij. Me vdekjen e Torgomit, Harku u shndrrua në vendqëndrim të Hajkut dhe të treqind trimave të tij së bashku me familjet e tyre. Ka studjues, që thonë, se Togarmahu ka qenë paraardhësi i popujve Turkikë; megjithatë, këto burime janë zhvlerësuar. P.sh., një studjues çifut i mesjetës, Joseph ben Gorion liston në Josipponin e tij dhjetë bijtë e Togarmas si më poshtë vijon: Kozar-Khazar, Pakinak-Peçeneg, Aliqanos-Alan, Bulgar-Burgar, Raxhbixha-Raxhbinas, Turqi-KokTurks, Uz-Oghuz, Zabuk, Ungari-Hungarian dhe Tilmak-Tauri; sidoqoftë, Joseph ben Gorion është zhvlerësuar si shkrimtar nga (JewishVirtualLibrary.org) në artikullin e titulluar: Josippon, Enciklopedia Çifute (JewishEncyclopedia.com) në artikullin e titulluar: Joseph ben Gorion, prej Franz Delitz dhe studjues të tjerë, si një shkrimtar me plot gabime historike dhe për futje të të dhënave fiktive. Kronikat e Jerahmeel, ose Historia e Biblës Hebraike pohon, që pasardhësit e Togarmahut janë: Sorbin-Servianët, Lusiai-Losatianët, Liish'an-Polakët, Krabat-Kroatët,

Bosniin-Boshnjakët, Asidinia-Askania. Ju lutem, kini parasysh, që kombet e sipërpërmendur janë zhvilluar mijëvjeçarë pas kohës kur ka jetuar Togarmahu dhe nuk ka shënime, që të nxjerrin në pah ekzistencën e këtyre kombeve prej historianëve, të cilët shkruan për kohën e njohur përgjithësisht si B.C.E. ose Përpara Epokës Tonë. Kështu, Askania ka qenë emri i mbretërisë së Askanazit. N.q.s. Askanazi ka qenë vëllai Togarmahut, përse është listuar si pasardhës i Togarmahut? Kjo nuk bën sens. Besimi se Togarma ose Torgom ka qenë paraardhësi i popujve Turkikë, gjithashtu, është zhvlerësuar prej burimeve të tjera. P.sh., sipas Legjendës Hungareze të Drerit të Bardhë, Nimrodi ishte babai i Hunorit dhe Magorit, të cilët u bënë paraardhësit e Hunëve dhe Maxharëve. Disa studjues deklarojnë, se Hunët dhe Maxharët janë popuj Turqishtfolës, dhe studjues të tjerë deklarojnë se Skithët janë popull Turqishtfolës. Sipas Shanameh të Firdusit (Hakim Abu'l-Qasim Ferdusi Tusi ka qenë një poet Persian, i cili ka jetuar në periudhën 940-1020 A.D.) Mbreti Abtin dhe gruaja e tij, Faranak, ishin prindërit e Mbretit Feridun. Mbreti Feridun ishte babai i Salm - Mbret i Salm ose i Perëndimit, Mbret i Sairima ose Sarmatia, Irajit - Mbret i Iranit dhe Turit - Mbret i Turit. Turan është emri Persian për Azinë Qendrore. Ferdusi e emëron lumin Oksus si kufirin ndërmjet Iranit dhe Turanit. Libri i Zhou, Tongdian (T'ung-tien) dhe burime të tjera Kineze emërtojnë Tuxhu dhe Gokturk (Gokturk ose Kokturk do të thotë Blu ose Turk Qiellor, që është konfederata e parë Turkike, e cila u bë një perandori, që shtrihej nga Mongolia në Azinë Qendrore) si të njëjtin popull, të cilin e kishte pushtuar Dinastia Kineze Tang. Historia dhe faktet sugjerojnë, që populli Tuxhu pushtoi ose u shkri me popullin e Turanit (Azia Qendrore) dhe u bënë armiq me popullin e Iranit. Një tipar të përbashkët, që popujt Turkikë kishin ose kanë, është ai i të adoptuarit të emrave të vendeve, që ata pushtojnë, si emra për kombin e tyre, gjë që ndihmoi në unifikimin e shumë tribuve Turkike për të formuar një vend të ri

dhe ata e riemëruan popullin e tyre për të formuar një emër për kombin, që do të mund të tingëllonte si emër vendas (autokton). P.sh., Oguzët ose Turqit Perëndimorë pushtuan vendet e Gogut dhe Magogut dhe e emërtuan veten Gokturk ose Maxhar.

Turqit Bulgar ose Balkar pushtuan tokat e Lumit Vollga (Bulga) dhe e emërtuan veten Bulgarë. Grekët (Bizantinët) i vendosën Turqit në Azinë e Vogël, me qëllim që të kontrollonin popullsinë jo-Greke të perandorisë së tyre. Më vonë Turqit Selxhukë pushtuan Seleukinë (Seleukia ishte Mbretëria e Seleukut, një prej gjeneralëve të Aleksandrit të Madh) dhe e quajtën veten Selxhuk. Turqit pushtuan, gjithashtu, të gjithë Azinë e Vogël dhe Thrakën prej Greko-Bizantinëve. Turqit e Azerbajxhanit (Tatarët dhe Turqit, që banonin në veri të Maleve Kaukaze) pushtuan Shirvanin, Arranin dhe Azerbajxhanin (Azerbajxhanin Iranian) dhe u vetëquajtën Azerbajxhanas. Turqit pushtuan krahinat veriore të Qipros dhe formuan Republikën Turke të Qipros Veriore.

\* \* \*

## Pasardhësit e Hajkut

**Haos** në Greqisht ose **Hajk** në Armenisht dhe në gjuhën Ariane ka qenë djali i parë i Torgomit. Hajku ishte, gjithashtu, i njohur si Ha, Hiig, ose Hignes prej popujve të etniciteteve të ndryshme. Ai mori si trashëgimi gjysmën e tokave të Torgomit dhe autoritetin e mbretit mbi vëllezërit e tij. Tokat e Hajkut ishin tokat, që ndodheshin në jug të Maleve Artaz, duke përfshirë edhe tokat e Taraunit, Turuberanit, Liqenit Van dhe të Mesopotamisë Veriore deri në kufi me Lullubinë dhe me Assirinë nga ana e jugut, dhe nga Liqeni Kaputan ose Liqeni Urmia deri në kufijtë e Mbretërisë Mannaeen. Vendqëndrimi i Hajkut u emërtua Hajkashen;

sidoqoftë, Hajoc Cori dhe shumë vendbanime dhe qytete u emërtuan duke pasur për bazë emrin Hajk. Prej Hajkut rrodhën fisnikët Hajkazuni dhe populli Haj ose Armen. Hajku ndërtoi kështjellën Hajkaberde në Hajkashen si vendqëndrim të tij. Ti-Hajku ose Tajku, që do të thotë Hajku i Madh ose Mex Hajk (mex – i madh) e mori emrin prej Hajkut. Tajku më pas u quajt Tiauhi ose Diaukhi prej Urartianëve. Hajku ka pasë qenë adhuruar si një prej shumë zotave në Armeninë e lashtë.

**Aramaneak** (Araman-Heag ose Araman-Hajk që do të thotë Aramani i Hajkut, pasi Hajku njihej, gjithashtu, edhe si Hiig, si edhe me emra të tjerë) ka qenë njohur si Armenak, Ndërtuesi i Kombit, në historinë Armene. Ai ishte i biri i Hajkut. Aramaneaku ka qenë paraardhësi i popullit Armen (Armen) dhe i popullit Aram (Aramaik). Aramaneaku ndërtoi Aramaneakits ose Aramaneagats si vendqëndrim të tij (Aragatsoni pranë Malit Aragats).

**Khor** (Kor ose Cor) ose Khur, ishte djali i Hajkut, prej nga rrodhën fisnikët Khorkhoruni. Khor ndërtoi Khorkhorunikun si vendqëndrim të tij. Khor ose Khur është gjithashtu prindi i popullit Khurrit, i cili nga ana e tij ka qenë një tribu Hurro-Urartiane ose Khurro-Urartiane; pra, ata janë popuj të lashtë Armenë ose të afërm me ta. Në gjuhën Hurro-Urartiane dhe në Assirishten e lashtë nuk ka gërmë O dhe në vend të saj përdoret germa U. Lumi Kur ose Kura e ka marrë emrin prej tij, dhe njihet si kufiri ndërmjet Hurro-Urartianëve dhe Cimmerianëve. Sipas studjuesit sovjetik Igor M. Diakonov dhe Sergei A. Starostin, gjuhët e Kaukazit Lindor janë një degë e grupit Hurro-Urartian të gjuhëve. Korintasit (Korinthasit janë populli i përmendur në Bibël) janë pasardhës të Khorit. Khorit dhe Familja Khorkhoruni jetuan në vendet në veriperëndim të Liqenit Van, të quajtur Taravan (Taraun). Taravani (Tarauni) është njohur, gjithashtu, si Taron dhe ka qenë në perëndim të Tauruberanit ose Turuberanit. Qyteti i vendqëndrimit të Khorit ka qenë quajtur Khorkhorunik dhe nuk ka qenë larg prej Harkut, vendqëndrimit të Torgomit. Pas

vdekjes së Torgomit, Hajku e shndroi vendqëndrimin e Torgomit, Harkun, në një vendqëndrim të treqind trimave luftëtarë të tij dhe familjeve të tyre.

**Manavazi** ishte djali i Hajkut, prej nga e kanë prejardhjen fisnikët Manavazian. Manavazi ndërtoi Manazkertin si vendqëndrim të tij. Manavazi dhe Bazi ose familjet Manavazian dhe Bznuni jetonin në tokat në verilindje të Liqenit Van. Atje ata ndërtuan Manazkertin dhe Bznunikun. Në historinë e Armenisë, Liqeni Van ka pasë qenë quajtur edhe Deti Bznuni në nder të Bazit.

**Kadmos** ose Cadmus, djali i Aramaneakut dhe nipi i Hajkut, ka qenë njohur, gjithashtu, si Kadman në disa shënime. Prej Kadmosit rrodhën fisnikët Kadmeanë, të cilët jetuan në jug të liqenit Van. Kadmosi ndërtoi Korçajkun si vendqëndrim të tij. Hajku kurorëzoi nipin e tij, Kadmosin, si mbret të Fenikias, pasi që nga momenti që Feneçi kishte vdekur në mënyrë të mistershme, tokat i kishin kaluar në administrim Nimrodit, dhe pas vrasjes së këtij të fundit nga Hajku, Fenikasit kishin nevojë për një mbret të ri; kështu Kadmosi u bë mbreti Fenikasve në momentin që Hajku u bë mbret i mbretërisë së Nimrodit.

**Pakh** dhe **Paksam**, nipi dhe mbesa e Hajkut dhe Movkanit, nxorrën në dritë fisnikët e Pakhinit në krahinën Pakhnatun të Sofenes (Sophene) ose Xopkut dhe fisnikët e Angegh në Angegh-Tun.

**Angegh** ose Angel; prej Angel rrjedhin fisnikët Angegh, si edhe populli Angelian dhe populli Anzhu. Paksami ndërtoi Ingalovën (Shih ngjashmërinë ndërmjet Ingal dhe Ingaland, gjithashtu Angegh dhe Angel) ose Ingal-Avan si vendqëndrim të tij. Thori ishte një pasardhës i Paksamit, i cili kaloi nëpër Thrakë, në tokat e Thrakasve, të cilët janë pasardhës të Tirasit, dhe udhëtoi për në perëndim dhe veri.

**Aramais**, djali i Aramaneakut dhe nipi i Hajkut, nxorri në dritë Amasian dhe Sharrin. Qytetet e reja: Amasia dhe Shirak u ndërtuan për ta. Aramaisi ndërtoi Armavirin si vendqëndrim të tij.

**Bazi**, djali i Manavazit dhe nipi i Hajkut, ishte babai i fisnikëve

Bznuni dhe Basean, të cilët jetuan në perëndim të Liqenit Van, dhe prej tij rrodhi edhe populli **Bask**. Krahina Basoporakan ose Vaspurakan e ka marrë emrin prej Bazit. Prej djalit të Bazit, Ordit, rrjedhin fisnikët Orduni.

**Frig** (Phryg) ose Vrig, djali i Manavazit dhe nipi i Hajkut, nxorri në dritë popullin Frigian. Frigu ndërtoi Frigian si vendqëndrim të tij.

Aramaisi trashëgoi Mbretërinë e Aramaneakut, dhe pasardhësit e tij, prej Amasias dhe Sharrit, mbajtën detyrat e udhëheqësve të Mbretërive...

**Amasia** ose Am-Asi (Am-Asi nënkupton: Am ose femër dhe Asi ose shpatare, një femër luftëtare; ose gruaja e Asias) ishte motra e Sharrit, dhe të dy së bashku Amasia dhe Sharri patën Aramaisin si baba. Tokat e Azisë së Vogël, Armenia dhe Assiria u quajtën Azia për shkak të Amasias. Amasia, gjithashtu, riemërtoi Malin Ararat dhe e quajti atë Amasis ose Masis dhe tokat përqark tij Maseatsotn. Amasia njihet të jetë paraardhësja e Sisakut dhe Armas në historinë Armene. Amasia organizoi një ushtri femërore. Populli Amazon besohet të jenë pasardhëset e këtyre luftëtareve femra. Aktualisht Amazonë quhen banorët e Ossetisë. Fjala Osse do të thotë Grua, dhe Ossetha do të thotë Gra në gjuhën Ossetiane. CT (Set) nënkupton “Zonjë” në gjuhën Egjiptiane.

**Suhis**, djali i Amasias, pati trashëgimtar Kajpakun. Kajpaku pati trashëgimtar Cangarin ose Kangarin.

**Cangari** ose Kangari, djali i Kajpakut, nxorri në dritë fisnikët e Cangarkut ose Kangarkut, një vendbanim në vendet që ndodhen në veri të Shirakut ose Sirakenit dhe në juglindje të Xhavahkut.

**Parokhu**, djali i Amasias, është babai i popullit të Parakhotnit, i cili banonte pranë Maleve Parakh.

**Colak** ose **Tcolarkh** ishte djali i Amasias. Colak ose Tcolarkh ishte paraardhësi i fisnikëve të Colarzenit ose Kolarzenit (Klarjik) pranë Tajkut (Tao-Klarjeti në gjuhën Gjeorgjiane) ku pasardhësit e

Hajkut dhe Kartlosit jetonin në harmoni, deri sa krahina u pushtua prej Aleksandrit të Madh. Aleksandri i mori Iberianët, popullin që banonte në Gadishullin Iberik, dhe i vendosi ata në tokat e Kartlisë. Aleksandri emëroi Azo ose Azonin si Guvernator apo Satrap të Kaukazit. Iberianët u ngarkuan që të mbështesnin Azonin dhe ushtritë e Aleksandrit në Kaukaz. Kështu, u krijua një mbretëri e re, që u emërtua Iberia (Iverastan ose Vrastan në gjuhën Armene) dhe populli u quajt Iberian (Iveraci ose Vraci në gjuhën Armene) që do të thotë se Iberianët nuk janë i njëjti popull me popullin Kartli.

**Gegh** ose Gel, djali i Amasias, dhe gruaja e tij, Gegham (Gegham ose Gegh-Am nënkupton “Gruaja e Geghut”; Urartianët e lashtë përdornin L në vend të Gh, U në vend të O, etj.) patën si trashëgimtarë dy fëmijë: Sisak dhe Arma. Gjatë kësaj kohe, Liqeni Sa-Avan (Liqeni Sevan) u riemërtua në Liqeni Geghama.

**Sisak**, djali i Gegh dhe Gegham, janë prindërit e fisnikëve Sisakianë, të cilët njihën si fisnikët Sjuni të Krahinës së Sjunikut.

**Gar** ose Garnik, djali i Sisakut, nxorri në dritë fisnikët e Garnisë. Ka shumë fakte që e mbështesin tezën se populli Gargarean (aktualisht Qalqal ose Ingush) është pasardhësi i Garit.

**Varazh**, djali i Garnikut, nxorri në dritë fisnikët e Varazhnunit.

**Akn** ose **Sevahn** (Sev do të thotë “i zi” dhe Akn do të thotë “sy” në gjuhën Armene) ishte djali i Varazhit. Akn nxorri në dritë fisnikët e Aknunit. Ashtu si Hajku, edhe Akn ka qenë i njohur si një harkëtar i zoti në historinë Armene.

**Arma** ishte djali i Geghamit. Ai unifikoi popullin Armen dhe popullin Subr (Shubrianët) dhe shkoi të luftojë kundër Assirianëve.

Pasi mposhti Assirianët, ai krijoi një mbretëri të re dhe e emërtoi atë Arme-Shubria. Njerëzit me mbiemër Subrkhanian janë pasardhës të popullit Shubria. Arma pati si trashëgimtarë Aramin dhe Khoin. Ambar, djali i Khoit, u rrëzua nga fronti dhe me shumë gjasa është vrarë prej Sargonit të II<sup>të</sup> të Assirisë.

**Arami** ka qenë njohur si mbreti i parë i Urartusë dhe babai i Aras së Bukur. Arami mposhti Assirianët dhe e çliroi vendin prej zaptuesve të huaj. Ai luftoi kundër Assirianëve, Cimmerianëve dhe Titanëve të Azisë së Vogël.

**Ara e Bukur** (Ara Bukuroshja) vdiq në betejë kundër ushtrive Assiriane të Mbretëreshës Shamiram (Shamiramis).

**Kardos**, njeri prej djemve të Aras së Bukur, u martua me një pasardhës të Kadmosit, dhe tokat Kadmeane u riemërtuan në Karduene. Shumë studjues pohojnë, që Carduene ose Korduene është e njëjta gjë me Kurdistan, ku jetojnë Kurdët. N.q.s. vërtetohet që kjo është e vërtetë, atëhere nipi i Aras së Bukur, Cardus në Greqisht ose Kardos në gjuhën Ariane, është paraardhësi i popullit Kurd.

**Aran**, që nënkupton Ara, gjithashtu, është quajtur Arean Ara nga Moisi Korenaci. Arani është një prej djemve të Aras së Bukur; ai u martua me një pasardhëse të Sisakut dhe pati si trashëgimtar Anushavanin.

**Anushavan** në gjuhën Armene ose Aluavan në gjuhët Hurro-Urartiane ishte djali i Aranit. Nga Arani dhe Aluavani rrjedhin fisnikët e Arranit dhe vendi mori emrin **Aluank** ose **Alvank**, që njihet gjithashtu si **Albania**, një mbretëri në veri të Arranit. Kjo sipërfaqe ishte pjesë e Armenisë deri sa u pushtua prej Persianëve, dhe mori emrin Arran-Albania, dhe populli i Alvankut mori emrin populli Alban. Për shkak të influencës Perse në Aluank, gjuha, besimi Zoroastrian dhe kultura e popullit Alban u bënë njësh me atë të Persisë. Mbreti i Arran-Albanisë u quajt Arran-Shah. Pasi mbreti Urnair shkoi në Armeni dhe solli Kristianizmin në Arran-Albania, Grigoris, nipi i Gregor (Grigor) Iluminatorit u emërua si Bishop i Arran-Albanisë. Grigoris u kap dhe u vra prej Arianëve me prejardhje Albane. Nën Mbretin Vaçe Peroz, Mbretëria e Arran-Albanisë ju përshtat Armenisë në strukturë, besim dhe kulturë, por kishte akoma edhe shumë influenca prej popujve Persianë, Arianë dhe Kaukazianë. Arran-Albania përfshinte tokat e Bardos, Lekanit

dhe Movkanit. Shekuj më vonë, Armenia dhe Albania u pushtuan prej Romakëve, dhe shumë Armenë dhe Albanë u lëvizën në drejtim të Gadishullit Ballkanik dhe pjesëve të tjera të Europës prej Romakëve dhe Greko-Bizantinëve. Paretit ishte djali i Anushavanit. Arbaku ishte djali i Paretit dhe nipi i Anushavanit. **Sos** ishte djali i Anushavanit. **Parisos** e ka marrë emrin prej Sos.

**Sharri** nxorri në dritë fisnikët e Shirakut dhe Shaharunikut. Sharri ka qenë quajtur, gjithashtu, Sharru, Shir ose Shere, sipas dialekteve të ndryshme. Shrrail, që nënkupton “bujar”, është një mbiemër që e përshkruan atë, dhe që në gjuhën Armene do të thotë “Bujar, ose Zemërgjerë”. Sharri ka pasë qenë njohur, gjithashtu, edhe si Shataker Sharran, që do të thotë “Sharri që han shumë” ose Sharri llupës”.

**Erasti**, djali i Sharrit, u kurorëzua si Mbret i popullit Urartian Eriukhi. Prej historianëve të lashtë Uruku quhej ndryshe edhe Ereç; sidoqoftë, marrëdhënia ndërmjet Ereç dhe Erast kërkon studim më të thelluar. Ereçbuni ka qenë emri i vjetër për Erevanin, që gjithashtu mund të konsiderohet një tjetër dukuri, që të shtyn të mendosh se populli i lashtë i Urit dhe Urukut kanë qenë të lidhur me Popullin Torgomian, pasi ata kanë qenë të gjithë të racës Thrake. Ere ose Eri nënkupton popullin Eriukhi, i cili banonte në vendet ndërmjet Malit Ararat dhe Malit Aragats, dhe Bun ose Buni do të thotë Fole (çerdhe, strofull) në gjuhën e vjetër Urartiane dhe Armene; prej këtij rrjedh edhe kuptimi i emrit Ereçbuni.

\* \* \*

## Pasardhësit e Kartlosit

**Kartlos** në Greqisht dhe Kar ose Kard në gjuhën Ariane (rrënja për emra të tillë si: Karen, Karo, Karapet, Karine dhe emra vendesh si: Kars, Karin, Kartli, etj) ishte djali i dytë i Torgomit. Ai mori gjysmën e asaj që kishte ngelur nga tokat e Torgomit pas ndarjes së

pjesës që mori Hajku si trashëgimi. Tokat e Kartlosit ishin tokat, që shtriheshin nga perëndimi i Malit Artaz deri në Detin Perëndimor (Deti i Zi ose Deti Euksine) dhe Malet Kaukaze. Vendqëndrimi i Kartlosit u quajt Kartli; sidoqoftë, shumë vendbanime dhe qytete të tjera në atë zonë morën emrin sipas Kar. Kartlosi ishte babai i popullit Kartli dhe i mbretërisë Karia në Azinë e Vogël. Ka shumë qytete dhe vendbanime në Armeni me rrënjën Kar.

**Metshke** ose Metshketha, djali i Kartlosit, ishte babai i popullit Mtshketi të Sa-Mtshkhe, që nënkupton populli i Metshketha-s. Sipas studjuesve Gjeorgjianë të ditëve të sotme dhe disa historianëve Grekë emri Metshkhe ose Mskhetos është, gjithashtu, i lidhur me Mesheçin, paraardhësi i popullit Muski ose Mushki. James Robert Rusell, studjues dhe profesor në sektorin e Studimit të Gjuhëve dhe Civilizimeve të Lindjes së Afërme të Lashtë, Iranit dhe Armenisë në Universitetin e Harvardit pohon, se përcaktimi Gjeorgjian për Armenët është Somekhi. Somekhi dhe Samtskhe janë fjalë gjuhësisht të lidhura. Metskheta mund të jetë e prejardhur prej fjalëve Mets ose Metz (Mex - në Shqip), që do të thotë “e madhe” në gjuhën Armene, dhe Kheta. Mskheta ose Meskheta, gjithashtu, mund të jetë një variacion i fjalës Mesheç, gjë që është më pak e mundshme.

**Gardabos** ose Gardaban, djali i Kartlosit, ishte babai i popullit Gardman. Ai mund të ketë qenë, gjithashtu, i afërm me Bardosin dhe pasardhësit e tij nëpërmjet martesave për të zotëruar tokat e Gardmanit.

**Kakhos**, djali i Kartlosit, ishte babai i popullit Kakheti.

**Koghk** ose Kolk, djali i Kartlosit, ishte babai i popullit Kolki ose Kolkhida, të cilët jetonin në veri dhe lindje të tokave të Egrosit.

**Gaj** ose Kaj, djali i Kartlosit, ishte babai i fisnikëve Kajberuni.

**Uflos**, djali i Metskhes ose Mskhetos, ishte babai i popullit Uplistsikhe.

**Odrzkhos**, djali i Metskhe ose Mskhetos, ishte babai i popujve Odrzkhe dhe Adigeni.

**Xhavakos**, djali i Metskhe ose Mskhetos, ishte babai i fisnikëve Zabaaskhae në gjuhën Urartiane ose Xhavakhq në gjuhën Armene.

\* \* \*

### Pasardhësit e Bardanit

**Bardos** në Greqisht dhe Bard ose Bardan në gjuhën Ariane ishte djali i tretë i Torgomit. Ai mori gjysmën e asaj që kishte mbetur nga tokat e Torgomit pas ndarjes së pjesëve për trashëgimitë e vëllezërve të tij më të mëdhenj. Tokat e Bardosit ishin tokat në lindje të Malit Artaz deri në Lumin Kura (Lumi Kura gjithashtu quhej edhe Qiura Taikh në gjuhët Urartiane dhe Ariane) dhe nga Lumi Kura deri në Malin Savalan ose Sabaghan. Qyteti i banimit të Bardosit quhej Barda; megjithatë, Vardasheni bashkë me vendbanime dhe qytete të tjera e morën emrin po ashtu nga Bardi. Bardosi themeloi një qytet në perëndim të bregut të Lumit Kur dhe e quajti atë Barda. Lumi e mori emrin Kur ose Kura (gjithashtu njihej si Qur ose Qura) që do të thotë “Tokë” ose “Vendbanim” (që ka kuptimin “Qytet”) në gjuhët Sumeriane, Asiriane dhe Hurro-Urartiane, pasi Torgomianët e konsideronin atë të ishte motra e Lumit Araks dhe ndërtuan shumë vendbanime përgjatë Lumit Kura. Lumenjtë siguronin peshkimin, ujësin tokat, ndihmonin në udhëtimin e njerëzve, dhe ndihmonin këmbimet dhe tregtinë. Vardasheni, një qytet në Krahinën Utik, mund të jetë gjithashtu një vendbanim i ndërtuar nga pasardhësit e Bardosit. Gardaban, djali i Kartlosit, dhe Khagh ose Khal, djali i Movkanit, u martuan me bijat e Bardosit.

\* \* \*

## Pasardhësit e Movkanit

**Movakos** në Greqisht, ose **Movkan** (gjithashtu i njohur si Moughan ose Movakan) në gjuhën Ariane, ishte djali i katërt i Torgomit. Ai përfitoi gjysmën e asaj, që kishte mbetur nga tokat e Torgomit pas ndarjes së pjesëve për trashëgimitë e vëllezërve të tij më të mëdhenj. Tokat e Movkanit ndodheshin midis tokave në lindje të Lumit Kura, ku lumenjtë Iora dhe Alazan bashkohen duke formuar një liqen të quajtur Liqeni Mairoi, deri në Detin Lindor ose Detin Kaspik, duke përfshirë tokat ku lumenjtë Kura dhe Araks bashkoheshin në (Movakan Dasht) Movkan ose Fushën Mugane. Movkani njihej gjithashtu si Mougani ose Movakan. Movkani ose Mougani ishte babai i popullit Mughan të Fushës Mughane, si dhe të shumë fiseve të afërt më popujt Mughan, Khakhal, Kaspian, dhe Nakh, të cilët jetonin në perëndim dhe jug të Detit Kaspik.

**Khagh** ose **Khal**, djali i Movkanit, ishte babai i popullit Khalkhal ose Qalqal (Gargarian, aktualisht Ingush). Ata jetonin në moçalet ku lumenjtë Araks dhe Kura bashkoheshin.

**Gegh** ose **Gel**, një pasardhës i Movkanit, u martua me Geghamin ose Gelamin, një pasardhëse e Hajkut. Gegham do të thotë gruaja e Geghut ose Znj. Gegh. Geghard dhe Gegharkunik në Armeni dhe Geghajn ose Gelam në Persi i morën emrat nga Geghu. Geghajn ose Gelam ishin toka midis Maleve Talish dhe Detit Kaspik në Persi. Gel dhe Gelam ishin paraardhës të popullit Gelian në Arran-Albania.

**Kaspi**, një pasardhës i Movkanit, ishte babai i popullit Kasp dhe Kaspianë. Ata jetonin në tokat në perëndim dhe jug të Detit Kaspik. Deti Kaspik e mori emrin nga Kaspi.

\* \* \*

## Pasardhësit e Lekanit

**Lekos** në Greqisht, ose **Lekan** në gjuhën Ariane, ishte djali i pestë i Torgomit. Ai mori gjysmën e asaj që kishte mbetur nga tokat e Torgomit pas marrjes së pjesëve përkatëse të trashëgimisë nga vëllezërit më të mëdhenj. Tokat e Lekanit shtriheshin nga lindja e Maleve të Kaukazit deri në verilindje të brigjeve të Detit të Lindjes ose Detit Kaspik. Lekani dhe pasardhësit e tij ishin baballarët e popullit Lezg ose **Lezgin**, popullit **Cez**, popullit Andik ose **Antes**, të cilët jetonin në tokat ndërmjet Maleve të Kaukazit Lindor dhe Detit të Lindjes ose Detit Kaspik, të popullit **Udi**, i cili banonte në të dy anët e Lumit Kur ose Kura, si edhe popuj të tjerë të afërm me ta.

**Lak** besohet të jetë një tjetër emër për Lekanin ose është një pasardhës i Lekanit. Populli Lak fliste një gjuhë, që ishte pjesë e Gjuhëve të Kaukazit Lindor. Vendi i tyre ka pasë qenë njohur si Lakia ose Lakistan. Ata u pushtuan prej Persianëve, Romakëve, Greko-Bizantinëve, Hunëve, Arabëve, Turqve Khazarë, Tatarëve-Mongolë dhe prej Ruisë, e cila ka influencuar mbi kulturën e tyre dhe e ka ndryshuar gjuhën e tyre origjinale.

\* \* \*

## Pasardhësit e Heranit

**Heros** në Greqisht, ose **Heran** në gjuhën Ariane, ishte djali i gjashtë i Torgomit. Ai mori gjysmën e asaj, që kishte mbetur nga tokat e Torgomit pas marrjes së pjesëve përkatëse të trashëgimisë nga vëllezërit më të mëdhenj. Tokat e Herosit ndodheshin në lindje të tokave të Kartlosit, në veri të tokave të Bardlosit, në perëndim të tokave të Lekanit, dhe ka kufi me tokat e Movkanit, pikërisht ku

lumenjtë Iora dhe Alazan bashkohen me Lumin Kur duke formuar një liqen të quajtur Liqeni Majroi; sidoqoftë, Heros dhe pasardhësit e tij më vonë lëvizën në drejtim të tokave në veri dhe lindje të Liqenit Kaputan ose Liqenit Urmia. Vendqëndrimi i Herosit ka qenë emërtuar Her, sipas emrit të tij. Heros (versioni Greqisht i emrit) ose Heran (version në gjuhën Ariane i emrit) zotëronte tokat në verilindje të Liqenit Kaputan ose Urmia dhe i emërtoi ato Her. Heros dhe pasardhësit e tij ishin baballarët e fisnikëve Herheruni dhe të popullit Hereti. Heran dhe pasardhësit e tij i zgjeruan tokat e tyre në drejtim të lindjes së maleve Alborz dhe themeluan **Ti-Hiran** ose **Teheran**.

\* \* \*

### Pasardhësit e Kaukazit

**Kaukaz** në Greqisht, ose **Kaukan** në gjuhën Ariane, (Kaukazi quhet, gjithashtu, edhe Kavkaz ose Kaskas prej shumë historianëve) ishte djali i shtatë i Torgomit. Ai njihet, gjithashtu, edhe si Ovkhas ose Obkhaz. Ai mori gjysmën e asaj, që kishte mbetur nga tokat e Torgomit pas marrjes së pjesëve përkatëse të trashëgimisë nga vëllezërit më të mëdhenj. Tokat e Kaukazit ishin ato, që ndodhen në perëndim të Maleve të Kaukazit dhe pranë Detit të Perëndimit ose Detit të Zi. Vendqëndrimi i Kaukazit u quajt Kaukasos.

\* \* \*

### Pasardhësit e Egros

**Egros** në Greqisht shpesh lidhet me Ajar në gjuhën Ariane. Egros ishte djali i tetë i Torgomit. Ai mori atë, që kishte mbetur nga tokat e Torgomit pas marrjes së pjesëve përkatëse të trashëgimisë nga vëllezërit më të mëdhenj. Tokat e Egros ishin tokat që ndodheshin

ndërmjet Maleve Likhi dhe Detit të Perëndimit ose Detit të Zi. Vendqëndrimi i Egros u quajt Egris. Egros dhe pasardhësit e tij ishin baballarët e popullit Axhar të Axharisë. Egrosi ndërtoi një qytet si vendqëndrim të tij, të cilit i vuri emrin Egrisi. Ekziston një teori, sipas së cilës, pasi mundi Belin, Hajku i dha toka të reja Egrosit dhe ato toka u emërtuan Sa-Egros ose Zagros; pra, ka mundësi që Malet Zagros ta kenë marrë këtë emër prej Egrosit.

**Laz** nënkupton “Njerëz” në gjuhën Axhariane. Sipas Robert Ellis, populli Laz ka qenë një degë e popullit Gargarean, të cilët ishin të afërm me Axharët. Gargareanët ishin një popull me vetëm meshkuj dhe për riprodhim vareshin prej popullit Amazon, të cilët, gjithashtu, ishin një popull me vetëm femra. Si Amazonët edhe Gargareanët ishin popuj të racës Ariane dhe jetonin në Anatinë Lindore. Ata luftuan së bashku me Trojanët kundër Grekëve. Gjatë luftës së Trojës, Paflagonët, Gargareanët dhe Amazonët, si edhe Armenët dhe Frigët, Thrakasit dhe **Palasgianët**, si edhe Arianë të tjerë luftuan përkrah Trojanëve kundër Grekëve Akeanë (Akej), Spartanëve dhe Grekëve të tjerë. Lumi Gargar ndodhet ndërmjet Arcakhut dhe vendit ku bashkohet Lumi Kura me Lumin Araks, dhe tokat e kësaj zone kanë marrë emrin Gargark për shkak të Gargareanëve. Gargarku njihet, gjithashtu, si Khalkhal në historinë e Persisë dhe të Armenisë.

\* \* \*

## Pasardhësit e Mesheçit, Gogut, dhe të Tjerë

**Mesheçi** ishte babai i popullit Muski ose Mushki, që i ndërtoi vendbanimet e tij përgjatë Lumit Aratzani (Lumi Arsanias). Vendbanimet e ndërtuara prej Mesheçit dhe popullit Muski ishin Mokq ose Moksoene, Mush, Moskia dhe Mesksi ose Meskhet. James Robert Rusell, studjues dhe profesor në sektorin e Studimit të Gjuhëve dhe Civilizimeve të Lindjes së Afërme të Lashtë, Iranit dhe Armenisë në Universitetin e Harvardit pohon se përcaktimi

Gjeorgjian për Armenët është Somekhi (Someçi). Sipas studjuesve të sotëm Gjeorgjianë dhe disa historianëve Grekë emri Metskhe ose Mskhetos (Mskhetos ishte djali i Kartlosit) është, gjithashtu, i lidhur me Mesheç, paraardhësi i popullit Muski ose Mushki. Flavio Josifi (Flavius Josephus) ka identifikuar Mosoçeninë, një tribu Kappadokase, me Mesheçin. Ilirët identifikohen si pasardhës të Mesheçit në një kronikë të shkruajtur nga Hipoliti (Hippolytus) i Romës.

**Shibashni** ishte djali i Mesheçit (shih librin “Libri i Xhasherit”, Kreu 10) dhe qyteti Sebastia ose Sivas e ka marrë emrin prej tij. Sebastia u bë kryeqyteti i Armenisë së Vogël.

**Mush** (gjithashtu, Mus ose Muk dhe Mok ose Moc) ishin pasardhës të Mesheçit. Mush dhe Moksoene ose Moks e kanë marrë emrin prej tij.

\* \* \*

**Gog** ishte djali i Magogut, dhe pasardhësit e tij ndërtuan vendbanimet e tyre në Gorgarene ose Gugark. Provinca Armene e Gugarkut përfshinte Xhavahkun, Kangarkun, Tashirin, Bambakun, Kajenkun, Gogun ose Gagun, dhe Curtavin. Curtav është një variant i Curt, që në gjuhën Armene do të thotë “ftohtë”, dhe Curtav ose Curtets, në varësi të dialektit, nënkupton “me marrë të ftohtë”. Gogledd nënkupton “Veri” në gjuhën Uellsiane, dhe fjala “vendet Gog” ka lidhje me veriun.

\* \* \*

**Susi**, në gjuhën Urartiane, nënkupton Fortifikatë. Kur Bel Nimrodi pushtoi Susan dhe qytet-shtete të tjera në Mesopotami, shumë popuj gjetën strehim në Mbretërinë e Hajkut. Refugjatët,

që erdhën prej Susas, ndërtuan vendbanime në tokat e Bardos. Një prej këtyre vendbanimeve u quajt Susa ose Shusha. Shusha (Shusha quhet, gjithashtu, edhe Shushi, që është një variant i Susi) është një qytet i madh në Provincën Armene të Arcakhut.

\* \* \*

**Urtsa** (Urca) ose fisnikët Ur-Sa e kanë marrë këtë emër prej Malit Urtsa dhe jetuan në pronën Urtsa, e cila është e vendosur në lindje të Qytetit të Artaksatit të Provincës së Araratit. Urtsa e ka marrë këtë emër prej popullit Ur ose Uruk, i cili shpëtoi prej Bel Nimrodit dhe gjeti strehim në Mbretërinë e Hajkut.

\* \* \*

Fisnikët **Alarodianë** (gjithashtu, Alar-Otian ose Alar-Udian) janë një degë e popullit Udi. Qyteti i qëndrimit të fisnikëve Alarodianë quhej Dalar (Da-Alar ose De-Alar) që nënkupton “prej Alar/Alarod, dhe ndodhej atje ku Lumi Dalar (Lumi Dalar është një degë furnizuese e Lumit Aratsani) bashkohet me Lumin Arsanias. Ndonëse shumë studjues përpiqen t’i paraqesin Alarodianët si Popull i Kaukazit Verior, George Rawlinson, Michael Herzfeld dhe studjues të tjerë i vendosin Alarodianët në zonën e Lumit Arsanias (Aratsani) dhe ndërmjet tribuve të Mbretërisë Urartu. Ksenofoni, Herodoti dhe historianë të tjerë kanë shkruajtur rreth Alarodianëve dhe tribuve të tjera Urartiane, Ariane dhe Armene.

\* \* \*

Fisnikët **Burbur** u vendosën në Aragatson dhe Bjurakani e mori emrin prej tyre. Dinastia Burbur e Shinarit u rrëzua prej Kushitëve, kur Kushi dhe ushtritë e tij pushtuan Babiloninë. Herodoti dhe George Rawlinson pohojnë, se fisnikët e Dinastisë Burbur ishin të lidhur me fisnikët Alarodianë të Armenisë. Me shumë mundësi lidhjet e tyre kanë qenë rezultat i martesave.

\* \* \*

**Udi** ose Uti quhet populli i Provincës së Utikut ose Otene të Urartusë dhe Armenisë. Fisnikët Otianë të Armenisë janë pasardhës të popullit Udi.

# FJALOR

## A

Abel - është Abeli Biblik, djali i Adamit dhe Evës

Abidenus – ishte historian Grek

Adama nënkupton “gjak” në gjuhën Sumeriane dhe Adamu nënkupton “gjak” në gjuhën Akkadiane

Aghbak ose Albak, ka qenë quajtur, gjithashtu, Ba'alBak dhe Ael-Bak (El-Bak) prej Assirianëve dhe Babilonasve, që nënkupton Kopshti i Zotit ose Perëndisë.

Alarodianët ishin një degë e popullit Otian (Otene) ose Udi (Utik), dhe një prej tribuve kryesore të perandorisë Urartu

Ar ishte Dielli-Zot për Arianët

Ara nënkupton “I Shenjtë” ose “Hyjnor” në gjuhën Ariane

Aramaneak (Aramaneak në gjuhën Armene është thirrur si Armen ose Armenak) ishte djali i Hajkut

Ararat është mali ku qëndroi Arka e Noes

Araza ishte vajza e Noes Biblik. Araza ishte nëna e Skitës ose Skithës dhe e Bretonit

Lumi Araz dhe Lumi Aratsan (Arzانيا) e kanë marrë emrin prej Arazës

Arba nënkupton “Katër” në gjuhët Babilonase dhe Hebreje  
Arnoi ose Arrn-Noi, në gjuhën Armene, fjalë për fjalë do të thotë  
“Marrë nga Noeja”

Artaksata ose Artashat ishte kryeqyteti i Mbretërisë Armene të  
Mbretërve Artashianë

Mali Artos ndodhej në juglindje të Liqenit Van në Distriktin Hajoc  
Cor të Provincës së Vaspurakanit në Armeni

Askanaz ishte vëllai i Torgomit dhe Rifatit

Astghik ose Astlik ishte vajza e Noes Biblik. Në gjuhën Armene,  
Astghik do të thotë “Yll”, dhe ajo ka pasë qenë njohur si “Astraea”  
nga historianët Grekë. Lumi Aghstev e ka marrë emrin prej  
Astghikut

Astiexhis ose Azhi-Dahakes ishte mbreti i Medëve Azhi. Ai ka pasë  
qenë njohur si Azhdahak në historinë Armene

Azhi nënkupton “gjarpër” në gjuhët Ariane.

Azura ose Azure ishte vajza e Adamit dhe Evës Biblike. Sipas Librit  
të Ngjarjeve, ajo ishte gruaja e Sethit Biblik

Azure quhej, gjithashtu, edhe Azur ose Azura, që do të thotë Blu,  
Qjell në gjuhët Persiane, Arabike dhe ato Latine, dhe ai ishte  
emri i vjetër i Liqenit Urmia

## B

Ba'al ose Bel (El) nënkupton Zot ose Perëndi në gjuhët Babilonase  
dhe Assiriane

Bab-Bel ose Bab-bili nënkupton Bel Bab ose Zoti (Perëndia) Bab,  
një nga djemtë e Nimrodit Biblik

Babili (Babilonia) është përkthyer si “Porta e Zotit” prej disa  
studjuesve

Bak nënkupton “Kopësht” në gjuhën Armene

Bar nënkupton “Jashtë, I huaj” në gjuhën Sumeriane dhe Hurro-Urartiane

Bardos ose Bardan (Vardan) ishte vëllai i Hajkut; vendbanimet e quajtura Barda dhe Vardashen në Provincën e Arran-Utikut e kanë marrë emrin prej Bardosit

Baz ishte djali i Manavazit dhe nipi i Hajkut; Bazi ishte paraardhësi i fisnikëve Bznuni në Distriktin Bznunik pranë Liqenit Van

Bazporakan ka qenë emri fillestar i Vaspurakanit, dhe e kishte marrë këtë emër prej Bazit, nipit të Hajkut

Bel nënkupton “Zot” në gjuhët Assiriane dhe Babilonase. Bel Nimrod ka qenë njohur si “Bilu Nipru” në Babiloni

Berossus ka qenë një historian i lashtë me prejardhje nga Babilonia, i cili ka shkruajtur në gjuhën Greke.

## C (K)

Kaini ishte Kaini Biblik, djali i Adamit dhe Evës

Katolikos ose Katoghikos është titulli më i lartë në Kishën Apostolike Armene

Kaukaz (Kavkaz) ose Kaukan ishte vëllai i Hajkut; Kaukazi ishte paraardhësi i popullit Abkhaz dhe i popujve të tjerë të afërm me ta; Malet Kaukaze e kanë marrë emrin prej tij

Kush ose Cush (Vendi) është vendosur në jug të Egjiptit, dhe e ka marrë emrin prej Kushit Biblik

Kush ose Cush është emri i Kushit Biblik. Kushi ishte babai i Nimrodit, i cili ishte mbret i Babilonisë, i popullit Seba ose Sheba, i cili banonte në Etiopinë Qendrore dhe ishte pasardhës i Sebas. Havilah ishte babai i popullit, që jetonte në tokat në Afrikën Verilindore. Populli Sabtah ose Savtah, i cili jetonte në tokat, që ndodheshin në skajin jugperëndimor të Gadishullit Arabik, ishte pasardhës i Sabtahut. Populli Raamah ose Ra'mah, i cili banonte

në verilindje të Sabtahut, në Gadishullin Arabik, ishte pasardhës i Raamah. Populli Sabtekah ose Savtekha, i cili jetonte në bregun juglindor të Afrikës, ishte pasardhës i Sabtekahut. Dedan, një pasardhës i Kushit ishte mbret i Dedanit, i cili ishte i vendosur në verilindje të Detit të Kuq.

## D

Da ose De nënkupton “Prej, Nga” në Protogjuhë, e cila mbijetoi në gjuhën Latine dhe Angleze

Djutcazun prej Dju-t ose div nënkupton “Divine, Hyjnore” dhe Sazun nënkupton “vijë-Gjaku” në gjuhët Hurro-Urartiane

Dzor (Cor) nënkupton “një Grykë” ose “Luginë e Vogël” në gjuhën Armene

Deiokes, paraardhësi i Astiaxhes ose Azhi-Dahakes; ai i organizoi tributë Madaiane në një komb të vetëm

Di nënkupton “Dy” në gjuhën Greke

## E

Egrosi ishte vëllai i Hajkut dhe paraardhësi i popullit Laz

El ose Eli nënkupton Zot dhe Bab-Ili ose Bab-Eli nënkupton “Porta e Zotit” në gjuhën Babilonase

Etruria ka qenë quajtur, gjithashtu, Tirrhënia sipas Tirrhenusit, që ishte një pasardhës i Tirasit

## G

Gal ose Gagh në gjuhën Cimmeriane (Kimmeriane), Sumeriane dhe Hurro-Urartiane është njëlloj si Gah në gjuhën Persiane ose Armene, që do të thotë “Fron”

Gardabos ose Gardaban, djali i Kartlosit, ishte babai i popullit Gardman; ai mund të ketë qenë i afërm, gjithashtu, me Bardosin dhe pasardhësit e tij nëpërmjet martesave për të zotëruar tokat e Gardmanit

Ghevond Alishani ka qenë historian Armen

Gog është emri i Gogut Biblik

Gugark ose Gogarene ishte emri i vendbanimit, ku jetuan pasardhësit e Gogut

Gom është njëlloj si Gomer ose Gamir

Gomer ishte djali i Xhafetit dhe nipi i Noes

Gin nënkupton “Grua” dhe Ginajk nënkupton Gra” në gjuhën Greke; Kin nënkupton “Grua” në gjuhën Armene; Kinu nënkupton “e përligjur” në gjuhën Babilonase

Gymri ose Gumri është qytet në Armeni

## H

Halis ose Alis ishte vajza e Rifatit; Halis ishte gruaja e Feneçit dhe nënë e Paflagonit

Lumi Halis në Azinë e Vogël e ka marrë emrin prej Halisit

Ham Titani ose Kham ishte emri i Hamit Biblik

Hamshen ose Ham-Shen në gjuhën Armen nënkupton “Ndërtuar prej Hamit”

Hand nënkupton “Kopësht” në gjuhën Perse dhe Hurro-Urartiane

Hajk ishte paraardhësi i popullit Armen

Hents ose Henc në gjuhën Armene nënkupton “që këtej, prandaj, kështu që)

Her (Heran) ose Heros ishte vëllai i Hajkut; Herosi ishte paraardhësi i fisnikëve Heruni ose Herheruni

Herodoti (Herodotus) ishte historian Grek

Hurrianët ishin një popull i lashtë, që jetonte në Azinë e Vogël dhe në tokat në veri të Mesopotamisë

Hurro-Urartian ishte një gjuhë e lashtë e Mbretërisë Armene të Urartu-së (Araratit)

## I

Iapheth ose Japheth, Xhafet, Xhabet është i njëjti me Xhafetin Biblik Ibi nënkupton “Tym” (me shumë gjasa Kulti i Zjarrit) në gjuhën Sumeriane dhe Hurro-Urartiane

Idigina nënkupton “Uji i Madh” ose “Lumi i Rrëmbyer” në gjuhën Sumeriane, dhe është emri i lashtë i Lumit Tigër

Ionton ose Jonton është konsideruar djali i katërt i Noes; megjithatë, ai ishte dhëndri i Noes

Ishair ishte Distrikti i Moksit ose Provinca Moksoene e Mbretërisë Armene

Ishuva ishte një mbretëri Hurriane dhe Milidi, kryeqyteti i Ishuvas, ishte njëlloj si Malatia e Armenisë së lashtë

## J (Xh)

Japheth (Xhabet, Xhafet, Jafet) Oste është emri i Xhafetit Biblik

Juanshir (Xhuanshir, Xhanshir, Xhuansher, Jasher - përdorur sipas autorëve të ndryshëm) ishte një mbret Iberian (Iberia Kaukaziane) dhe historian me prejardhje Ariane ose Persiane

## K

Kadmos ose Cadmus ishte djali i Aramaneakut dhe nipi i Hajkut; Kadmos ose Cadmus ishte paraardhësi i fisnikëve Kadmeanë ose Cadmeanë

Kakhos ishte djali i Kartlosit; Kakhosi ishte paraardhësi i popullit Kakheti

Kaj (Qaj) ose Gaj ishte djali i Kartlosit; Kaj ishte paraardhësi fisnikëve Armenë Kajberuni ose Qajberuni

Kartlos ose Kar ishte vëllai i Hajkut; Kartlos ishte paraardhësi i popullit Kartli (Për më tepër informacion rreth Kartlosit dhe pasardhësve të tij shih seksionin: “Populli Armen dhe popujt e afërt me të” të këtij libri)

Karen ishte titull ose gradë, që kishte kuptimin Komandant ose Udhëheqës Ushtarak në Gjuhët Ariane

Katoghikos ose Katolikos është titulli më i lartë i Kishës Apostolike Armene

Kajen ose Kain është i njëjti me Kainin Biblik; Distrikti Kajenk ndodhet në veri të Lumit Aghstev, pranë Liqenit Sevan

Ketsan ose Kets ka kuptimin “I Qëndrueshëm, I Fortë” në gjuhën Armene dhe Lumi Ketsan është një nga degët furnizuese të Lumit Xherm (Jerm) dhe të dy së bashku janë degë furnizuese të Lumit Tigër

Kham është emri i Hamit Biblik

Khor ose Khur ishte djali i Hajkut; Khor ose Khur është paraardhësi i fisnikëve Khorkhoruni dhe i popullit Khurrit

Khurritët janë të njëjtë me popullin Hurrian sipas disa burimeve shkrimore , të cilat unë i kam listuar në seksionin “Bibliografi” të këtij libri

Lumi Khoshav ose Khosab (Hosap në gjuhën Kurde) ka kuptimin “Ujë i Mirë” në gjuhën Persiane dhe Hurro-Urartiane

Kin ka kuptimin “Grua” në gjuhën Armene; Gine ka kuptimin “Grua” dhe Ginajk ka kuptimin “Gra” në gjuhën Greke

Kinu ka kuptimin “E Ligjëruar” në gjuhën Babilonase

Koghkis ose (Koghk) Kolç ishte djali i Kartlosit; Kolç ishte paraardhësi i popullit Kolçis ose Kolkhida

Kuh-e-Kush ka kuptimin Malet Kush në gjuhën Persiane

Kuh-e-Nuh ka kuptimin Malet e Noes në gjuhën Persiane

KUR ose (k)Ur do të thotë “Tokë, Vend” në gjuhët Cimmeriane (Kimmeriane), Sumeriane dhe Hurro-Urartiane

Kush ose Cush është emri i Kushit (Cushit) Biblik

Kushania ose Indu-Kush gjendet ndërmjet Persisë dhe Indisë, dhe Kushanët ishin aleatë të Hunëve dhe armiq të Persisë Sassanide

## L

Lekan ose Lekos ishte vëllai i Hajkut; Lekani ishte paraardhësi i popullit Lezgian

Leonoti ishte Oficeri Komandues (Gjeneral) i ushtrisë së Nimrodit

Lisun në gjuhën Babilonase ose Lezu (Lezuner – në shumës) do të thotë “gjuhë” në gjuhën Armene

Lu nënkupton Person ose Njeri (Njerëz) në gjuhë Sumeriane dhe atë Hurro-Urartiane

Lu-Bar nënkupton Popull i Jashtëm (Popull jashtë Arkës) në gjuhën Sumeriane dhe Hurro-Urartiane

Lugal do të thotë “Mbret”; formohet prej Lu-Person dhe Gal ose Gagh në gjuhët Cimmeriane, Sumeriane dhe Hurro-Urartiane, njëlloj si Gagh në gjuhën Persiane dhe atë Armene, që ka kuptimin “Fron”

Lulubi ose Lullubi nënkupton “Adhures të Zjarrit”; formohet nga Lu, që do të thotë “Person” në gjuhën Sumeriane dhe Hurro-Urartiane dhe nga Ibi, që do të thotë “Tym” (me shumë gjasa Kulti i Zjarrit) në gjuhën Sumeriane dhe Hurro-Urartiane

Lusine ose Lu-Sine ka kuptimin Person i Perëndisë ose Adhures i Perëndisë

## M

Manavaz ishte djali i Hajkut; ai ishte paraardhësi i fisnikëve Manavazianë

Maneton ose Maniton ishte paraardhësi i popullit Mannaeen

Mannaeenët kanë qenë njohur edhe si Mannai nga Akkadianët

Manu ose Manuk ishte Officer Komandues (Gjenerali) i ushtrisë së Manitonit

Mar Abas Katina ishte një historian i lashtë; në historinë Armene ka pasë qenë njohur si Maribasa

Populli Mar ose Mari jetonte në Marastan; Populli Mar ose Mari ka qenë popull proto-Armen

Mesheç është emri i Mesheçit Biblik

Metskhe ose Metskhetha, djali i Kartlosit, ishte babai i popullit Mtskheti të Sa-Mtskhe, që do të thotë “Toka e Metskhetha” ose “Toka e Gardhit të Madh”. Sipas studjuesve të sotëm Gjeorgjianë dhe disa historianëve Grekë emri Metskhe ose Mskhetos (Mskhetos ishte djali i Kartlosit) është, gjithashtu, i lidhur me Mesheç, paraardhësi i popullit Muski ose Mushki. James Robert Rusell, studjues dhe profesor në sektorin e Studimit të Gjuhëve dhe Civilizimeve të Lindjes së Afërme të Lashtë, Iranit dhe Armenisë në Universitetin e Harvardit pohon, se përcaktimi Gjeorgjian për Armenët është Somekhi. Somekhi dhe Samtskhe janë fjalë të lidhura gjuhësisht.

Mia ka kuptimin “Ujë” në gjuhën Arabe dhe atë Siriake

Milid ishte kryeqyteti i Ishua

Milid ose Melitene ishte emri i lashtë për Qytetin Malatia

Mitanni ishte një mbretëri Hurriane.

Mizraim ishte i njëjtë me Mizraimin Biblik; Mizraimi ishte paraardhës i Egjiptianëve të lashtë ose Hamitikë

Malet Mokate e morën emrin nga Moku ose Muku, një pasardhës i Mesheçit, i cili ishte në krye të fisit të popullit Mushki në Moks Movkani (Muugan ose Mughan) ose Movakani ishte vëllai i Hajkut; fusha Mughane ose Movakane e mori emrin nga ai

## N

Nairi ose Noi-ri do të thotë “Njerëzit e Noes” në gjuhën Anatoliane Navasardi ose Nauazardi do të thotë “Dekorata të Reja; Medaljet e reja”, dhe shenjonte Vitin e Ri Armen

Lojrat e Navasardit ishin lojra konkurruese, dedikuar kthimit në shtëpi të Hajkut dhe festimit të Vitit të Ri Armen

Nibrodi ose Nebroti ishte një tjetër emër për Nimrodin Biblik, dhe Grekët e adaptuan këtë emër nga Egjiptianët në formën Nimrod

Nihor ose Nehur ishte vjehri i nipit të Hajkut, Kadmosit

Malet Nihorakan (Koh-i-Nihorakan në gjuhën Persiane) ishin një vargmal që ndodhej ndërmjet Liqenit Van dhe Liqenit Urmia, dhe shenjonte kufirin midis Distriktit Kartunik të Krahinës Korçajk dhe Distriktit Tamber të Krahinës Parskehajk të Mbretërisë Armene

Nimrod ose Bel Nimrod ishte emri i Nimrodit Biblik. Sipas Moisi Khorenacit, Nimrodi kishte një djalë të quajtur Bab. Sër H. Rawlinson dhe historianë të tjerë pohojnë, se Belusi ishte djali i Nimrodit. Berossus-i shkroi, se Belusi ishte i njëjtë me Nimrodin dhe ishte mbreti i parë i Babilonisë. Sipas Legjendës Hungareze të Drerit të Bardhë, Nimrodi ishte babai i Hunorit dhe Maxhorit, të cilët u bënë paraardhësit e Hunëve dhe Maxharëve. Libri i Ngjarjeve (Ngjarja e tridhjetë e dytë) deklaroi se Nebrodi ose Nimrodi ishte babai i Azuradit, dhe Azuradi më pas u bë mamaja e Pelegut. Pelegu ishte një paraardhës i Abrahamit; ndaj, Nimrodi ishte paraardhës i Abrahamit. Libri i Xhasherit tregon se Nimrodi

kishte një djalë të quajtur Maridon dhe një vajzë të quajtur Zehila, dhe se si Abrahami vrau Nimrodin; megjithatë, kjo do të ishte e pamundur, pasi Nimrodi ishte gjenerata e katërt e Noes dhe Hamit, ndërsa Abrahami ishte gjenerata e njëmbëdhjetë, dhe ka fakte të tjera, që provojnë se Nimrodi nuk luftoi kurrë kundër Abrahamit

Noe (Noe Biblik) gjithashtu i njohur si Ksisuthros ose Ziusudra nga Grekët dhe Mesopotamët, si nofkë duke qenë se mbijetoi Përmbytjen

## O

Oste ose Osto do të thotë “Kockë” në gjuhën Greke. Xhafet Oste (Japheth Oste, Xhafet Oste) ishte emri i Xhafetit Biblik si një nofkë, pasi ai ishte Kockëmadh.

## P

Paflagoni ishte djali i Fenekut dhe Halisit, dhe nipi i Rifatit; Paflagoni ishte paraardhësi i Paflagonëve

Parisp në Armenisht do të thotë “Fortifikatë”. Parisi mund të jetë nisur si një fortesë

Parisos ose Paris-Sos ishte një distrikt Armeni i ndodhur në lindje të Liqenit Sevan dhe në veri të Arcakhut

Pashat ose Mali Pshat ndodhej në juglindje të Liqenit Van në Distriktin Hajoc Dzor

Feneç (Phennech) ka qenë njohur gjithashtu si Fineus nga Grekët dhe Romakët; Feneçi ishte paraardhësi i Fenikasve dhe qyteti i banimit të tij ishte Tiri

Proto do të thotë “i pari” në Greqisht; Protogjuha do të thotë “Gjuha e Parë”

Purattu ishte emri i lashtë i Lumit Euftrat

## R

Fisnikët Remposianë ishin një degëzim i fisnikëve Heruni, dhe fisnikët Heruni ishin pasardhës të Herosit

Rifati ishte vëllai i Torgomit dhe Askanazit

Fisnikët Rshtuni të Rshtunikut vinin nga Mbreti Rusas I i Urartusë, dhe Rusas I i Urartusë ishte një pasardhës i Kadmosit

## S

Sa ose Za do të thotë “Gur” në gjuhën Sumeriane dhe Hurro-Urartiane  
Sahand – Sa do të thotë “Tokë” dhe Hand do të thotë “Kopësht” në gjuhët Perse dhe Hurro-Urartiane

Samtskhe ose Sa-Mets-khe(ta) do të thotë “Toka e Khetës së Madh” në gjuhën Hurro-Urartiane

Sazun do të thotë “linjë gjaku” në gjuhën Hurro-Urartiane

Sem Zrvan ishte emri i Semit Biblik

Sem-Sar ose Sim-Sar do të thotë “Mali i Semit” (Semi Biblik) në gjuhën Armene

Setk i njohur gjithashtu si Sodk. Ishte Toka e Sethit Biblik në historinë Armene

Shna, Sna, Sin, Sini, Sine, Sina, dhe Sena, që do të thotë Zot, Perëndi ose Hyjni, ishte perëndia ose perëndesha e fertilitetit, lindjes dhe krijimit; Sine ishte një perëndi ose perëndeshë Hënë

## T

Tauruberan ose Turuberan ishte një provincë e Urartusë dhe Armenisë

Lumi Terek në Kaukaze fillon në Malet Kazbek dhe derdhet në Detin Kaspik

Thraka ndodhej në juglindje të Europës, ndërmjet Ballkanit dhe Azisë së Vogël

Tir ose Tiras nënkupton Tirasin Biblik

Titanët në Mitologji janë zotër të fuqishëm; ata janë pasardhës (fëmijë) të Tokës dhe Qjellit. Përcaktimin e fjalës Titan e gjeni tek [www.dictionary.com](http://www.dictionary.com) – Titani është një person ose gjë me përmasa shumë të mëdha, fuqi, forcë, ndikim shumë të madh, etj.

Tor ka kuptimin “nip” në gjuhën Armene dhe ato Ariane

Togarmah, quhej gjithashtu edhe Torgom ose Tor-Gom nënkupton ”Nip i Gomerit Biblik” në gjuhën Armene dhe ato Ariane; Torgom përbëhet nga Tor – që nënkupton “nip” në gjuhët Armene dhe Ariane dhe nga Gom që është i njëjti me Gomerin ose Gamirin.

Tyrrhenia (Tyrrhenia ka qenë quajtur, gjithashtu, edhe Etruria) e ka marrë emrin nga Tyrrhenus, një pasardhës i Tirasit

## U

Udi ose Uti quhej populli i Provincës së Utikut ose Otenes të Urartusë dhe Armenisë

Ur nënkupton Tokë (Vend) në gjuhët Cimmeriane, Sumeriane dhe Hurro-Urartiane

Urmia ose Ur-Mia nënkupton Ur-Tokë dhe Mia-Ujë në gjuhët Arabe dhe Siriake

Uru nënkupton Tokë (Vend) me shumë qytete; në gjuhët Cimmeriane, Sumeriane dhe Hurro-Urartiane ajo nënkupton një “Shtet”

Ut ose Ud ka kuptimin “Ditë” në gjuhën Hurro-Urartiane

Uti nënkupton “Të Ngrënë, Të hash” ose “të përfitosh prej tokës” në gjuhën Urartiane.

Utikune ose Udikune nënkupton “Guvernator, Qeveritar” në gjuhën Urartiane.

## V

Vagharshak ose Valarsakes ishte një mbret Armen me prejardhje Parthe

Fisnikët Varazhnuni ose Varajnuni e kanë prejardhjen prej Varazhit, djalit të Garnikut dhe nip i Sisak Hajkazunit

## X (Ks)

Ksenofanes i Kolofonit ishte një historian Grek

Ksithutros ishte një prej emrave të Noes, që përdorej nga Grekët si nofkë ose mbiemër, për të treguar të mbijetuarit e Përmbytjes

## Z

Za ose Sa nënkupton “Gur” ose “Shkëmb” në gjuhët Sumeriane dhe Hurro-Urartiane

Zil nënkupton “i/e Fortë” në gjuhët Sumeriane dhe Hurro-Urartiane; në gjuhën Armene do të thotë “i/e Fortë”

Ziusudra ishte një prej emrave të Noes, që përdorej nga popujt Mesopotamianë si nofkë ose mbiemër, për të treguar të mbijetuarit e Përmbytjes

Zrvan ose Zeru (Zero) nënkupton “Farë, Bërthamë” në gjuhën Assiriane dhe Van nënkupton Liqeni Van. Farat e Sesamit origjinalisht kanë pasë qenë quajtur Semsem. Sem Zrvan ishte emri i Semit Biblik

## BIBLIOGRAFI

- Armenia përpara se të bëhej Armeni, prej Ghevond Alishan, botuar në vitin 1904, në Venetia
- Historia e Armenisë, prej Moisi Korenacit, botuar në vitin 1913, në Tbilisi
- Qytetërimi Urartian dhe Probleme të Origjinave Baske, prej Vahan Sarkisian, botuar në vitin 1998, në Erevan
- Mitologjia Armene, kapitulli 10, Pjesa 1, prej Mardiros Harutiun Ananikian, botuar në vitin 2010
- Kronika Gjeorgjiane (Histori e Përmbledhur e Gjeorgjianëve, prej Xhuansherit) përkthyer prej Robert Bedrosian, shko tek [www.rbedrosian.com](http://www.rbedrosian.com) dhe shtyp në Bardos dhe shtyp kërkim; lexo Kapitulli 1.
- Histori e Përmbledhur e Gjeorgjianëve, prej Xhuansherit, Kapitulli 2, Pjesa 5
- Bibla e Shenjtë, Gjenezë 8:4 Çlirimi i Noes, Gjenezë 10:6-12 Nirodi, Gjenezë 10:15 Kanaani sjell në jetë Sidoni dhe Hethin, Gjenezë 10:25 Joktani, Gjenezë 11:1-7 Kulla e Babelit
- Bibla e Shenjtë, Ezekiel 27:2-4, 27:14, 38 dhe 39 Tiri dhe Togarmahu, Ezekiel 27:14, 38 dhe 39 Togarmahu dhe Gogu. Në Ezekiel 38;6 Ezekieli shkruan se Togarmahu është nga veriu i largët, me kuptimin larg në veri të Izraelit, dhe Armenia është larg në

veri të Izraelit. Veriu i largët jo domosdoshmërisht nënkupton Polin e Veriut.

Libri i Ngjarjeve (The Book of Jubilees) përmend emrin e “Nebrod” (Forma Babilonase për Nimrod) si të ishte babai i Azuradit, Azuradi ishte gruaja e Eberit dhe nëna e Pelegut (8:7). Sipas këtij tregimi ai na del paraardhës i Abrahamit dhe si rrjedhim edhe i gjithë Hebrenjve

Libri i Ngjarjeve (The Book of Jubilees) është shkruajtur prej autorëve të panjohur në gjuhën Hebreje dhe Etiopiane; është përkthyer prej një studjuesi Anglez të Biblës, Robert Henry Charles, dhe është publikuar prej Shoqërisë për Nxitjen e Njohurive Kristiane, Londër, 1917

Pikturë: Piktura e Hajkut si harkëtar i Madh është punuar prej Karlen Nurunjanian në vitin 1975

Pikturë: Kulla e Babelit, prej Pieter Bruegel, pikturuar në 1563

Pikturë: Pallati i Nimrodit, nxjerrë nga një skicë e bërë prej James Ferguson për Sir Henry Layard, më 1853

Pikturë: Sulm me qerre luftarake dhe njësi kalorësie, prej Andre Castaigne, pikturuar më 1898-1899

Pikturë: Beteja e Hajkut me Belin, Juliano Zasso (1833-1889).

Pikturë: Ararat (Pamje nga ana Turke )

Pikturë: Piktura e Malit Artos dhe Liqenit Van në Distriktin e Hajoc Corit, ku Hajku vrau Bel Nimrodit

Hartë: harta e Mbretërisë së Hajkut dhe e popujve fqinje në vitet 2500 B.C.

Ilustruar prej Garegin D. Nalbandian për Legjendën e Hajkut dhe Bel Nimrodit.

Studime Klasike, prej Henry Drisler, botuar në vitin 1894, në Londër Geographica (Gjeografia) prej Strabo, Libri 11,

Përkthyer prej Horace Leonard Jones, botuar nga Shtypshkronja e Universitetit të Harwardit, në vitin 1927, në USA

Referenca për Zoroastrianizmin, prej Richard James Horatio Gottheil i Kolegjit të Kolumbias, New York, 1894

Kopshti Sekret, prej Peter Martin, botuar në Sunday Times, në 11 Tetor, 1998

Zbulimi i Kopshtit të Edenit, prej Jim Myers, [www.biblicalheritage.org](http://www.biblicalheritage.org) website original i Qendrës së Trashëgimisë Biblike, Inc.

Parajsa e gjetur, Raport i Jeruzalemit, në 01 Shkurt, 1999; bazuar në gjetjet e arkeologut David Rohl

Origjina Armene e etruskëve, prej Robert Ellis, B.D., botuar në vitin 1861, London

Ziggurat, prej R.G.Killick, Diksionari i Artit (edition J.Turner, New York&London: Macmillan 1992), vol. 33, 675-676

Ziggurat, prej E.C. Stone, Enciklopedia e Arkeologjisë e Oksfordit në Lindjen e Afërme (ed. E.M. Meyers, New York&Oxford 1997), vol. 5, 390-391

Eia ishte Ea Sumeriane, që Akkadianët e përdornin për Ha ose Haia. Igor M. Diakonoff. Të dhëna mbi ndarjet etnike të Hurrianëve, 22, Instituti Vostokovedenija, Leningrad, Ussr. Predystoriia Arminskogo Naroda (Pre-Historia e Kombit Armen) Erevan, 1968

Herodotus Istorii (Historia) Leningrad, Russia, 1972

Historia, prej Herodotit, 440 B.C., përkthyer prej George Rawlinson me Sir Henry Rawlinson dhe Sir John Gardiner Wilkinson, London, 1860

Historia, prej Herodotit, 440 B.C., përkthyer prej George Campbell Macaulay, publikuar prej Macmilan, London dhe New York, 1890

Pesë Monarkitë e Mëdha, prej George Rawlinson, London, 1871

- Libri i Xhasherit, publikuar prej J.H. PARRY&COMPANY, Salt Lake City, Utah, 1887
- Summerian Glossary, prej Patrick C. Ryan, Publikuar Online, 2008
- Arkeologjia shkrimore e Kulturës së vjetër Mesopotamike, RRegistri i gjuhës së shenjave Sumeriane, prej Kurt Jasiewicz dhe John M. Jaritz, Chicago, Il, 1967
- Diksonari, Glossari, dhe Gramatika Urartiano-Armene, prej Sargis Aivazian, publikuar prej Universitetit Shtetëror të Erevanit, Erevan, 2008
- Urartskiye Pis'ma i Dokumenty (Letra dhe dokumente Urartiane), prej Igor M. Diakonoff, Moskë, 1963
- Predystoria Armianskogo Naroda (Pre-Historia e Kombit Armen), prej Igor M. Diakonoff, Erevan, 1968
- Legjenda e Drerit të Bardhë, një Legjendë kombëtare Hungareze
- Legjenda e Drerit të Bardhë, prej Fred Hmori (Fred Hamori)
- Tarihi Ungurus (Historia e Hungarezëve) prej Mahmud Terdjiuman, 1456, përkthyer prej Joseph Blaskovich, Pragë, 1982
- Perandoria Khazare, prej Arthur Koestler, London, 1976
- Tribuja e Trembëdhjetë, prej Arthur Koestler, London, 1976
- Historia e Khazarëve Çifutë, prej Douglas Morton Dunlop, Schocken Books, New York, 1954
- Histori e hershme e Gjuhëve Indo-Europiane, prej Tamaz V. Gamkrelidze and Vjaçeslav V. Ivanov, Moscow, 1984
- Eneida, shkruar prej Virgjilit në 19 B.C.E. dhe përkthyer prej John Dryden – Punët e Virgjilit, London, 1697
- Anabasis (Marshimi), prej Ksenofonit, Greece, 401 B.C.
- Anabasis (Marshimi) i Ksenofonit, prej Dr. William Rainei Harper dhe Dr. James Wallace, publikuar prej American Book Company, New York, 1893

Parimet e Filozofisë së Historisë Universale e aplikuar në Gjuhën dhe Besimin, prej Christian Charles Josias, Baron von Bunsen, London, 1854

Kombet pre-Historike, prej John Denison Baldwin, publikuar prej Harper&Brothers, New York, 1869. Publikuar përsëri prej BiblioBazaar, 2011

Origjina e historisë sipas Biblës, prej François Lenormant, Paris, 1874  
Përmbytja dhe Epopeja Babilonase, prej François Lenormant, Paris, 1873

Wikipedia.org-Article named Ferrous Metallurgy.

Exploiting the Earth, Kapitulli 4 – Epoka e Bronzit dhe Kapitulli 5 – Epoka e Hekurit, prej Richard Cowen, publikuar prej John Hopkins University Press në U.C. Davis, 1999

Udhëtim nëpër Arabinë Qëndrore dhe Lindore, prej William Gifford Palgrave, publikuar prej Macmillan&Company, London, 1866

Etiopianët e mrekullueshëm të Perandorisë Kushite, prej Drusilla Dunjee Houston, publikuar prej Universal Publishing Company, Oklahoma City, 1926

www.fanaticus.org-Article named: Paphlagonians

JewishVirtualLibrary.org-Article named: Josip-pon, dhe Enciklopedisë Çifute. JewishEncyclopedia.com në artikullin me titull: Joseph ben Gorion

Trashëgimia e Literaturës Armene: nga tradita gojore deri në Epokën e Artë, Kapitulli 5-Mitologjia Armene, prej Agop Jack Hacikian, Gabriel Basmajian, Edwards S. Franchuk dhe Nourhan Ouzounian, publikuar prej Wayne State University Press, Detroit, 2000

Nikolai Ivanoviç Vavilov ka shkruajtur se Armenia është vendlindja e kulturave të drithërave

Origjina dhe Gjeografia e Bimëve të Kultivuara, shkruar prej Nikolai

Ivanoviç Vavilov, përkthyer prej Doris Love, publikuar prej Cambridge University Press, Cambridge, 1992

[www.wikipedia.org](http://www.wikipedia.org)-Article named: Lord Byron

Legjenda e Hajkut dhe Belit ishte kaq domethënëse sa Lordi George Gordon Byron dhe kolegët e tij e konsideruan atë të një rëndësie të veçantë, të denjë për t'u shtuar në Bibël si pjesë e saj ose duke zëvendësuar atë me historinë e Kainit të Biblës; sidoqoftë, ata nuk ja arritën ta realizojnë idenë e tyre. Pasi kishte studjuar gjuhën Armene dhe gjuhë të tjera, ai pohonte se “gjuha Armene është gjuha me të cilën mund të flasësh me Zotin, dhe Zoti foli me botën në gjuhën Armene”. Lord George Gordon Byron, St. Lazarus Island in Venice, 1816 – 1819.

[www.poetryfoundation.org](http://www.poetryfoundation.org)-Article named: Lord Byron (George Gordon)

[www.fanaticus.org](http://www.fanaticus.org)-Article named: Paphlagonians

Iberianët, prej Antonio Arribas Palau, publikuar prej Thames dhe Hudson, London, 1964

Antichnaia Ispaniia (Spanja e Lashtë) prej Aleksandr Vasilevich Mishulin, Moscow, 1952

“Problema etnogeneza naseleniia Iberii (drevnei Ispanii).” Vestnik drevnei istorii, 1940

Big Davtar of Gurjistan, prej Valeriy I. Silogava dhe Kaksa (Kakha) Shengelia, Shtëpia Botuese e Universitetit të Kaukazit, Tbilisi, 2006. (Është në përdorim edhe e përkthyer në gjuhën Ruse dhe Gjeorgjiane)



CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Nalbandian, Garegin D.

Legjenda e Hajkut dhe Bel Nimrodit / Garegin D. Nalbandian ;  
përkth. Berzh Piranjani, Kevin Piranjani ; red. Berzh Piranjani.  
- Tiranë : Albpaper, 2020 ; 180 f. : me il. 14 x 21 cm.

Tit. origj.: The legend of Hayk and Bel Nimrod. - Fjalor. -  
Bibliogr.

ISBN: 978-9928-05-271-1

1.Historia e lashtë 2.Armeni 3.Mitologjia 4.Legjenda

94(=19)



Lekë 500 Çmimi

